



ISSN 2413-1334



Policimi dhe **SIGURIA**

Nr. 5
PRILL
2017

Revistë periodike shkencore
Botim i Akademisë së Sigurisë, Tiranë 2017



POLICIMI DHE SIGURIA
AKADEMIA E SIGURISË

Policimi
dhe **SIGURIA**

BOTIM PERIODIK
Botuar nga Akademia e Sigurisë, Tiranë

NR 5
PRILL
2017

Copyright © - Akademia e Sigurisë, Tiranë.

Të gjitha të drejtat e botimit dhe ribotimit janë të Akademisë së Sigurisë. Asnjë material nuk mund të riprodhohet, kopjohet, ripublikohet, modifikohet, shpërndahet apo shitet në asnjë mënyrë, i plotë apo pjesë të tij në formë elektronike apo në letër, pa autorizimin e shkruar të Akademisë së Sigurisë. Përdorimi i materialeve të kësaj reviste, pa autorizim, përbën shkelje penale të të drejtave të autorit.

Akademia e Sigurisë zotëron liri akademike dhe respekton detyrimet ligjore të përcaktuara shprehimisht në ligjin për Policinë e Shtetit dhe Arsimin e lartë si dhe të gjitha aktet e tjera ligjore që janë të detyrueshme për institucionet publike. Pikëpamjet e shprehura në revistën "Policimi dhe Siguria", janë të autorëve dhe nuk pasqyrojnë qëndrim zyrtar të Akademisë së Sigurisë. Autorët e publikimeve në revistën "Policimi dhe Siguria" gëzojnë liri të plotë akademike, me kushtin e vetëm që kur shkruajnë, ata të zbatojnë të gjithë legjisllacionin përkatës si të komunikimit edhe atë profesional, i cili nuk cenon të drejtat e ndryshme.



Botues

AKADEMIA E SIGURISË
Rruga e Elbasanit, Sauk, Tiranë

NR 5
PRILL
2017

BORDI EDITORIAL

Kryetari i Bordit

Dr. Xhavit SHALA

Anëtarët e Bordit

Prof. Dr. Ilirjan MANDRO

Prof. Dr. Ismet ELEZI

Prof. Dr. Irakli KOÇOLLARI

Prof. Dr. Giovanni ARCUDI

Prof. Dr. Sebastiano TAFARO

Prof. Asc. Dr. Pandeli TAÇI

Prof. Asc. Dr. Snezana MOJSOSKA

Prof. Asc. Dr. Bejtush GASHI

Prof. Asc. Dr. Ferdinand ELEZI

Prof. Asc. Dr. Fatmir TARTALE

Dr. Frank HARRIS

Redaktor shkencor

Albert HITOALIAJ

Përkthyes

Vangjel LILI

Lavdim KAZAZI

Punimet grafike

Andi OSMANI

Realizimi teknik

Qendra Kërkimore Shkencore,
Akademia e Sigurisë

Revista shkencore "**Policimi dhe Siguria**", botohet nga "Qendra Kërkimore Shkencore" e Akademisë së Sigurisë, me qëllim përmbushjen e standardeve më të larta në veprimtarinë kërkimore-shkencore në aktivitetin e Akademisë së Sigurisë.

P È R M B A J T J A

1. **Ministër i Punëve të Brendshme, Fatmir XHAFAJ**
Përgjegjësi, përkushtim, angazhim maksimal dhe rezultate konkrete, në përmbushjen e prioriteteve kyçe në luftën kundër krimit të organizuar... 8
2. **Magjistrat Ergys GASHI**
“Veprimet arbitrare” dhe “lejimi i gjendjes së paligjshme” – dy figura të veprës penale me subjekt punonjës të Policisë së Shtetit 14
3. **Msc Arben SKËNDO**
“Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat”, në sfidën e faktorit të mbikëqyrjes së jashtme civile24
4. **MSc, gjenearl i Gardës Gramoz SAKAJ**
Garda e Republikës - vështrim historik mbi misionin dhe rolin e saj ... 34
5. **Prof. Asc. Dr. Pandeli TAÇI**
Studimet “Master”, kusht i domosdoshëm për një polici profesionale. . 44
6. **Dr. Xhavit SHALA**
Përballja dhe lufta kundër korrupsionit policor, forcon organizatën tonë policore 56
7. **MSc. Ardi VELIU**
Siguria rrugore: sfida jonë e përbashkët68
8. **Msc Argjenda PRIFTI**
Ndhma shtetërore në BE dhe ndikimi, në ekonominë dhe sigurinë e përbashkët 78
9. **Dr. proc. Anisa HYSESANI**
Policimi në komunitet: “Zyrat e Shërbimit të Qytetarëve” të Komisarariatit të Policisë Durrës, në kuadër të kësaj strategjie 90
10. **MSc Kujtim STOJKU**
Siguria kombëtare dhe religjioni 98
11. **Msc Adriatik DUQI**
Koncepti i shkollimeve e trajnimeve dhe roli i mësimdhënësve 108
- Abstraktet në anglisht / Abstracts 118**



POLICIMI DHE SIGURIA
AKADEMIA E SIGURISË

Përgjegjësi, përkushtim, angazhim maksimal dhe rezultate konkrete, në përmbushjen e prioriteteve kyçe në luftën kundër krimit të organizuar



Fatmir XHAFJA

MINISTËR I PUNËVE TË BRENDSHME*



Lufta për parandalimin e çdo lloji veprimtarie që lidhet me mbjelljen dhe kultivimin e kanabisit në veçanti dhe trafikun e narkotikëve në përgjithësi, do jetë prioriteti thelbësor i punës sime në krye të Ministrisë dhe i gjithë ekipit drejtues, veçanërisht i strukturave të Policisë së Shtetit (nga Drejtori i Përgjithshëm deri tek punonjësi më i thjeshtë i rolit bazë). Qeveria shqiptare ka hartuar, në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë, një plan të qartë veprimi për luftën ndaj lëndëve narkotike dhe posaçërisht, për ndalimin e kultivimit të kanabisit. Ky plan do jetë udhërrëfyesi i punës sonë të përbashkët. Sfidë ime është që ta nxjerrim Shqipërinë njëherë e përgjithmonë nga lista e vendeve që kultivojnë kanabisin. Pa dyshim, ky objektivi është një sfidë mjaft e vështirë për këdo dhe kudo ku ky fenomen ekziston. Por, duhet të jemi të gjithë të vetëdijshëm se, asnjë e mirë nuk u vjen qytetarëve të një vendi ku mbillet kanabis dhe ku ekziston trafiku i lëndëve narkotike. Ndaj, në këtë luftë duhet të jemi të gjithë bashkë, pa asnjë dallim politik apo të çdo lloji tjetër

Sot, Policia ka një fizionomi të ndryshuar, për shkak të një statusi të ri ligjor, që u është dhënë punonjësve të saj. Sot, Policia është e përbërë nga një trupë e mirëpërzgjedhur, e mirëarsimuar dhe e trajnuar, me emëtime dhe ngritje në detyrë për shkak të meritokracisë. Vlen të theksohet se, jo vetëm ngritja profesionale ka ndikuar në performancën më të lartë të Policisë në këto 27 vitet e fundit, por edhe mbështetja financiare logjistike ndaj tyre, ka shërbyer për rikthimin e dinjitetit të punonjësit të Policisë. Falë mbështetjes edhe të partnerëve ndërkombëtarë, sot kemi një Polici më mirë të trajnuar profesionalisht, në luftën kundër krimit të organizuar, luftës ndaj lëndëve narkotike dhe luftës ndaj terrorizmit dhe ekstremizmit.

Në ushtrimin e funksionit të lartë kushtetues, ligjor dhe institucional në krye të Ministrisë të Punëve të Brendshme, përpara meje dhe gjithë ekipit drejtues të kësaj ministrie si dhe atij të Policisë së Shtetit, shtrohen një sërë prioritetesh kyçe të cilat kërkojnë përgjegjësi, përkushtim, angazhim maksimal dhe rezultate konkrete:

1. Lufta për parandalimin e çdo lloj veprimtarie që lidhet me mbjelljen dhe kultivimin e kanabisit në veçanti dhe trafikun e narkotikëve në përgjithësi, do jetë prioriteti thelbësor i punës sime në krye të Ministrisë dhe i gjithë ekipit drejtues, veçanërisht i strukturave të Policisë së Shtetit (nga Drejtori i Përgjithshëm deri tek punonjësi më i thjeshtë i rolit bazë). Qeveria shqiptare ka hartuar, në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë, një plan të qartë veprimi për luftën ndaj lëndëve narkotike dhe posaçërisht, për ndalimin e kultivimit të kanabisit. Ky plan do jetë udhërrëfyesi i punës sonë të përbashkët. Sfidë ime është që ta nxjerrim Shqipërinë njëherë e përgjithmonë nga lista e vendeve që kultivojnë kanabisin. Pa dyshim, ky objektivi është një sfidë mjaft e vështirë për këdo dhe kudo ku ky fenomen ekziston. Por, duhet të jemi të gjithë të vetëdijshëm se, asnjë e mirë nuk u vjen qytetarëve të një vendi ku mbillet kanabis dhe ku ekziston trafiku i lëndëve narkotike. Ndaj, në këtë luftë duhet të jemi të gjithë bashkë, pa asnjë dallim politik apo të çdo lloji tjetër. Shqipëria është një vend i vogël, me një sipërfaqe relativisht të vogël, por edhe me një territor të vështirë e me infrastrukturë të keqe në një pjesë të konsiderueshme të saj. Ne të gjithë, do të bëjmë përpjekjet tona maksimale për të parandaluar këtë fenomen që në embrion. Për të realizuar këtë, ndër të tjera, do të rrisim dhe mbështesim maksimalisht rolin e Policisë në terren. Ndaj, ju siguroj sot, këtu, se do ketë shumë herë dhe më shumë njerëz në terren se sa në zyra, në luftën për parandalimin e mbjelljes së kanabisit. Në këtë betejë

nuk do bëjmë asnjë kompromis me trafikantët, me abuzuesit e ligjit, me punonjësit e korruptuar të Policisë. Do të ketë ndëshkim për çdo rrënjë kanabisi të mbjellë. Dhe ky ndëshkim nuk do bjerë vetëm mbi ata që tentojnë ta mbjellin, por edhe mbi ata që e lejojnë, që nuk informojnë dhe nuk e luftojnë, duke u bërë palë me kriminelët. Ju siguroj publikisht se, për të gjithë ata punonjës të Policisë së Shtetit që bëhen palë me kriminelin, ndëshkimi ligjor do të jetë mjaft i rreptë, nga largimi i tyre i plotë nga radhët e Policisë së Shtetit dhe deri në ndjekje penale.

Kjo është një betejë e cila nuk mund të realizohet pa mbështetjen e shtetasve, pa mbështetjen e të gjithë shqiptarëve, pa mbështetjen dhe angazhimin serioz të organeve të qeverisjes vendore për të bashkëpunuar me Policinë për denoncimin e rasteve, për rritjen dhe sensibilizimin tek njerëzit në zonat rurale më të thella – nga skaji verior e deri tek ai jugor. Duke forcuar besimin se, tek Policia e Shtetit çdo qytetar duhet të gjejë mbështetjen absolute në luftën kundër çdo lloj paligjshmërie. Jam i bindur se të gjithë bashkë do ta fitojmë këtë betejë. Dhe Shqipëria nuk do të jetë pjesë e kësaj harte famëkeqe, por e një harte tjetër: hartës së familjes së madhe të Bashkimit Evropian.

2. Lufta kundër terrorizmit, ekstremizmit të dhunshëm dhe financimit të terrorizmit do të jetë një ndër prioritetet, gjithashtu shumë të rëndësishme të punës sonë. Sot e përditë, vendet evropiane po përballen me një pasiguri ekstreme, për shkak të terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm. Në këtë luftë, Shqipëria ka një rol të rëndësishëm. Së pari, për parandalimin e përhapjes së këtyre fenomeneve në vendin tonë. Dhe së dyti, marrjen e masave për evidentimin e tyre. Shteti ynë, ka mbështetjen e pakursyer të partnerëve tanë strategjikë në luftën kundër terrorizmit, ekstremizmit dhe financimit të tyre. Duke mbajtur parasysht se kjo luftë përfshin disa faktorë, prioriteti i punës sonë në Ministrinë e Punëve të Brendshme do të jenë përpjekjet maksimale dhe të vazhdueshme, për të realizuar të gjitha detyrimet tona kundrejt të gjitha akteve dhe konventave ndërkombëtare të ratifikuara, marrëveshjeve dhe strategjive me të cilat Shqipëria është bërë pjesë. Veprimtaria jonë do të intensifikohet në këtë drejtim në mbështetjen edhe të partnerëve strategjikë, për ta bërë vendin akoma edhe më të sigurt.

3. Intensifikimi i luftës ndaj krimit të organizuar dhe grupeve kriminale, duke përfshirë këtu edhe organizmin e kultivimit të bimëve narkotike do të jetë një tjetër prioritet kyç i punës sime si ministër. Puna parandaluese duhet të shkojë paralelisht me veprimtarinë e Policisë së Shtetit, në funksion të zbatimit me efektivitet të Ligjit Penal. Këtu, një rol të dorës së parë ka veprimtaria e Policisë Gjyqësore, puna dhe misioni i përbashkët me prokurorët për ndëshkimin e rreptë të veprimtarisë kriminale. Në këtë aspekt, strukturat e Policisë së Shtetit do të nxiten dhe inkurajohen që të fokusohen me hetime proaktive, do të mbështeten me mjete logjistike dhe do të kërkohet që të ndjekin hetime, deri në identifikimin e autorëve dhe dokumentimin e plotë të veprimtarisë

kriminale. Forcat njerëzore, në këtë aspekt, janë disi të kufizuara në numër. Ndaj, kërkohet përqendrim në hetimet që kanë rëndësi parësore për çështje të rëndësishme, duke racionalizuar forcat dhe duke hequr dorë nga puna për dukje dhe shifra që nuk thonë gjë. Puna e çdo oficeri apo agjenti të Policisë do të duhet të matet me rezultate konkrete dhe të arritura në terren, në veprimtarinë hetimore për evidentimin e të gjitha grupeve kriminale, posaçërisht të personave që paraqesin rrezikshmëri të theksuar për rendin dhe sigurinë publike. Struktura përkatëse të Policisë së Shtetit, do të inkurajojnë që të ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme, të aktivizojnë të gjitha burimet e informimit me qëllim ndërprerjen e lidhjeve që favorizojnë mbështetjen e tyre, deri në arrestimin dhe nxjerrjen e tyre para drejtësisë.

4. Policia e Shtetit do t'i kushtojë një rëndësi të posaçme forcimit të besimit të ndërsjellë dhe bashkëpunimit me Shërbimet Informative. Disa raste, të anashkalimit të strukturave të Policisë dhe të krimit, të lidhjeve të shkurtra me misionet e tjera ligjzbatuese, duhet të mos përsëriten. Fakti, se për fat të keq, ka dhe raste të korrupsionit të oficerëve apo agjentëve të veçantë të Policisë, nuk duhet të shërbejë si alibi për të përligjur mosbashkëpunimin. Ndërkohë që është fakt i provuar, që në radhët e Policisë, punojnë vajza dhe djem me integritet të sprovuar në luftën e përditshme kundër krimit. Këta të fundit, të cilët do të mbështeten fort nga ana ime si ministër, janë garancia për të shtyrë përpara punën e përbashkët në interes të ligjit, drejtësisë dhe sigurisë së qytetarëve.

5. Do të ngrihet në nivel më të lartë beteja jonë kundër aseteve dhe produkteve të krimit, të cilët ushqejnë çdo ditë dhe çdo orë paligjshmërinë, u japin forcë dhe siguri organizatave kriminale, financojnë veprimtarinë e paligjshme dhe sponsorizojnë korrupsionin në Prokurori dhe Gjykatë, duke shumëzuar me zero punën e strukturave të Policisë së Shtetit. Për këtë arsye, krahas parandalimit dhe represionit kundër krimit, do të kërkoj me forcë zbatimin e ligjit për sekuestrimin dhe konfiskimin e aseteve kriminale, mbështetur edhe në ndryshimet e rëndësishme që po i bëhen legjislacionit përkatës, në kuadër të Reformës në Drejtësi dhe që priten, të miratohen së shpejti, nga Kuvendi i Shqipërisë. Disa masa reformuese të strukturave të Policisë Gjyqësore dhe hetimit, në radhët e Policisë së Shtetit, në përshtatje edhe me zgjidhjet e reja të ofruara nga Reforma në Drejtësi, në fushën e drejtësisë penale, do të jenë pjesë e rëndësishme e axhendës sime në krye të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

6. Një Polici e qëndrueshme, me integritet të lartë dhe besueshmëri të qytetari, është gjithashtu një tjetër prioritet i punës sonë. Për të arritur këtë qëllim, duhet të zhvillohen raporte vlerësimi, për të vlerësuar pastërtinë e figurës së punonjësit të Policisë. Dhe, ndoshta ka ardhur koha, për të bërë atë që konsiderohet ndryshe edhe "*Vetting-u i figurës morale të çdo punonjësi të Policisë*". Promovimi brenda strukturave të Policisë së Shtetit, do të bëhet vetëm sipas meritokracisë dhe sistemeve të vlerësimit. Në

këto kushte, dua të theksoj sot se punonjësit e Policisë së Shtetit, do të jenë shërbëtorë të ligjit dhe luftëtarë të krimit. Tolerancë zero do të aplikohet ndaj çdo shkeljeje gjatë ushtrimit të detyrës dhe ndaj atyre punonjësve të cilët nuk meritojnë të jenë në radhët e Policisë. Është detyra ime në radhë të parë dhe çdo e drejtuesi të lartë, e deri të punonjësi më i thjeshtë i Policisë, për t'i shërbyer me ndershmëri qytetarëve dhe për të forcuar më tej, besimin në rritje të publikut te Policia e Shtetit. Shtetasit shqiptarë duhet të ndihen më të fortë për të bërë denoncim në Polici, më të mbrojtur për të bashkëpunuar me organet e Policisë dhe për t'u sensibilizuar, për të rritur parandalimin e veprave të ndryshme penale.

7. Lufta kundër korrupsionit në radhët e Policisë, gjithashtu do të marrë prioritet gjatë qëndrimit tim në këtë detyrë. Ne kemi nevojë për punonjës Policie dhe veçanërisht për drejtues Policie me integritet të lartë moral, të aftë të punojnë dhe të luftojnë në ekip si dhe me profesionalizëm të lartë, si kusht për një Polici në shërbim të kushtetutës dhe ligjit, në shërbim të jetës dhe të sigurisë së qytetarëve, për një Polici që ofron shpresë dhe besim. Nuk mund të mendohet që një punonjës i thjeshtë policie, të japë ndihmë, apo më keq akoma, të bashkëpunojë ngushtë me persona të përfshirë në veprimtari kriminale – dhe jo më, një drejtues i lartë Policie. Nëse kjo ndodh, atëherë rendi dhe siguria publike janë cenuar rëndë. Dhe në këtë rast reagimi ligjor kundër këtyre drejtuesve do të jetë shumë i ashpër.

8. Me rëndësi të veçantë, do të jetë edhe vazhdimi i projekteve që kanë filluar dhe që kanë rëndësi të madhe për shtetasit dhe pikërisht, projekti që lidhet me “Popullimin” identifikimin e çdo adrese të individëve përmes numrit unik personal të shtetasve, atje ku banojnë. Gjithashtu nisma “Dorëzimi vullnetar i armëve” do të jetë gjithashtu një projekt që do të ketë vëmendjen e punës sime, kjo, për të rritur sensibilizimin e qytetarëve për dorëzimin e armëve dhe për t'i thënë “Jo!” dhunës dhe vetëgjyqësisë.

9. Reforma në Drejtësi, është reforma më e rëndësishme në 25 vitet e fundit, një reformë e mezipritur nga shtetasit, të cilët enden për vite të tëra në dyert e prokurorive dhe gjykatave, që vuajnë pasojat e një hetimi ose vendimi të padrejtë, që vuajnë nga veprimet korruptive të gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe nga neglizhenca e institucioneve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë e atij të Prokurorisë. Por, jo vetëm për shtetasit, por edhe për vetë Policinë. Është sfiduese të luftosh me kriminelët deri në humbje jete dhe të arrestosh kriminelët, të cilët i rishikon përsëri në rrugët e qytetit tënd. Me zbatimin e Reformës në Drejtësi këto praktika abuzive do të marrin fund. Zbatimi i *Vetting*-ut është hapi i parë që pritet të ndodhë në jetësimin e kësaj reforme, proces që do t'i hapë rrugën verifikimit të skanimit të së gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve të sistemit të drejtësisë dhe më pas, konstituimit të së gjitha institucioneve të reja të këtij sistemi. Ne

jemi të ndërgjegjshëm që, në radhët e gjyqësorit dhe të prokurorisë, shërbejnë edhe shumë njerëz, me integritet e cilësi të larta morale, që nuk kanë asgjë të përbashkët me individët e korruptuar në radhët e tyre, që janë vendosur në shërbim të interesave të jashtëligjshme politike dhe financiare. Ne do të nxisim bashkëpunimin me ta, në funksion të arritjes së rezultateve konkrete në hetimet e përbashkëta. Asnjëherë nuk duhet të humbasim besimin, se vetëm me përpjekje dhe punë të përbashkët, duke kultivuar solidaritetin dhe bashkëpunimin e sinqertë në luftë ndaj krimit, rezultatet nuk do të mungojnë.

Kontributi im tashmë do të fokusohet në procesin e zbatimit me sukses të procesit të *Vetting*-ut, brenda kufijve të ligjit dhe në ngritjen e institucioneve të reja të sistemit të drejtësisë penale. Dhe sidomos Byrosë Kombëtare të Hetimit, pjesë e strukturave të posaçme për luftën ndaj krimit të organizuar dhe korrupsionit si domosdoshmëri për të eliminuar kulturën e pandëshkueshmërisë dhe forcuar luftën ndaj krimit të organizuar, korrupsionit dhe terrorizmit.

Të shërbej si ministër, është një përgjegjësi e madhe kushtetuese dhe ligjore dhe sidomos në raport me interesat e qytetarëve, që presin një qeverisje më të mirë. Ndaj, sa herë më është dhënë mundësia për një detyrë të tillë, i kam dhënë asaj gjithë përgjegjësinë, përkushtimin dhe angazhimin tim. Të shërbej si Ministër i Brendshëm, për më tepër në një vend si ky i yni, ku politika dhe konfliktualiteti i prodhuar prej saj është arma që vret më shumë shpresën dhe besimin e njerëzve, është jo thjesht një përgjegjësi, por edhe një sakrificë. Jam i ndërgjegjshëm për këtë gjë, ndaj dhe vendimi për të pranuar këtë detyrë ka qenë dhe besoj se do të mbetet vendimi më i vështirë i jetës sime politike. Tashmë kjo është shndërruar në një sfidë që ka vetëm një rrugë:

përbushjen me sukses të detyrës!

“Veprimet arbitrare” dhe “lejimi i gjendjes së paligjshme” – dy figura të veprës penale me subjekt punonjës të Policisë së Shtetit



■ **Ergys GASHI**
Magjistrat në profilin “Gjyqtar”

Abstrakt

Ky punim trajton dy figura bazë të veprës penale, në të cilat shfaqen shkeljet e punonjësve të Policisë së Shtetit, të dënueshme penalisht. Ato nuk kanë një përhapje të gjerë në praktikë, duke qenë kjo shenjë e një ndjenje përgjegjësie në rritje, e anëtarëve të trupës policore, veçanërisht në përmbushjen e detyrave funksionale me ndikim në lirinë e shtetasve. Thelbi i këtyre dispozitave qëndron në cenimin e kundërligjshëm të lirisë dhe të paprekshmërisë fiziko-mendore të shtetasve. Të dy dispozitat i shërbejnë po të njëjtit qëllim, shmangies së veprimeve arbitrare, duke dekurajuar vetë punonjësit që mund të përfshihen në këto veprime (n. 250 i Kodit Penal), si dhe pasivitetin e kolegëve të tyre për të mos raportuar dhe ndaluar vijimin e mëtejshëm të pasojave të veprimeve (n. 251). Në rast se veprimet arbitrare shkaktojnë edhe pasoja të rënda në jetën apo shëndetin e shtetasve, punonjësi do të duhet të përgjigjet për krimin e “veprimeve arbitrare” e njëkohësisht për krimin përkatës kundër jetës apo shëndetit.

Fjalëkyçe:

Shpërdorim i detyrës policore, liria e shtetasve, kryerja e veprimeve arbitrare, mosmarrja e masave për të ndërprerë gjendjen e paligjshme.

Gashi, E.
« “Veprimet arbitrare” dhe “lejimi i gjendjes së paligjshme” – dy figura të veprës penale me subjekt punonjës të Policisë së Shtetit »

Policimi
dhe
Siguria
nr.5, 2017

1. Hyrje

“Kryerja e veprimeve arbitrare” dhe “Mosmarrja e masave për të ndërprerë gjendjen e paligjshme”, të parashikuara nga n. 250, 251 të Kodit Penal¹, përbëjnë dy nga figurat bazë të veprës penale, që kanë si protagonist (subjekt aktiv) punonjës të Policisë së Shtetit. Kjo e fundit, duke qenë organi kryesor përgjegjës për ruajtjen e sigurisë publike, parandalimin dhe luftën ndaj kriminalitetit, ndërmerr një vëllim pune të atillë, që së bashku me arritjet, lë vend edhe për dështime, më saktë shpërdorime, nga punonjës të veçantë të trupës policore. Në lidhje me këtë veprimtari të kundërligjshme, legjislacioni penal material synon para së gjithash, të mbajë të pacenuar lirinë e shtetasve ndaj të cilëve drejtohen veprime të caktuara policore. Qartësia dhe thjeshtimi i procedurave të ndërmarra nga Policia e Shtetit, komunikimi dhe raportimi i rregullt midis hallkave organizative, ndërgjegjësimi i qytetarëve për të kallëzuar paligjshmërinë dhe krijimi i një infrastrukture ndihmëse, - jo vetëm proceduralo-penale, për këtë qëllim, - janë vetëm disa nga mjetet që mund të përdoren në përpjekjen institucionale për të kufizuar shfaqjet e shpërdorimit me detyrën në Policinë e Shtetit. Aleati më i vyer në këtë përpjekje është qytetari, jo vetëm për të shmangur dhe zbutur efektet negative të shpërdorimeve policore në të drejtat dhe liritë e tij, por edhe për ta bërë qytetarin të sigurt, besues dhe dëshmues në luftën kundër paligjshmërisë dhe konsolidimin e shtetit të së drejtës.

¹ Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, së fundi i ndryshuar me ligjin nr. 82/2016, datë 25.07.2016.

Gashi, E.
« “Veprimet arbitrare” dhe “Lejimi i gjendjes së paligjshme” – dy figura të veprës penale me subjekt punonjës të Policisë së Shtetit »

Policimi
dhe
Siguria
nr.5, 2017

2. Kryerja e veprimeve arbitrare

Kjo figurë e veprës penale karakterizohet nga veprime aktive të çfarëdollojshme, të cilat drejtohen drejtpërdrejt tek qytetarët ose nga urdhra që punonjësi i policisë jep për strukturat vartëse. Këto veprime ose urdhra janë arbitrare, në kuptimin që bien ndesh me parashikime ligjore, normative ose të rregulloreve të ndryshme të organizimit dhe funksionimit të policisë.² Gjithashtu ato kanë si karakteristikë se kryhen apo jepen gjatë ushtrimit të detyrës nga punonjësi. Deri këtu, ngjan se karakteristikat e sapopërmendura, e bëjnë këtë figurë të veprës penale një shfaqje të figurës së gjerë të 'Shpërdorimit të detyrës', sipas n. 248 të K.P.. Ajo që i shquan 'veprimet arbitrare', sipas n. 250 të Kodit, është se ato prekin apo cenojnë lirinë e një ose më shumë shtetasve. Mendimi ynë, është se kemi të bëjmë me një vepër penale materiale dhe jo formale, në kuptimin që vepra quhet e kryer, e konsumuar, me ardhjen e pasojës së kundërligjshme, cenimin e lirisë individuale të shtetasve. Nëse përpara këtij momenti, rezulton se punonjësi ka kryer veprimet e nevojshme të domosdoshme për ardhjen e pasojës, por ajo nuk ka ardhur, për arsye të pavarura nga vullneti i tij, atëherë vepra do të konsiderohet si e mbetur në tentativë.

Një aspekt kyç që duhet shtjelluar në lidhje me këtë figurë të veprës penale është ai se: "çfarë kuptojmë me 'liri të shtetasve'?" Liria në këtë kontekst duhet kuptuar më së shumti si liri e lëvizjes, pra si mundësi e shtetasit për të përcaktuar vendndodhjen sipas vullnetit të vet. Por jo vetëm kaq. Ajo duhet të përfshijë edhe të drejtën e shtetasit për paprekshmërinë e tij fizike dhe psikike dhe ruajtjen të pacenuar të sferës së integritetit vetjak. Veprime të tilla policore si shoqërimi, ndalimi, arresti në flagrancë, përbëjnë shfaqjet kryesore të veprimtarisë policore, të cilat, në kushte flagrante arbitrariteti dhe paligjshmërie, mund të bëhen shkas për marrjen në përgjegjësi penale të punonjësit, sipas n. 250 të Kodit. Që kjo të ndodhë, do të duhet që kriteret ligjore për zbatimin e këtyre veprimeve policore me karakter shtrëngues, izolues, të jenë shpërfillur me dashje dhe në keqbesim nga punonjësi përkatës. Sigurisht që secilit punonjës publik, - jo vetëm në Policinë e Shtetit, - i lejohet një hapësirë, brenda së cilës shtrihen gabimet e tij në kryerjen e detyrës, të cilat, lënë vend për përgjegjësi disiplinore; për t'u dalluar nga përgjegjësia penale që do të duhet të shkaktohet në raste më specifike. Kriteri bazë që bën dallimin këtu, qëndron tek rëndësia e shkeljes dhe qëndrimi i punonjësit në kryerjen e detyrës.

3. Mosmarrja e masave për të ndërprerë gjendjen e paligjshme

Ajo që bie në sy në lidhje me këtë figurë të veprës penale është qëndrimi pasiv i punonjësit përkatës publik. Ai vihet në dijeni, në një mënyrë të çfarëdoshme, se një punonjës tjetër ka kryer një veprim arbitrar që ka prekur lirinë e shtetasit, e megjithëkëtë, qëndron pasiv, duke mos njoftuar organin përkatës drejtues ose duke mos e ndërprerë ai vetë gjendjen e paligjshmërisë së krijuar. Dispozita flet për vënienë në dijeni të gjendjes së paligjshme për shkak të funksionit apo shërbimit. Kjo nuk duhet kuptuar në mënyrë

Gashi, E.
« Veprimet arbitrare » dhe
"lejimi i gjendjes së paligjshme"
- dy figura të veprës penale me subjekt punonjës të Policisë së Shtetit »

Policimi dhe Siguria
nr.5, 2017

² Rreth këtij aspekti të shihet edhe: Ismet Elezi. *E Drejta Penale. Pjesa e Posaçme*. Tiranë, 2007.

të ngushtë: sikur është e nevojshme që marrja e dijnisë për veprimin arbitrar të ketë ndodhur zyrtarisht, p.sh. në mënyrë formale apo shkresore. Sidoqë punonjësi të ketë marrë dijeni për veprimin arbitrar, ai do të duhet të përgjigjet, me kusht që në rrethanat e caktuara të ketë pasur mundësi të kuptojë që ka qenë cenuar jo vetëm liria e shtetasit, por që kjo ka ndodhur përmes një veprimi arbitrar, pra haptazi të kundërligjshëm. Nëse në rrethanat e krijuara nuk ka qenë e mundur që punonjësit t'i lindë një dyshim i arsyeshëm se veprimi i kolegut të tij ishte haptazi i kundërligjshëm, ai nuk do të duhet të përgjigjet sipas kësaj dispozite.

Kjo figurë e veprës penale është e lidhur pazgjidhshmërisht me figurën tjetër të “Kryerjes së veprimeve arbitrare”, të trajtuar më lart, aq sa mund të flitet për një vazhdimësi në planin logjik dhe kronologjik të faktit të kundërligjshëm. Fillimisht, një punonjës kryen veprime arbitrare, me cenim të lirisë së shtetasit, e më pas, një tjetër punonjës, koleg, vartës apo epror i të parit, i ardhur në dijeni të veprimit arbitrar, nuk merr masa të nevojshme që veprimi të shfuqizohet apo të pushojë, e bashkë me të, të rikthehet edhe gjendja e lirisë së shtetasit.

4. Praktika gjyqësore në këtë fushë

Me Vendimin nr. 374, datë 02.07.2004, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, gjykata është përballur me një rast ku, një punonjës policie në rrugë ka ushtruar veprime të dhunshme ndaj një shtetasi. I dëmtuari është dërguar në komisarariat me anë të grupit të gatshëm e më pas në spitalin e qytetit, ku kanë rezultuar pasoja në shëndet në masën e plagosjes së lehtë. Gjatë shtrimit në spital, në derën e dhomës e në korridor, ruhej me policë. Gjykatat e faktit (e shkallës së parë dhe e apelit) e kanë cilësuar veprën si “torturë”, në vështrim të n. 86 të Kodit Penal. Gjykata e Lartë, duke pranuar se vuajtja fizike nuk ka qenë e rëndë, sipas n. 86, i ka cilësuar veprimet e të gjykuarit se përmbushin elementet e “Kryerjes së veprimeve arbitrare” në vështrim të n. 250 të Kodit. Me këtë cilësim juridik që ka bërë Kolegji Penal i Gj.L., i ka dhënë rëndësi faktit të shoqërimit të personit në komisarariat e më pas vazhdimit të cenimit të lirisë deri në spital, duke u konsideruar këto veprime si arbitrare. Në vendimin gjyqësor nuk evidentohet ekzistenca e ndonjë rrethane apo dyshimi të ligjshëm, që do ta kishte justifikuar shoqërimin e detyrueshëm të shtetasit në komisarariat dhe as zbatimi i ndonjë procedure apo mbajtja e akteve të shkruara për këtë qëllim. Eventualisht, në ato akte të mbajtura në vendngjarje apo në ambientet e komisarariatit, do të duhet të ishte pasqyruar dyshimi përkatës për shkelje të ligjit nga shtetasi i shoqëruar.

Në panoramën e rrethanave të faktit që paraqet çështja e mësipërme gjyqësore, rezulton se cilësimi ligjor i veprës do të kishte qenë i ndryshëm, nëse i dëmtuari do t'i ishte nënshtruar dhunës fizike në vendngjarje, pa cenim të mëtejshëm të lirisë së tij vetjake. Për pasojat e përkohshme në shëndetin e shtetasit, punonjësi do të duhet të përgjigjej vetëm sipas n. 89 të Kodit (“Plagosja e lehtë me dashje”).

Me Vendimin nr. 82, datë 17.03.2003, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë³ ka vendosur shpalljen fajtor të të gjykuarit L.B., për “Vrasje me dashje”, sipas n. 76 të Kodit, të të gjykuarit D.G., për “Kryerje të veprimeve arbitrare” sipas n. 250, dhe të disa punonjësve të tjerë të policisë, për “Moskallëzim të krimit”, sipas n. 300. Të

³ Vendim i lënë në fuqi, me vendimet nr. 86, datë 15.07.2003, të Gjykatës së Apelit Korçë dhe nr. 63, datë 30.01.2004, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

Gashi, E.
« “Veprimet arbitrare” dhe “Iejimi i gjendjes së paligjshme” – dy figura të veprës penale me subjekt punonjës të Policisë së Shtetit »

Policimi dhe Siguria
nr.5, 2017

sipërpërmendurit, - të gjithë punonjës policie, - kishin marrë dijeni se shtetasi G.T. kishte kryer veprime të kundërligjshme në dëm të një tjetër shtetasi (dëmtim prone, vepra me armatim/municion), dhe të njoftuar nga ky i fundit, ishin paraqitur në banesën e G.T., duke u përpjekur ta shoqëronin në komisariat. Pasi kishin hasur në rezistencën e personit, e kishin shoqëruar forcërisht në komisariat, por duke e kryer, punonjësi i policisë, L.B., gjatë shoqërimit kreu veprime dhune ndaj G.T., për shkak të së cilave, ky i fundit gjeti vdekjen pak më pas. Ajo që është me interes për punimin e këtushëm, lidhet me veprimet e punonjësit të policisë D.G., për të cilat gjykata vendosi shpalljen e tij fajtor për “Kryerje të veprimeve arbitrare”. Në rrethanat konkrete të çështjes, në mënyrë që ai të shpallej fajtor, sipas kësaj dispozite penale do të duhej që veprimet e dhunshme të kryera prej tij, të ishin në shpërpjesëtim të hapur me dhunën e ushtruar nga viktima ose që të paraqiteshin të pajustificuara në kohë⁴.

Një çështje që paraqitet me rëndësi, është ajo rreth cilësimit ligjor të veprimeve të punonjësve, kur jo vetëm cenojnë në mënyrë të pajustificuar paprekshmërinë fiziko-psikike të shtetasve, por veprimet përkatëse shtyhen deri në ardhjen me atë rast, të pasojave të lehta ose të rënda në shëndetin e shtetasve. Është interpretim i yni, se pasoja jo më të rënda se sa paaftësia e përkohshme, do të duhet të përfshihen brenda kuadrit të n. 250 (“Kryerja e veprimeve arbitrare”), pa konkurrim të kësaj vepre me veprat penale kundër shëndetit. Pasoja të tilla jo të rënda, përfshihen brenda kuadrit të anës objektive të figurës së krimit, sipas n. 250, atje ku kjo dispozitë flet për “prekje të lirisë së shtetasve”. Për këtë arsye, kundërvajtjet penale kundër shëndetit do të konsiderohet se përthithen nga figura e krimit sipas n. 250⁵. Pas kësaj analize, rezulton se vepra penale, sipas n. 250, përbën v.p. me dy objekte, ku i pari konsiston në marrëdhëniet juridike të vendosura për mbrojtjen e veprimtarisë shtetërore dhe i dyti, në marrëdhëniet juridike për mbrojtjen e lirisë dhe paprekshmërisë së shtetasve. Nga ana tjetër, në rast pasojash të rënda në shëndet ose ndaj jetës, figura e krimit, sipas n. 250, do të duhet të konkurrojë me “plagosjen e rëndë me dashje”, “torturën” ose krimet e vrasjes.

Pasi shqyrtuam më lart dy çështje të bujshme nga vitet 2000, të na lejohet tani të bëjmë një kalim të shkurtër të praktikës gjyqësore më të fundit referuar “veprimeve arbitrare”. Kjo do t’i shërbente të kuptuarit të tendencave aktuale të shfaqjes së kësaj kategorie krimi.

Në një çështje gjyqësore⁶, tri punonjës të policisë rrugore u mbajtën përgjegjës për veprime të dhunshme me pasoja të lehta në shëndet ndaj një drejtuesi mjeti rrugor (furgon). Pasi kishin dhënë shenja të kundërta në lidhje me ndalimin e mjetit (ku njëri punonjës kishte sinjalizuar ndalimin, tjetri vazhdimin e lëvizjes), punonjësit e ndoqën me automjetin e policisë mjetin e transportit, dhe pas refuzimit të drejtuesit për të nënshkruar procesverbalin e konstatimit të shkeljes, i dhanë atij disa goditje fizike e më pas kërkuan shoqërimin e tij në polici. Ajo që bie në sy në mekanizmin e hetimit të kësaj ngjarjeje, lidhet me versionin e ndryshëm të fakteve nga punonjësit e akuzuar në raport me dëshmitë e pasagjerëve të mjetit të transportit, ku prokuroria dhe gjykata i dhanë përparësi versionit të këtyre të fundit.

Në një çështje gjyqësore⁷, një punonjës i policisë së objekteve, në orët e para të

⁴ Reagimi paraqitet i pajustificuar në kohë, nëse ndodh pasi ka pushuar dhuna e të shoqëruarit.

⁵ Për këtë të fundit parashikohet dënimi me gjobë ose me burgim deri në shtatë vjet.

⁶ Vendimi nr. 2874, datë 23.09.2016, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

⁷ Vendim dënimi me nr. 331, datë 08.02.2016, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

mëngjesit duke qenë në vendshërbim, ka fyer dhe goditur disa të rinj, të cilët më pas i kanë marrë shenjën e numrit të identifikimit, janë larguar dhe kanë paraqitur kallëzim.

Në një tjetër çështje⁸, një punonjës i patrullës së përgjithshme është dërguar nga prokuroria për gjykim, por ka marrë pafajësinë para gjykatës. Dy punonjësit e patrullës, duke qenë në shërbim në këmbë, në një aks rrugor në qendër të qytetit, kanë sanksionuar me masën e gjobës një automjet të ndaluar në rrugë në vend të gabuar. Gjatë hartimit në vend të aktit administrativ, janë kundërshtuar me fjalë dhe veprime (jo të dhunshme) nga drejtuesi i mjetit, që ka ardhur nga diku aty pranë, ku kishte ambientin e biznesit. Punonjësit kanë njoftuar patrullën ndihmëse, por me të mbërritur kjo e fundit me automjet, i kanë kërkuar të largohej, pasi drejtuesi i mjetit që do të shoqërohej, deklaronte se nuk mund ta linte mjetin të braktisur në rrugë. Me automjetin e personit që do të shoqërohej, me mjetin që drejtohej nga ky i fundit, shtetasi dhe punonjësi i patrullës së përgjithshme janë paraqitur në komisariat, ku ndaj shtetasit është zbatuar masa e shoqërimit policor. Në vijim shtetasi është marrë në përgjegjësi penale për ‘kundërshtim të punonjësit të policisë’ dhe është dënuar me vendim gjyqësor. Nëse do të bënim një koment të kësaj çështjeje, sipas rrethanave të parashtruara më sipër, rezulton se prokuroria e ka dërguar punonjësit e policisë para gjykatës kryesisht mbështetur në rrethanën se shtetasi ishte shoqëruar me mjetin e vet vetëm me praninë e punonjësit të akuzuar. Ndërsa disa rrethana të tjera të pretenduara, si veprime të parregullta të punonjësit gjatë drejtimit të mjetit nga shtetasi dhe vonesë e qëllimshme e punonjësit deri në mbërritjen në komisariat, nuk i rezultuan gjykatës.

Në një çështje gjyqësore⁹, dy punonjës të policisë janë dërguar nga prokuroria për gjykim, por kanë marrë pafajësinë para gjykatës. Punonjësit e patrullës janë paraqitur në afërsi të një lokali në orët e para të natës, për të verifikuar ndër të tjera pushimin e zhurmeve në mjedis sipas parashikimeve normative. Një shtetas që dukej se kishte konsumuar pije alkoolike, është grindur me punonjësit e lokalit dhe me punonjësit e policisë, edhe fizikisht, është larguar me të shpejtë, por është ndalur në një rrugicë nga punonjësit e policisë. Pasi është arrestuar, ekspertimi mjekoligjor ka konstatuar se ishte gjakosur në pjesë të caktuara në fytyrë (kryesisht në zonën sipër syve). Institucioni i Avokatit të Popullit, ka pretenduar se në ngjarje ka pasur edhe veprime të dhunshme policore, duke kërkuar ndjekjen penale të punonjësve të policisë. Gjatë kësaj kohe shtetasi është proceduar dhe dënuar për “kundërshtim të punonjësit të policisë”. Gjykatës që mori në shqyrtim akuzën për “veprime arbitrare”, nuk i rezultoi që dëmtimet në fytyrë shtetasit t’i jenë shkaktuar nga punonjësit e policisë, duke lënë të hapur mundësinë e përplasjes së tij me objekte rrethana gjatë largimit me të shpejtë për t’iu shmangur punonjësve në momentin e ngjarjes.

5. Të dhëna statistikore

Kemi marrë në shqyrtim të dhënat që ofron Vjetari Statistikor i Ministrisë së Drejtësisë, për një periudhë 10 vjeçare, 2006-2015.¹⁰ Duke qenë se n. 250 i Kodit, ka

⁸ Vendimi nr. 3614, datë 23.11.2016, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

⁹ Vendimi nr. 3295, datë 31.10.2016, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

¹⁰ Ministria e Drejtësisë. Vjetari Statistikor i Ministrisë së Drejtësisë, për një periudhë 10 vjeçare, 2006-2015, gjendet në faqen e e internetit:

<http://www.drejtësia.gov.al/dokumente/statistika>


Gashi, E.
« “Veprimet arbitrare” dhe “lejimi i gjendjes së paligjshme” – dy figura të veprës penale me subjekt punonjës të Policisë së Shtetit »

Policimi dhe Siguria
nr.5, 2017

për subjekt në tërësi nëpunësit publikë dhe jo ngushtësisht punonjësit e Policisë së Shtetit, të dhënat e mëposhtme nuk u referohen shprehimisht punonjësve të Policisë së Shtetit. Gjithsesi këta të fundit përbëjnë shumicën dërrmuese të rasteve.

Tabela 1

Numri i çështjeve penale të gjykuara dhe i shtetasve të dënuar për "Kryerje të veprimeve arbitrare".



Nga analiza e të dhënave rezulton se numri i çështjeve të gjykuara nuk ka tejkaluar në asnjë rast numrin 11, po ashtu si numri i të dënuarve. Mesatarja e çështjeve të gjykuara në një vit, është 6.6, ndërsa ajo e të dënuarve, është 7.9.

Referuar "Mosmarrjes së masave për të ndërprerë gjendjen e paligjshme", në përgjithësi mungojnë çështjet e shqyrtuara nga gjykatat. Përrjashtim bëjnë vetëm vitet 2012 dhe 2013, në të cilat është gjykuar nga një çështje, përkatësisht me një dhe tre të dënuar.

6. "Veprimet arbitrare" në optikën e institucionit të Avokatit të Popullit

Për të mbikëqyrur respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut gjatë ushtrimit të veprimtarisë nga administrata publike, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë¹¹ ka ngarkuar një organ të posaçëm siç është Avokati i Popullit. Gjatë viteve të ekzistencës së tij, ky organ e ka vendosur në fokus problematikën e shpërdorimeve policore, duke përdorur për këtë qëllim mjetet e hetimit administrativ që i njej ligji.¹² Në rekomandimet me karakter të përgjithshëm që ka dhënë për t'u përballur me këtë dukuri, A.P. ndër të tjera ka vënë theksin tek nevoja për trajnim nga ana psikologjike i punonjësve të policisë, me qëllim zbatimin e rregullave të sjelljes dhe etikës gjatë përbushjes së detyrave, si dhe ruajtjen e qetësisë dhe të kontrollit të veprimeve të tyre gjatë kryerjes së detyrave ligjore, edhe në rastet kur kundërshtohen verbalisht apo fizikisht nga persona të ndryshëm. Gjithashtu, është vlerësuar i nevojshëm sqarimi në mënyrë të përshtatshme i punonjësve të policisë për të drejtën e përdorimit të forcës, për të përbushur detyrën ligjore në përputhje me parimin e proporcionalitetit.¹³

Le të hidhemi në vijim në disa raste të evidentuara në veprimtarinë e institucionit të A.P.. Në vitin 2016, Avokati i Popullit evidentoi një ngjarje në të cilën dy punonjës policie u dyshuan nga ky organ për "kryerje të veprimeve arbitrare".¹⁴ Tri

¹¹ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë. Nenet 60-63.

¹² Gjatë vitit 2015 Avokati i Popullit ka paraqitur 9 rekomandime për fillimin e hetimeve ndaj punonjësve të policisë, nga të cilat 1 rast për veprën penale të "Torturës" dhe 8 raste për veprën penale të "Kryerjes së veprimeve arbitrare" – Revista Avokati i Popullit, nr. 17, f. 26.

¹³ Avokati i Popullit, nr. 5, f. 17.

¹⁴ Avokati i Popullit, nr. 18, f. 28-31.

shtetas ishin paraqitur vullnetarisht në komisariatit e policisë, për të kallëzuar ushtrimin e dhunës nga policia bashkiake gjatë një tubimi të mbajtur në parkun e Liqenit Artificial. Fillimisht ishin lënë në pritje, pa ua marrë kallëzimet, e më pas dy punonjës policie, kishin mbajtur raportet e shoqërimit, duke i izoluar shtetasit në dhomën përkatëse të shoqërimit. Motivi i raportit të shoqërimit dhe i vetë kësaj mase, qëndronte në kryerjen nga shtetasit të veprave të dhunshme ndaj punonjësve të policisë, gjatë pjesëmarrjes në tubim, të evidentuara në pamjet filmike të marra nga policia. Avokati i Popullit konstatoi shkelje në mosmarrjen e kallëzimit të shtetasve, si dhe në zbatimin e paligjshëm të masës së shoqërimit, në kushtet ku shtetasit ishin paraqitur vullnetarisht në polici. Sipas A.P., shtetasit do të mund të ishin pyetur në cilësinë e të dyshuarve; shtojmë ne - eventualisht të merrej ndaj tyre masë ndalimi apo arresti, nëse do të përmbusheshin kushtet e ligjit procedural për rëndësinë e veprës penale të dyshuar.

Në vitin 2015, Avokati i Popullit evidentoi një ngjarje në të cilën dy punonjës policie u dyshuan nga ky organ për “kryerje të veprimeve arbitrare”.¹⁵ Punonjësi i policisë kishte ndaluar një shtetas që drejtonte automjetin në gjendje të dehur, e meqë ai nuk po reagoonte, ai e ka nxjerrë me forcë nga automjeti, duke e dëmtuar në shpatull dhe duke e goditur në fytyrë. I pranishëm në distancë, ka qenë edhe zëvendësdrejtori i policisë së qarkut. Punonjësi është kallëzuar për “kryerje të veprimeve arbitrare”, ndërsa drejtuesi për “mosmarrje të masave për të ndërprerë gjendjen e paligjshme”.

Në vitin 2015, Avokati i Popullit evidentoi një ngjarje në të cilën një punonjës policie u dyshua nga ky organ për “kryerje të veprimeve arbitrare”.¹⁶ Punonjësi, në cilësinë e Shefit të Seksionit për Hetimin e Krimeve në Komisariatit e Policisë Kukës, duke reaguar së bashku me forca të tjera policore, gjatë kundërshtimit për mbajtjen e një tubimi të kundërligjshëm, kishte ushtruar dhunë ndaj organizatorit të tubimit gjatë shoqërimit si i dyshuar për disa vepra penale. Njëkohësisht, punonjësi kishte nxjerrë edhe armën e shërbimit, duke e mbushur atë.

7. Përfundime dhe sugjerime

Intensifikimi i sinjalizimeve të qytetarëve, nëpërmjet mjeteve të parashikuara nga ligji procedural penal (kallëzimeve), ose platformave digjitale të ngritura nga Ministria e Linjës dhe Policia e Shtetit, dhe një përgjegjësi e shtuar e strukturave përgjegjëse policore për t'i evidentuar dhe transmetuar këto sinjalizime, janë hapa të rëndësishëm pozitivë në goditjen e shfaqjeve të shpërdorimit të detyrës në Policinë e Shtetit.

Veprimet arbitrare, sipas n. 250 të Kodit Penal, nga pikëpamja e anës objektive, konkretizohen kryesisht në përfshirjen e punonjësve të terrenit në goditje apo dëmtime të tjera me dashje, ndaj shtetasve që i nënshtrohen shoqërimit policor apo masave shtrënguese proceduralo-penale. Nga pikëpamja statistikore, rezulton se për vitin 2015, në gjykatat e vendit janë gjithsej 6 çështje gjyqësore të gjykuara dhe po aq nëpunës publikë të dënuar nga gjykata për “Veprime arbitrare”, e në këtë numër, përfshihen edhe punonjës të Policisë së Shtetit¹⁷. Nga zhvillimi 10-vjeçar i të dhënave (2006-2015), rezulton se numri i çështjeve të gjykuara si dhe ai i të dënuarve, nuk ka tejkaluar në asnjë rast numrin 11, ndërsa mesatarja e çështjeve dhe të dënuarve për vit, është

¹⁵ Avokati i Popullit, nr. 5, f. 18-19.

¹⁶ Po aty, f. 21.

¹⁷ Dispozita e n. 250 të K.P. ka për subjekt nëpunësit publikë në tërësi, jo thjesht punonjësit e Policisë së Shtetit.

Gashi, E.
« “Veprimet arbitrare” dhe “lejimi i gjendjes së paligjshme” – dy figura të veprës penale me subjekt punonjës të Policisë së Shtetit »

Policimi
dhe
Siguria
nr.5, 2017

përkatësisht afërsisht 7 dhe 8.

Vihet re një vëmendje e veçantë, - për t'u përshëndetur, - e strukturave të institucionit të Avokatit të Popullit, mbi problematikën e shpërdorimeve policore me pasoja në të drejtat dhe liritë e shtetasve. Konstatimet dhe rekomandimet e këtij institucioni të rëndësishëm kushtetues përbëjnë një ndihmesë të çmuar për ndërgjegjësimin e shoqërisë, organizmit të Policisë së Shtetit dhe institucioneve të lidhura, mbi nevojën për parandalimin dhe goditjen e shpërdorimeve. Strukturat e Avokatit të Popullit, në ato raste kur kryejnë verifikime konkrete në terren apo mbledhin të dhëna nga institucionet, konstatojnë fakte të cilat punonjësit e dyshuar dhe strukturat rreth tyre shpeshherë mund të jenë të prirë t'i mbulojnë. Në këtë kuptim, roli i institucionit të Avokatit të Popullit është i pazëvendësueshëm, në reagimin ndaj shpërdorimeve policore.

Nga ana tjetër, vërehen në praktikën hetimore dhe gjyqësore, raste të tilla ku prokuroria priret nga marrja si të mirëqenë, çdo rast të konstatimeve dhe rekomandimeve të institucionit të Avokatit të Popullit, p.sh. duke përcaktuar përgjegjësinë penale të punonjësve të dyshuar të policisë, nëpërmjet dërgimit të tyre për gjykim për "veprime arbitrare". Mendojmë se të dhënat që ofrohen nga Avokati i Popullit, do të duhet të hetohen nga prokuroria me mjetet që parashikon ligji procedural penal, pa e shndërruar në veprim rutinë dërgimin e çështjes para gjykatës. Sigurisht, që për shpërdorimet policore, nëse ka të dhëna fillestare për paligjshmëri penale, do të duhet të kryhen hetime të plota, duke mbajtur parasysh edhe cenimin e reputacionit dhe integritetit profesional që do të shkaktonin për punonjësit përfundime jo të peshuara drejt nga institucioni i akuzës.

Duhet theksuar mungesa e procedimeve penale, për veprën penale të "Mosmarrjes së masave për të ndërprerë gjendjen e paligjshme", sipas n. 251 të Kodit Penal. Nëpërmjet informacionit dhe raportimit nga punonjës të policisë, që janë në marrëdhënie paralele/eprove/vartëse, me punonjës të përfshirë në veprime arbitrare, lufta kundër këtyre shfaqjeve të shpërdorimit të detyrës në Policinë e Shtetit, do të merrte nxitje të nevojshme. Në shumicën dërrmuese të rasteve, veprimet arbitrare, qofshin këto të kryera në terren apo qoftë edhe në ambiente policore, lënë gjurmë të mjaftueshme. Veçanërisht, në rastet kur veprimet arbitrare i sjellin efektet e tyre për një kohë jo të shkurtër, apo kur punonjësi i policisë, gjatë kryerjes së veprimeve ka qenë i shoqëruar nga të tjerë punonjës, prokuroria do të duhet të konstatojë indicjet përkatëse që do të shërbenin më tej, si bazë për ngritje të akuzës për "Mosmarrje të masave për të ndërprerë gjendjen e paligjshme".

Gashi, E.

« Veprimet arbitrare » dhe "Iejimi i gjendjes së paligjshme" - dy figura të veprës penale me subjekt punonjës të Policisë së Shtetit »

Policimi dhe Siguria nr.5, 2017

Bibliografi

1. *Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.*
2. *Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë.*
3. Ministria e Drejtësisë, *Vjetarët Statistikorë për vitet 2006-2015*, në faqen internet: <http://www.drejtesia.gov.al/al/dokumente/statistika>.
4. *Avokati i Popullit*, nr. 5, 17, 18
5. Elezi, Ismet. *E Drejta Penale. Pjesa e Posaçme*. Tiranë, 2007.
6. *Vendimi nr. 3614*, datë 23.11.2016, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
7. *Vendimi nr. 3295*, datë 31.10.2016, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
8. *Vendimi nr. 2874*, datë 23.09.2016, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
9. *Vendimi nr. 331*, datë 08.02.2016, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
10. *Vendimi nr. 374*, datë 02.07.2004, i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.
11. *Vendimi nr. 82*, datë 17.03.2003, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.

Gashi, E.

« “Veprimet arbitrarë” dhe “lejimi i gjendjes së paligjshme” – dy figura të veprës penale me subjekt punonjës të Policisë së Shtetit »

Policimi
dhe
Siguria
nr.5, 2017

“Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat”, në sfidën e faktorit të mbikëqyrjes së jashtme civile



■ **MSc Arben Skëndo**
Drejtori i SHÇBA-së

Abstrakt

Në këtë punim trajtohet evoluimi, reformimi dhe roli i “Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat” (SHÇBA), si një aktor i rëndësishëm i rjetit të institucioneve të mbikëqyrjes dhe kontrollit të jashtëm civil, në luftën kundër korrupsionit policor. Të gjitha ndryshimet që ka pësuar Shërbimi, pasqyrojnë stadet e zhvillimit nëpër të cilat ka kaluar vetë shoqëria jonë, ato janë pasqyrë e ndryshimeve dinamike që kanë ndodhur në Policinë e Shtetit, në strategjitë dhe objektivat e Ministrisë së Brendshme, duke ruajtur koherencën me objektivat strategjikë dhe synimet e shpalosura nga qeveritë shqiptare ndër vite. Në këtë punim jepen parimet mbi të cilat organizohet dhe ushtron veprimtarinë SHÇBA, hartimi dhe standardizimi i të cilave, është bërë në përputhje të plotë me normat e rregullat e parashikuara në legjislacionin ndërkombëtar, në fushën e etikës dhe të sjelljes policore, parandalimit dhe luftës së korrupsionit, e në veçanti të atij policor. Edhe pse lufta ndaj korrupsionit dhe keqsjelljes policore është një proces i gjatë dhe i vazhdueshëm dhe, ka nevojë të konceptohet në radhë të parë si përgjegjësi e vetë Policisë së Shtetit, vendi që zë dhe roli që luan SHÇBA-ja, është shumë i rëndësishëm. Duke qenë se në strategjinë qeverisëse për sigurinë kombëtare, lufta ndaj korrupsionit, në çdo formë të shfaqjes së tij, është përcaktuar si prioritet dhe konsiderohet si një fenomen me rrezikshmëri të lartë shoqërore, nisur nga rëndësia e rolit të tij dhe për të qenë në lartësinë e pritshmërive në përmbushje të detyrave të ngarkuara, Shërbimi iu nënshtrua reformave të thella legjislative, strukturore dhe organizative, me synimin për t’u bërë, krahas organizmave të tjerë mbikëqyrëse, një agjenci e mbikëqyrjes së jashtme civile sa më efektive, në parandalimin dhe luftën ndaj çdo fenomeni korruptiv në Policinë e Shtetit. Në punim jepen me hollësi ndryshimet që ka pësuar Shërbimi si në zgjerimin e fushës së zbatimit të ligjit, ashtu edhe në zgjerimin e objektit të veprimtarisë së tij. Gjithashtu jepen ndryshimet strukturore dhe organizative si domosdoshmëri dhe në përputhje me ndryshimet ligjore. Në fund të punimit jepen disa nga synimet e Shërbimit për rritjen dhe forcimin e kapaciteteve të mbikëqyrjes së jashtme policore, për konsolidimin e pozicionit të tij si një faktor i rëndësishëm në zinxhirin e aktorëve që përbëjnë sistemin e mbikëqyrjes së jashtme policore, rritjen e bashkëpunimit me strukturat e Policisë së Shtetit, rritjen e kapacitetit profesional të burimeve njerëzore të Shërbimit etj.

Skëndo, A.
« Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat », në sfidën e faktorit të mbikëqyrjes së jashtme civile »

Policimi dhe Siguria
nr.5, 2017

Fjalëkyçe:

SHÇBA, Institucione të mbikëqyrjes, kontrolli i brendshëm, reforma ligjore, mbikëqyrja civile.

1. Hyrje

Nga dita e krijimit të tij e deri më sot, Shërbimi ndër vite, me ndryshimet që ka pësuar ka krijuar historikun e tij. Më duket me interes për lexuesin që në fillim të këtij shkrimi të paraqes shkurtimisht disa nga momentet e rëndësishme të historikut të ndryshimeve që ka pësuar ky Shërbim. Të gjitha ndryshimet që ka pësuar ky Shërbim janë pasqyrë e stadeve të zhvillimit të vetë shoqërisë tonë, pasqyrë e ndryshimeve dinamike të ndodhura në Policinë e Shtetit, në strategjinë dhe objektivat e Ministrisë së Brendshme dhe në përputhje me objektivat strategjike dhe synimet e shpalosura nga qeveritë shqiptare ndër vite. Shërbimi i ka fillesat e ekzistencës së tij, në vitin 1991, i krijuar me Ligjin nr. 7530, datë 11.12.1991 “Për organizimin e Shërbimit Informativ Ushtarak dhe të Shërbimit të Kundërzbulimit në Organet e Rendit Publik”¹, i ndryshuar. Me këtë ligj, Shërbimi funksionoi si një strukturë informativo-gjurmuese, në varësi të Ministrisë së Rendit Publik, me objekt të punës sigurimin e të dhënave për zbulimin, parandalimin e ndërprerjen e veprimtarisë antikushtuese dhe kriminale në organet e Rendit Publik e repartet e tyre, pa pasur kompetenca hetimore, pra, siç shihet, duke pasur vetëm kompetenca të pastra informative.

Në këtë ligj, Shërbimi e mbështeti veprimtarinë e tij deri në vitin 2001, ku si pasojë e ndryshimeve dinamike sociale e shoqërore, lindi si domosdoshmëri që këto ndryshime të reflektoheshin edhe në veprimtarinë e Shërbimit. Këto ndryshime u reflektuan më së miri në Ligjin nr. 8749, datë 1.3.2001 “Për Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm në

Skëndo, A.
« Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat », në sfidën e faktorit të mbikëqyrjes së jashtme civile »

Policimi dhe Siguria
nr.5, 2017

¹ Ligji nr. 7530, datë 11.12.1991 “Për organizimin e Shërbimit Informativ Ushtarak dhe të Shërbimit të Kundërzbulimit në Organet e Rendit Publik” i ndryshuar, nenet 1 dhe 4, f.11.

Ministrinë e Rendit Publik, (SHKB)”, ku shërbimi operon si një strukturë e veçantë policore, unike dhe e pavarur, në varësi direkt të Ministrisë të Brendshme dhe ku, për herë të parë, veprimtaria e tij, nga karakteri informativ zgjerohet edhe në atë të hetimit paraprak dhe ushtrimin etributeve të policisë gjyqësore².

Në vitin 2008, Shërbimi pati të tjera ndryshime me miratimin e Ligjit nr. 10 002, datë 6.10.2008, “Për Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm, në Ministrinë e Brendshme” duke iu nënshtruar një reformimi administrativ, operacional e menaxherial, duke siguruar pavarësinë e duhur nga strukturat që mbikëqyr dhe kontrollojnë. Ky ligj i zgjeroi akoma më shumë kompetencat e Shërbimit, me ato inspektuese³, krahas atyre informative dhe hetimore.

Nga viti 2014 e në vazhdim, Shërbimi e mbështet veprimtarinë e tij në Ligjin nr. 70/2014 “Për Shërbimin për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, në Ministrinë e Punëve të Brendshme”, me kompetenca informative, hetimore, inspektuese dhe hetimore administrative të ankesave, kryerje testi të integritetit,tribute të policisë gjyqësore për personelin me grada e pa grada të Shërbimit dhe me analiza risku e rekomandime përkatëse, duke reflektuar në këtë mënyrë, realitetet e reja të ndryshimeve dinamike, jo vetëm të organizatës së policisë, por edhe të ndryshimeve sociale e shoqërore të shoqërisë tonë.

2. Parimet e organizimit të SHÇBA-së

Në fillim, dua të parashtroj shkurtimisht disa elementë të sistemit apo modelit më të pranuar dhe më të zbatueshëm, në dekadat e fundit, në vendet më të zhvilluara të Bashkimit Europian, Shteteve të Bashkuara të Amerikës e Britanisë së Madhe, parimet e të cilit i ka adaptuar edhe SHÇBA-ja. Që nga viti 2006, Shërbimi ynë është pjesë e EPAC (Partnerët Europian Kundër Korrupsionit), një rrjeti i pavarur, jopolitik që përfshin më shumë se 80 autoritete antikorrupsion dhe organizma të mbikëqyrjes së jashtme policore të shteteve anëtarë të Bashkimit Europian dhe vendeve anëtare të Këshillit të Europës, të interesuar në mbikëqyrjen e pavarur policore dhe në parandalimin e luftën kundër korrupsionit⁴ dhe nga viti 2009, është anëtar me të drejta të plota i këtij organizmi. Qëllimi i këtij rrjeti, është shkëmbimi i praktikave më të mira në fushën e mbikëqyrjes së jashtme policore dhe në zhvillimin e strategjive të përbashkëta në parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit. Të qenit pjesë e këtij rrjeti, na ka mundësuar të njihemi nga afër me praktikat më të mira të realizimit të mbikëqyrjes së jashtme policore, në vende si, Britania e Madhe, Belgjika, Franca, Irlanda, Norvegjia, Spanja e Suedia, prej të cilave janë hartuar dhe miratuar parimet dhe normat standarde të organizmave të mbikëqyrjes së jashtme policore sot, në BE e më gjerë.

Hartimi i parimeve të mbikëqyrjes së jashtme policore nga vendet pjesëtarë të rrjetit të EPAC dhe standardizimi i tyre, ka ardhur si domosdoshmëri dhe rezultat i ndryshimeve politike, sociale dhe kulturore që kanë influencuar në politikat qeverisëse të këtyre vendeve, veçanërisht në pavarësinë e funksionimit të organizmave të mbikëqyrjes së jashtme policore. Ato janë reflektimi koherent i asaj ç’ka ndodhur në

Skëndo, A.
« Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat », në sfidën e faktorit të mbikëqyrjes së jashtme civile »

Policimi dhe Siguria
nr.5, 2017

² Ligji nr. 8749, datë 01.03.2001 “Për Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm, në Ministrinë e Rendit Publik”, nenet 3 dhe 4, f.1.

³ Ligji nr. 10 002, datë 06.10.2008 për “Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm, në Ministrinë e Brendshme”, gërma “b”, neni 3 dhe nenet 28-33, f.11, f.11-13.

⁴ www.epac-eacn.org – constitutions of EPAC/EACN

vitet e fundit me kompetencat e dhëna oficerëve të policisë dhe zyrtarëve të agjencive të tjera ligjzbatuese së bashku, për të luftuar krimin e organizuar, korrupsionin dhe terrorizmin. Por duhet theksuar se ashtu siç janë rritur kompetencat e policisë, në po të njëjtën shkallë janë rritur edhe pritshmëritë ndaj shërbimeve policore, të cilat do të duhet të veprojnë konform principeve të demokracisë, llogaridhënies dhe respektimit të së drejtave të njeriut. Gjithashtu, hartimi dhe standardizimi i këtyre parime është bërë në përputhje të plotë me normat e rregullat e parashikuara në legjislacionin ndërkombëtar në fushën e etikës dhe të sjelljes policore, parandalimit dhe luftës së korrupsionit, në veçanti të korrupsionit policor. Parimet bazë mbi të cilat mbështeten organizmat e mbikëqyrjes së jashtme policore në shoqëritë e hapura dhe demokratike, dhe si i tillë edhe SHÇBA, mbështetet në parime të përpunuara dhe të miratuara nga vendet anëtare të Partnerëve Evropianë Kundër Korrupsionit, siç janë⁵:

1. parimi i krijimit të organizmit të mbikëqyrjes së jashtme policore mbi bazë të një ligji organik;
2. parimi i pavarësisë institucionale dhe financiare nga struktura(t) që mbikëqyr;
3. parimi i ushtrimit të kompetencave inspektuese dhe hetimore, duke forcuar kapacitetet e këtyre organeve për të zbatuar politikant antikorrupsion;
4. parimi i të drejtës së aksesit tek informacioni, esenciale për institucionet e mbikëqyrjes së jashtme në mënyrë që të rishikojnë aktivitetin e policisë në mënyrë efektive dhe të japin rekomandimet detyruese;
5. parimi i krijimit të një sistemi ankimi të aksesueshëm nga publiku dhe informimi i ankuesit për zgjidhjen e kërkesës së tij;
6. parimi i transparencës dhe raportimit mbi arritjet dhe veprimtarinë e organeve të mbikëqyrjes së jashtme të aksesueshme nga publiku;

Implementimi dhe zbatimi i këtyre parimeve, synon të promovojë: standarde më të larta të policimit; respektimin e ligjit dhe të drejtave të njeriut në të gjitha aktivitetet policore; besim të publikut tek policimi; sistem të qartë llogaridhënie për oficerët e policisë dhe zyrtarët e agjencive të tjera ligjzbatuese; transparencë dhe të kuptuarit e policimit nga qytetarët; sisteme për të siguruar që janë nxjerrë mësim nga incidentet dhe gabimet; respekt për ligjin, policimin dhe si konsekuencë, reduktimin e kriminalitetit dhe sigurimin e rendit publik.

Modeli që kemi zgjedhur, pra ai i kontrollit dhe mbikëqyrjes nga jashtë i strukturave të policisë, mund të themi se ka natyrë profilaktike pasi ka të bëjë jo thjesht dhe vetëm me monitorimin dhe shqyrtimin e sjelljes dhe performancës së policisë, por edhe me përcaktimin e diagnozës dhe mandej edhe dhënien e rekomandimeve dhe marrjen e masave për eliminimin në radhë të parë të shkaqeve dhe indikatorëve që çojnë në keqsjellje. Por jo vetëm kaq, sepse gjatë këtij procesi, Shërbimi evidenton dhe stimulon edhe anët pozitive në sjelljen e policisë - që fatmirësisht, të tilla ka shumë dhe, - që propagandimin dhe stimulimin e saj, e konsiderojmë si një mjet efikas edukues dhe ndërgjegjësues në përmirësimin e sjelljes së policisë. Lufta ndaj korrupsionit dhe keqsjelljes policore është një proces i gjatë dhe i vazhdueshëm dhe ka nevojë që të konceptohet, në radhë të parë, si përgjegjësi e vetë Policisë së Shtetit. Këtij procesi i shërben dhe, kontribuon me mjetet e mundësitë e saj ligjore edhe SHÇBA-ja, qëllimi i së cilës është parandalimi i keqsjelljes policore dhe kontributi në përmirësimin e vazhdueshëm të

Skëndo, A.
« Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat », në sfidën e faktorit të mbikëqyrjes së jashtme civile »

Policimi dhe Siguria
nr.5, 2017

⁵ The European Partners against Corruption. *Parimet e organizmave të mbikëqyrjes së jashtme policore*. Gjetend në faqen e internetit: www.epac.org

shërbimit që policia i ofron publikut; rritja e besimit dhe partneriteti me policinë, me synimin final pasjen e një policie moderne dhe demokratike në shërbim të qytetarëve. Në të njëjtën kohë, sa shprehëm më sipër janë qëllimet dhe synimet e Shërbimit tonë, por ne nuk jemi aktorët e vetëm për arritjen e tyre.

“Duke qenë se punonjësit e policisë janë të ngarkuar me përgjegjësi kaq të rëndësishme në shoqërinë tonë, është e nevojshme që sjellja e tyre të mbahet nën mbikëqyrje” pasi profesionin e tyre shpesh e konsiderojmë si *“profesion të rrezikshëm moralisht”*.⁶

Nisur nga kjo, që ky sistem apo model të funksionojë me efikasitet e eficiencë duhet që të kryejnë e të përmbushin rolin e funksionet e tyre mbikëqyrëse edhe aktorët e tjerë në përbjeje të sistemit dhe, konkretisht: ekzekutivi, parlamenti, gjyqësori, institucionet e specializuara (si SHÇBA), hetimet ‘ad hoc’, organizatat e shoqërisë civile dhe mediet. Gërshetimi i funksioneve proaktive dhe reaktive të mbikëqyrjes së jashtme, të ushtruar nga aktorët e sipërcituar ndaj strukturave të policisë, ndihmojnë dhe ndikojnë në identifikimin, zbulimin e ndëshkimin e praktikave korruptive dhe, jo vetëm, në polici nga njëra anë, por edhe në identifikimin e adresimin e faktorëve sistematikë që çojnë në korrupsion si dhe në zgjidhjen e tyre me anë të legjislacionit, politikave dhe menaxhimit. Jo pa qëllim, parashtruar si parantezë të këtij shkrimi, kuptimin, qëllimin, aktorët e funksionet kryesore të gjithsecilit në modelin/sistemin e mbikëqyrjes së jashtme civile të policisë, por për të rreshtuar njëra pas tjetres arsyet dhe domosdoshmërinë e reformimit të SHÇBA-së.

Së pari, reformimi lidhet drejtpërsëdrejti me vizionin dhe objektivat strategjikë të qeverisë shqiptare dhe angazhimeve konkrete të Ministrisë së Punëve të Brendshme, për reformimin e agjencive ligjzbatuese në vend, të fokusuar në:

- realizimi i një reforme themelore shumëdimensionale për të rikthyer sigurinë dhe garantimin e rendit publik, të jetës shoqërore dhe të zhvillimit të sipërmarrjes në Shqipëri, si dhe përmbushjen e angazhimeve tona rajonale e ndërkombëtare;
- zbatimimi i një programi konkret për reformimin e thellë të Policisë së Shtetit dhe agjencive të tjera ligjzbatuese për (i) përmbushjen e standardeve më të larta të funksionimit demokratik, transparent, të kontrollueshëm dhe llogaridhënës ndaj qytetarëve, (ii) vënien në zbatim të një modeli pune të bazuar rigorozisht te zbatimimi i ligjit, përgjegjësitë, kompetencat, procedurat e veprimtarisë së Policisë së Shtetit dhe agjencive të tjera ligjzbatuese, si dhe, (iii) konsolidimi i marrëdhënieve me institucionet e pavarura dhe bashkëpunimin intensiv me partnerët ndërkombëtarë e ndërveprimin policor rajonal dhe ndërkombëtar.

Së dyti, gjendja juridike dhe perceptimet mbi Shërbimin. Për sa i përket ekspertizës së jashtme dhe të brendshme, nga vlerësimet e bëra, evidentuan disa probleme, që shihen si më poshtë.

a. Ekspertiza e brendshme:

- nivele minimale të zbulueshmërisë dhe forcës goditëse ndaj veprimtarisë së kundërligjshme të kryer nga punonjës policie;
- mungesë të hetimeve proaktive dhe rekomandimeve për strukturat e Policisë së Shtetit;
- marrja dhe trajtimi i ankesave të publikut i lënë jashtë vëmendjes së veprimtarisë së Shërbimit si nga ana organizative, ashtu edhe funksionale;
- mungesa e instrumenteve ligjore për matjen reale të performancës policore dhe

Skëndo, A.
« Shërbimi
për Çështjet
e Brendshme
dhe Ankesat »,
në sfidën
e faktorit të
mbikëqyrjes së
jashtme civile »

Policimi
dhe
Siguria
nr.5, 2017

⁶ Forcimi i integritetit policor në Shqipëri, Tiranë 2015: Instituti për Demokraci e Ndërmjetësim, f. 5.
Gjendet i publikuar në faqen e internetit:
<http://idmalbania.org/wp-content/uploads/2015/12/Integriteti-PolicorSHTYP.pdf>

mospërcaktimin e rolit proaktiv të strukturës së inspektimit të Shërbimit.

b. Ekspertiza e jashtme – identifikuar nga partneri më i ngushtë, ICITAP-i.

- Ngarkesë pune në nivele tepër të ulëta, për një Shërbim si SHÇBA-ja dhe, pa të njëjtin sukses si agjencitë e tjera të mbikëqyrjes policore, në vendet e tjera të rajonit apo më gjerë. Kështu, gjatë vitit 2012 e periudhës janar-gusht 2013, Shërbimi ka ndjekur 1.4 çështje penale për çdo specialist.

Së treti, si detyrime që rrjedhin nga proceset integruese të vendit tonë për aderimin në Bashkimin Europian, ku ndër të tjera është edhe implementimi dhe zbatimi i parimeve të organizmave të mbikëqyrjes së jashtme policore sipas parimeve të EPAC, ku Shërbimi ynë është anëtar me të drejta të plota i këtij rrjeti.

3. Reforma ligjore dhe organizative - risitë e saja

Reformimi i kuadrit ligjor. “. . . Kontrolli i shtetit mbi policinë, në një shoqëri të hapur demokratike, duhet të kompletohet me mjete që mundësojnë përgjegjshmërinë e policisë tek publiku, që janë qytetarët dhe përfaqësuesit e tyre. Llogaridhënia policore përballë publikut është kusht kyç, për ta bërë marrëdhënien reciproke midis policisë dhe publikut, një realitet. Llogaridhënia mund të jetë direkt ose e kanalizuar, nëpërmjet organizmave që përfaqësojnë publikun. . .”⁷

Këtij qëllimi i shërben edhe reformimi ligjor i SHÇBA-së, i cili synon që të sjellë ndryshime thelbësore në veprimtarinë e tij. Reforma ligjore konsiston në miratimin e ligjit nr. 70/2014 për “Shërbimin për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat”, në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe implementimi i tij nëpërmjet hartimit dhe miratimit të një pakete prej 24 aktesh nënligjore, si VKM, urdhra e udhëzime, etj.⁸

Ndryshimet që solli miratimi i ligjit dhe i paketës së akteve nënligjore që e shoqërojnë atë, çuan në:

- Zgjerimin e fushës së zbatimit të ligjit⁹ tashmë jo vetëm ndaj Policisë së Shtetit, por edhe ndaj Gardës së Republikës dhe strukturave të PMNZSH.

- Zgjerimin e objektit të veprimtarisë,¹⁰ duke përfshirë përveç inspektimit dhe hetimit, edhe trajtimin e shqyrtimin e ankesave të publikut, ruajtjen e integritetit të punonjësve të strukturave, kontrollin e pasurisë së pajustificuar të punonjësve dhe analiza e rekomandime ndaj strukturave.

- Vendosjen në qendër të veprimtarisë së Shërbimit të trajtimit dhe shqyrtimit të ankesave, pasi konsiderojmë që: “Një sistem i pavarur dhe efektiv i ankesave është esencial për të siguruar dhe ruajtur besimin dhe konfidencën e publikut tek policia dhe do të shpërbëjë si një mbrojtje kryesore kundër keqtrajtimit dhe keqsjelljes. Një organizëm i pavarur i ankesave të policisë, duhet të formojë një pjesë kryesore (boshti) e një sistemi të tillë. . .”¹¹

- Risi në fushën e procedurave, duke normuar veprimtarinë informative sipas procedurave të miratuara dhe kontrolluara nga Prokurori¹².

- Hetimin (atributet e oficerit të policisë gjyqësore) si kompetencë e re e strukturës

⁷ Kumtesa e Komitetit të Ministrave, shteteve anëtare mbi nenin 59 të Kodit të Etikës Policore, miratuar në 19 shtator 2011.

⁸ Fletore zyrtare nr. 124, datë 08.09.2014, ligji nr. 70/2014 për “Shërbimin për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, në Ministrinë e Punëve të Brendshme”.

⁹ Ligji nr. 70/2014 për “Shërbimin për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, në Ministrinë e Punëve të Brendshme”, neni 2, f. 1.

¹⁰ Ligji nr. 70/2014 për “Shërbimin për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, në Ministrinë e Punëve të Brendshme”, neni 5, f. 2.

¹¹ Këshilli i Europës, *Opinion i Komisionerit të Këshillit të Europës për të Drejtat e Njeriut* (12 mars 2009).

Skëndo, A.
«Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat», në sfidën e faktorit të mbikëqyrjes së jashtme civile»

Policimi dhe Siguria nr.5, 2017

së inspektimit¹³.

Krahas zgjerimit të fushës së zbatimit të ligjit dhe zgjerimit të objektit të veprimtarisë së Shërbimit, reformimi ligjor solli edhe domosdoshmërinë e ndryshimeve organizative dhe strukturore të tij. Me këto ndryshime bëmë të mundur:

- ngritjen e “Sektorit të inspektimit të ankesave”, “Zyrës së pritjes së qytetarëve” dhe rivendosjes në funksionim, të linjës së gjelbër: 0 80 90 90, në funksion të vendosjes së urave të komunikimit mes Shërbimit dhe publikut, rritjes dhe forcimit të bashkëpunimit dhe bashkëveprimit shërbim-publik;

- organizimin e strukturave të drejtimit të hetimit, në nivel qendror dhe vendor, në funksion të rritjes së cilësisë dhe numrit të hetimeve proaktive dhe njëkohësisht forcës zbuluese dhe goditëse të veprimtarisë së kundërligjshme;

- ngritjen e zyrës së intervistimit për strukturat e hetimit, me pajisje bashkëkohore, me ndihmën e ICITAP-it;

- krijimin e sektorit të monitorimit të brendshëm/sigurimit të personelit, në funksion të vetëkontrollit brenda radhëve të Shërbimit;

- krijimin e “Zyrës së testit të integritetit”, me qëllim aplikimin e procedurave dhe metodave të parashikuara në “Manualin mbi procedurat dhe metodat e kryerjes së testit të integritetit”;

- reformimin në mentalitet dhe kapacitete të burimeve njerëzore, nëpërmjet rekrutimit gjithnjë e në rritje në numër të personelit me sfond arsimor e profesional jurist;

- ndryshueshmërinë gjinore, duke rritur në përqindje të konsiderueshme numrin e punonjësve femra në Shërbim, në 20 % të totalit të personelit;

- trajtimin më të mirë buxhetor e financiar të punonjësve të Shërbimit;

- zgjerimin dhe forcimin e marrëdhënieve me Shërbimet homologe të rajonit, si ato të Maqedonisë dhe Kosovës, përmes nënshkrimit të memorandumeve të bashkëpunimit në fushën e shkëmbimit të informacionit dhe kryerjes së operacioneve të përbashkëta;

- zgjerimin dhe forcimin e bashkëpunimit me agjencitë e tjera ligjzbatuese në vend, shërbimet informative, prokurori, pushtet vendor, por në veçanti me strukturat qendrore e vendore të Policisë së Shtetit, kryesisht në fushën e shkëmbimit reciprok të informacionit, kryerjes së operacioneve të përbashkëta apo në fushën e edukimit, trajnimit dhe ngritjes profesionale.

Të gjitha ndryshimet reformuese ligjore, organizative dhe strukturore, kanë si synim të fundit, ruajtjen e integritetit policor dhe për arritjen e këtij synimi po punojmë shumë, që më parë të rrisim performancën profesionale të punonjësve të Shërbimit e si rrjedhojë, rritjen e besimit të publikut, por edhe të Policisë së Shtetit, ndaj shërbimit tonë. Rritja e integritetit profesional e moral të punonjësve të shërbimit do të bëjë që perceptimi i mosndëshkueshmërisë së shkeljeve ligjore të çrrënjoset nga kultura jonë.

Të gjithë duhet të pranojmë se “*zbulimi i korrupsionit nga strukturat përkatëse brenda policisë, nuk përbën domosdoshmëri provë të menaxhimit të keq apo problemeve të integritetit. Përkundrazi, hetimet dhe evidentimi i rasteve të korrupsionit dhe keqsjelljes mund të konsiderohen si provë se sistemi po punon dhe se problemi po trajtohet, përpara se ai të degradojë më keq*”¹⁴.

Në punën tonë të përditshme, në bashkëpunim të frytshëm edhe me vetë strukturat policore, kemi synuar dhe synojmë jo vetëm evidentimin dhe parandalimin e veprimeve

¹² Ligji nr. 70/2014 për “Shërbimin për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, në Ministrinë e Punëve të Brendshme”, pika 3, neni 37, f. 13.

¹³ Ligji nr. 70/2014, për “Shërbimin për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, në Ministrinë e Punëve të Brendshme”, pika 2, neni 62, f. 21.

korruptive, si shfaqje e veseve dhe problemeve individuale të integritetit të punonjësve të caktuar, qasje kjo që njihet në literaturë si teoria e “mollës së kalbur”, por duke shkuar përtej kësaj metafore, në atë që shumë studiues e konsiderojnë korrupsionin policor si pasqyrim të kulturës dhe sjelljes së grupit/forcës policore. Rrjedhimisht, metafora e “mollës së kalbur” është zgjeruar në “arka e prishur” për të përfshirë devijimin nga normat dhe etikën në nivel grupi.

Sipas Komisionerit për reformën në Departamentin e Policisë së Nju York-ut, Patrick Murphy “... teoria e (mollës së kalbur) nuk funksionon më. Oficerët e korruptuar të policisë nuk janë kriminelë të lindur apo njerëz me vese morale) thelbësisht të ndryshëm nga kolegët e tyre të ndershëm. Detyra e kontrollit të korrupsionit kërkon që të ekzaminohet arka dhe jo vetëm mollët, organizata dhe jo thjesht individët brenda saj, sepse policët e korruptuar bëhen të tillë - nuk lindin”¹⁵.

Përveç sa më lart, të gjitha këto ndryshime dhe masa synojnë edhe çrrënjosjen e kulturës së heshtjes brenda organizatës policore dhe zëvendësimin e saj me një kulturë e cila e konsideron “mbylljen e njërës sy” ndaj shkeljeve po aq korruptive sa përfshirja aktive në korrupsion dhe në të njëjtën kohë, vlerëson profesionalizmin, punonjësit e përkushtuar dhe me integritet.

“Ndërtimi dhe forcimi i kulturës së integritetit, e cila nuk toleron asnjë formë të sjelljes negative policore është një aspekt i rëndësishëm në rrugën e demokratizimit të policisë”.¹⁶

Pjesë e rëndësishme e këtyre proceseve reformuese është edhe ndryshimi dhe çrrënjosja përfundimtare e mendimeve apo perceptimeve, që më së shumti vihet re në persona civilë dhe të përfunduar, por që për fat të keq ekzistojnë edhe brenda organizatës së Policisë, megjithëse në pakësim të vazhdueshëm, që e konsiderojnë Shërbimin si pjesë të strukturave policore, të integruara në këto struktura dhe, rrjedhimisht, që ndikojnë në veprimtarinë e tij. Shërbimi jo vetëm që nuk është pjesë e strukturave të Policisë, por është shkëputur plotësisht prej saj, duke mos u bërë palë me të e pjesëtare e “komisioneve emërtuese” të ecurisë në karrierë e gradë të personelit të policisë. Kjo është tërësisht një procedurë e brendshme e strukturave të policisë, e rregulluar më së miri me ligjin e Policisë së Shtetit dhe akteve nënligjore në zbatim të tij. Prandaj, ky perceptim është mjaft i gabuar dhe i dëmshëm për Shërbimin, pasi duke e trajtuar atë si pjesë të strukturave policore, barazohet objekti i veprimtarisë së Shërbimit me atë të Policisë së Shtetit, njehsohet performanca e tij me atë të strukturave policore dhe për pasojë duke ndikuar në besueshmërinë e publikut ndaj tij, në ofrimin e një shërbimi të paanshëm dhe transparentë. Shërbimi si pjesë e organizmave të mbikëqyrjes së jashtme civile, nuk është pjesë e administratës apo strukturave policore.

Ligji 70/2014 “Për Shërbimin për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Punëve të Brendshme” e ka të shprehur qartë dhe pa ekuivoke në nenin 8 të tij se: “Shërbimi është person juridik publik, strukturë e veçantë e Ministrisë së Punëve të Brendshme, në varësi të drejtpërdrejtë të ministrit”, dhe një nga parimet bazë në të cilat organizohet dhe funksionon Shërbimi, është “pavarësia nga strukturat, ndaj të cilave ushtron veprimtarinë e tij”¹⁷. Shërbimi ka buxhetin e vet, i cili është zë më vete në

¹⁴ Forcimi i integritetit policor në Shqipëri, Tiranë 2015: IDM, f. 18-19.

Gjendet elektronikisht në: <http://idmalbania.org/wp-content/uploads/2015/12/Integriteti-PolicorSHTYP.pdf>

¹⁵ Branko Lobjan & Gorazd Mesko (2015) “Perception of Police Corruption and the Level of Integrity among Slovenian Police Officers”, *Police Practice and Research, An International Journal*, 16:4, f. 343.

¹⁶ Sanja Kutnjak Ivkovic & Tara O’ Connor Shelley (2007) “Police Integrity and the Czech Police Officers”, *International Journal of Comparative and Applied Criminal Justice*.

¹⁷ Ligji nr. 70/2014 për “Shërbimin për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, në Ministrinë e Punëve të Brendshme”, neni 6, germa “b”, f. 3.

Skëndo, A.

“Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat”, në sfidën e faktorit të mbikëqyrjes së jashtme civile”

Policimi dhe Siguria
nr.5, 2017

buxhetin e ministrisë¹⁸, ka stemën dhe simbolet e saj¹⁹.

Shërbimi ka pasur dhe mban marrëdhënie bashkëpunuese me Policinë e Shtetit vetëm në rrugë institucionale. Policia e Shtetit informohet në mënyrë të vazhdueshme dhe të pandërprerë nga Shërbimi, nëpërmjet raporteve të përfundimit të inspektimeve në strukturat policore, nëpërmjet konstatimeve të dala nga kontrollet që kryhen nga Shërbimi, rekomandimeve të nxjerra nga analizat e kujdesshme mbi indikatorët negativë që lindin dhe që ushqejnë fenomenet negative apo shkaqet e mangësive të konstatuara, me qëllim që organizata e Policisë të marrë masat, me mjetet dhe mënyrat e saj, të vetërregullojë mangësitë apo të krijojë antikorpe, për t'u bërë bllok fenomeneve negative dhe të mbajë të pastër organizatën e saj. Drejtimi dhe shërbimi me integritet është kusht themelor për policimin e udhëhequr nga rregullat dhe parimet, jashtë çdo forme arbitrariteti, abuzimi me detyrën, sjelljeje të keqe apo korrupsioni. Pozitiviteti i këtij reformimi ligjor, organizativ dhe strukturor i Shërbimit reflektohet më së miri në treguesit statistikor krahasimor në të dyja fushat në hetimin administrativ dhe hetimin penal, të arritura në këto tre vite, konkretisht:

HETIMI ADMINISTRATIV - VITET 2013 - 2016²⁰


Periudha	Inspektime të planifikuara	Inspektime të paplanifikuara ²¹	Ankesa	Linja e gjelbër (0800 90 90)
2013 - 2016	32	148	2545	11739

Masa administrative (filluar ecuria disiplinore) mbi bazën e hetimit administrativ dhe atij penal: 572 masa disiplinore nga struktura e Drejtorisë së Standardeve Profesionale, Policia e Shtetit.

HETIMI PENAL - VITET 2013 - 2016²²

Periudha	Nr. rasteve	Niveli i lartë	Niveli i mesëm	Niveli i parë	Niveli zbatues	Punonjës civil	Efektiv të Gardës	Efektiv të PMNZSH-së	Totali	Të arrestuar/ Ndaluar	Të dënuar	Në gjykim
2013 - 2016	626	4	8	217	498	34	7	7	775	202	71	19

treguesit statistikor penal vitet 2013 - 2016



Skëndo, A.
«Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat», në sfidën e faktorit të mbikëqyrjes së jashtme civile»

Policimi dhe Siguria
nr.5, 2017

4. Përfundime

Në përfundim të këtij shkrimi, dua të theksoj se hartimi dhe miratimi i kuadrit ligjor dhe ngritja e strukturave apo mekanizmave të nevojshëm për zbatimin e tyre, nuk do të thotë që reformimi i Shërbimit u arrit, përkundrazi, është i nevojshëm kalimi në një stad më të lartë, atë të rritjes dhe forcimit të kapaciteteve të mbikëqyrjes së jashtme policore në tërësi dhe të strukturave të tij në veçanti, për konsolidimin e pozicionit të tij si një faktor i rëndësishëm në zinxhirin e aktorëve që përbëjnë modelin apo sistemin e mbikëqyrjes së jashtme policore. Fokusi i punës sonë do të synojë:

- Bashkëpunim më të mirë (më të ngushtë) me strukturat e vetëkontrollit të Policisë së Shtetit (Drejtoria e Standardeve Profesionale) në analizën e të dhënave të përftuara nga ankesat e publikut, me qëllim evidentimin e shkaqeve kryesore të keqsjelljes policore. Kjo qasje, do të na ndihmonte në identifikimin e tendencave në sjelljen e policisë, të cilat nuk përmbushin standardet e policimit dhe që përbajnë potencialin për një numër të konsiderueshëm ankesash të tyre. Adresimi në kohë i tyre do të jetë prioritet.

- Fuqizimin e kapaciteteve profesionale të burimeve njerëzore të Shërbimit, nëpërmjet shtimit të takimeve në nivel ekspertësh, seminaresh, trajnime, konferenca të përbashkëta me agjencitë e mbikëqyrjes policore nga vendet perëndimore, tashmë të konsoliduar në mbikëqyrjen civile, shoqërinë civile, organizatat joqeveritare që operojnë në këtë fushë apo edhe institucione të arsimit të lartë brenda dhe jashtë vendit.

- Dhënien e rekomandimeve të dala nga analizimi i problematikave të evidentuara nga raportet e inspektimit dhe protokollet e hetimit, që lidhen drejtpërsëdrejti me etikën policore, performancën e policisë dhe partneritetin polici-komunitet, me qëllim konsolidimin e këtij të fundit, për të rritur besueshmërinë dhe legjitimitetin e institucionit të policisë. *“Prezenca e SHÇBA-së afër qytetarëve, do të thotë mbështetje për garantimin e të drejtave të tyre, ndërsa prezenca e SHÇBA-së, afër policisë dhe strukturave do të thotë përkrahje për fuqizimin e integritetit dhe rritjen e besueshmërisë së publikut tek Policia e Shtetit”.*

Referencat

1. Branko Lobnikar & Gorazd Mesko (2015) “Perception of Police Corruption and the Level of Integrity among Slovenian Police Officers”, *Police Practice and Research: An International Journal*, 16:4.
2. Sanja Kutnjak Ivkovic & Tara O' Connor Shelley (2007) “Police Integrity and the Czech Police Officers”, *International Journal of Comparative and Applied Criminal Justice*.
3. *Forcimi i integritetit policor në Shqipëri*, Tiranë 2015: IDM.
4. *Fletore zyrtare nr. 124*, datë 08.09.2014, ligji nr.70/2014 për “Shërbimin për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, në Ministrinë e Punëve të Brendshme”.
5. *Fletore zyrtare nr. 190*, datë 16.12.2014, VKM nr. 829, datë 03.12.2014 për “Miratimin e Rregullores së Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, në Ministrinë e Punëve të Brendshme”.
6. *Ligji nr. 7530*, datë 11.12.1991 “Për organizimin e Shërbimit Informativ Ushtarak dhe të Shërbimit të Kundërbulimit në Organet e Rendit Publik”.
7. *Ligji nr. 8749*, datë 01.02.2001 “Për Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm, në Ministrinë e Rendit Publik”.
8. *Raportet Vjetore 2010, 2011, 2012, 2013, 2014, 2015, 2016* të Shërbimit.
<http://shcba.gov.al/index.php/raporte>
9. <http://www.epac-eacn.org> – constitutions of EPAC/EACN.

¹⁸ *Ligji nr. 70/2014* për “Shërbimin për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, në Ministrinë e Punëve të Brendshme”, neni 9, f. 3.

¹⁹ *VKM nr. 829*, datë 03.12.2014 për “Miratimin e Rregullores së Shërbimit”, neni 4, f. 3.

²⁰ *Raportet Vjetore të Shërbimit*, 2010, -2016, Gjenden në faqen : <http://shcba.gov.al/index.php/raporte>.

²¹ Inspektimet e paplanifikuara përfshijnë (inspektime jashtë planit vjetor të inspektimit, inspektime për trajtim ankesash, inspektime të përbashkëta me strukturat e hetimit, të agjencive homologe si IPK, etj).

²² *Raportet Vjetore të Shërbimit*, 2010-2016, . . . , po aty.

Skëndo, A.
« Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat », në sfidën e faktorit të mbikëqyrjes së jashtme civile »

Policimi dhe Siguria
nr.5, 2017

Garda e Republikës - vështrim historik mbi misionin dhe rolin e saj



■ **MSc Gramoz SAKAJ**
Gjeneral i Gardës së RSH-së

Abstrakt

Të realizosh sigurinë kombëtare (shtetërore, publike, të individit, etj.), do të thotë të garantosh integritetin dhe normalitetin e veprimtarisë politike, ekonomike e shoqërore të vendit, e cila në kushtet e sotme, kërcënohet nga rreziqe globale, rreziqe rajonale dhe rreziqe të brendshme, të tilla si: terrorizmi, krimi i organizuar ndërkombëtar e rajonal dhe një bashkim i shumë faktorëve, veçanërisht i atyre politikë, ekonomike, socialë, kriminogjenë, etj. Siguria, liria dhe mirëqenia janë elemente thelbësore të shoqërive të civilizuar dhe përfaqësojnë themelet, mbi të cilat mbështetet zhvillimi dhe progresi i kombit. Është për këtë arsye që, “. . .garantimi i një mjedisi që ofron siguri dhe liri për qytetarët, vlerësohet si një ndër përgjegjësitë parësore të shtetit demokratik, institucioneve të sigurisë dhe agjencive të zbatimit të ligjit”.¹

Në terma profesionale, siguria shtetërore, perceptohet si tërësi masash e institucioneve të sigurisë, që garantojnë integritetin e institucioneve shtetërore, jetën dhe veprimtarinë normale të personaliteteve të larta dhe autoriteteve shtetërore, mbrojnë rregullin e rendin publik nga turbullirat sociale, nga sulmet e armatosura dhe rebelimet masive, të cilat kërcënojnë rendin kushtetues, apo rrezikojnë ta përmbysin atë me dhunë. Ruajtja e jetës, shëndetit dhe pronës së personave që gëzojnëtribute të veçanta (personaliteteve të larta dhe autoriteteve shtetërorë) dhe e pjesëtarëve të familjeve të tyre, me qëllim shmangien nga ndonjë destabilizimi i rëndë i rendit dhe ngjalljes së pasigurisë në publik, nëse ato do të dëmtohen, është detyrë e rëndësishme e institucioneve të veçanta të sigurisë, të krijuara në bazë e për zbatim të ligjit. Këto institucione, veçanërisht Garda, Policia e Shtetit, etj., për të përmbyshur me sukses këtë detyrë dhe për të kontribuar në mënyrë efektive në forcimin e sundimit të rendit e ligjit, përveç profesionalizmit, komunikimit dhe bashkëpunimit ndërinstitucional kanë nevojë që të modernizohen e të konsolidohen. Me anë të një analize në retrospektivë, të fokusuar në historinë e lindjes dhe zhvillimit të asaj që sot quhet Garda e Republikës, qartësohet misioni dhe detyrat e saj në të gjitha kohët, si dhe evidentohet trashëgimia e pasur kulturore e historike, në përballjen dhe kapërcimin e sfidave të shumta të sigurisë dhe minimizimin e faktorëve që rrezikojnë integritetin e veprimtarinë normale, të institucioneve dhe personaliteteve të larta shtetërore.

Fjalëkyçe:

Garda, Institucion shtetëror, personalitete shtetërore, ruajtje, siguri, siguri kombëtare, siguri shtetërore, siguri publike, ruajtje fizike, etj.

1. Hyrje

Misioni dhe përgjegjësitë ligjore të Gardës së Republikës, si struktura profesionale, e cila, me shërbimet e veta, realizon ruajtjen e integritetit të institucioneve të rëndësishme shtetërore dhe garantimin e jetës e të veprimtarisë normale të personaliteteve dhe autoriteteve të larta shtetërore, e bën atë, një ndër institucionet me kontribute dhe pritshmëri të larta, në rritjen e treguesve të sigurisë për ushtrimin nga institucionet dhe personalitetet e veprimtarisë dhe përgjegjësive ligjore. Këtë mision dhe këto përgjegjësi, personeli i strukturës së gardës, në të gjitha kohët i ka kryer me përkushtim dhe përgjegjshmëri. Ashtu sikurse është fakt që, dekadat e fundit, kemi përjetuar ngjarje dhe gjendje të pamjaftueshmërisë dhe moseficiencës së punës së personelit dhe drejtuesve, duke vënë në rrezik jo rrallë sigurinë, integritetin dhe veprimtarinë e institucioneve e të autoriteteve shtetërore, e herë-herë, edhe jetën, shëndetin dhe pacenueshmërinë fizike të personaliteteve. Mbështetur në karakterin historik të zhvillimit të Gardës, me anë të një vështrimi analitik të fokusuar qysh nga hershmëria e deri në ditët e sotme, synohet të evidentohen lufta dhe përpjekjet në përballjen dhe kapërcimin e sfidave të shumta të sigurisë, por edhe qartësimi i çështjeve që lidhen me misionin, përgjegjësitë, statusin, atributet ligjore, apo probleme të tjera që lidhen me përmbushjen e veprimtarisë së tyre.

Duke e shtrirë studimin qysh nga “Garda Pretoriane/Mbretërore” e Skënderbeut, “Garda e Rilindjes Kombëtare” e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, “Kavaleria/Garda e

¹ *Strategjia e Sigurisë Kombëtare e Republikës së Shqipërisë*, miratuar me ligjin nr. 103/2014, datë 31.07.2014, f. 4, par. 1.

Sakaj, G.
« Garda e Republikës - vështrim historik mbi misionin dhe rolin e saj »

Policimi
dhe
Siguria
nr.5, 2017

Shtetit” e Qeverisë së Vlorës, “Garda Mbretërore” e periudhës së Monarkisë, “Batalioni i Sigurimit i SHPU-së” i periudhës së LANÇ-it, “Garda e RPSSH-së” e viteve 1976-1992 e deri të “Garda e Republikës”.² Në ditët e sotme, synimi është që, të qartësohet se misioni dhe detyrat e kësaj strukture, në të gjitha kohërat ka qenë dhe mbetet “. . . ruajtja e integritetit të institucioneve shtetërore, e jetës dhe veprimtarisë normale të personaliteteve të larta dhe autoriteteve shtetërore”.

Por, veç sukseseve, Garda ka pasur edhe defekte e të meta në veprimtarinë e vet. Analiza e faktorëve që kanë ndikuar në ngjarjet, mangësitë e të metat evidenton edhe mungesën e koordinimit dhe bashkëpunimit me institucionet e tjera të sigurisë: marrja e informacionit të hershëm për kërcënimet terroriste, mosshfrytëzimi i kapaciteteve të inteligjencës, veprime të gabuara me burimet njerëzore dhe trajtimin e personelit, defekte në veprimtaritë e formimit dhe të kualifikimit profesional, investime të munguara në modernizimin teknologjik, me mjete e pajisje efikase, etj.

Të gjitha këto, por edhe të tjera mangësi e defekte, kanë pasur e kanë impaktin e vet në efektivitetin e shërbimeve ndaj personaliteteve dhe institucioneve të larta shtetërore, për rrjedhojë edhe në nivelin e sigurisë, evidentohen si drejtime në të cilat duhet përqendruar vëmendja e menaxherëve dhe drejtuesve të Gardës, për evitimin e tyre. Ndaj dhe, veç nevojës për një trupë shërbimesh sigurie të aftë, të arsimuar e të kualifikuar, kjo gjendje sjell edhe një herë në vëmendje kërkesën që veprimtaria e strukturave menaxheriale e drejtuese, veçse e bashkërenduar dhe e integruar me institucionet e tjera të sigurisë, të jetë e fokusuar më mirë në kushtet dhe faktorët konkretë të riskut, për sigurinë e institucioneve dhe personaliteteve të larta shtetërore. Është kjo një nga arsytet që, në punën që bëhet për reformimin e strukturave të sigurisë, duke filluar nga miratimi i “Strategjisë së Sigurisë Kombëtare të RSH-së” (me ligjin nr. 103/2014, datë 31.07.2014), etj., vlerësohet kujdesi i qeverisë që, këtij procesi zhvillimi e modernizimi, t’i bashkohen të gjitha institucionet e strukturat e sigurisë, më konkretisht ato të Gardës dhe të Policisë, si struktura me rol e pritshmëri të veçanta për të ardhmen dhe integrimin e vendit në institucionet evropiane.

- *Qëllimi.* Me anë të këtij shkrimi, synojmë që të evidentojmë e nxjerrim në pah faktin se i kemi të gjitha potencialet e nevojshme (njerëzore, ekonomike e materiale), për të pasur një shërbim eficient të Gardës së Republikës, për të mbrojtur dhe zhvilluar më tej sigurinë e objekteve dhe personaliteteve të larta shtetërore. Ajo që lypset, e që natyrisht bën pjesë në rekomandimet e trajtesës, është që nëpërmjet një vështrimi studimor mbi historinë e zhvillimit të Gardës së Republikës, të evidentojmë rrugët, mjetet dhe mënyrat e rritjes së eficiencës së shërbimeve dhe personelit të saj, për realizimin e misionit dhe përgjegjësisë në tërësi. Kjo, me shqetësimin e veçantë që, gjatë këtij procesi zhvillimi e modernizimi, të identifikojmë të gjitha metodologjitë dhe mekanizmat me peshë, në rritjen e ndërveprimit institucional të agjencive të zbatimit të ligjit dhe të strukturave të sigurisë.

- *Metodat.* Arritja e objektivave dhe standardeve shkencore të punimit, zgjidhja e detyrave të shtruara dhe interpretimi i gjetjeve, çështjeve dhe problematikave, kërkoi përdorimin e metodave dhe teknikave të ndryshme, të përqasura me natyrën dhe qëllimet e punimit. Kështu, u përdor gjerësisht metoda historike e trajtimit të problemeve dhe e pasqyrimin realisht e me vërtetësi shkencore të kalimeve të Gardës nga njëra etapa në tjetrën, gjatë zhvillimit institucional. U përdor me objektivitet metoda e analizës dhe

² Me datë 09.09.1992, Parlamenti shqiptar miratoi ligjin: “Për Gardën e Republikës”.

sintezës, të çështjeve të organizimit strukturor dhe evoluimit progresiv të saj deri në ditët e sotme. Ashtu sikurse, për të realizuar krahasimet e nevojshme dhe për të dalë me konkluzione sa më të bazuara mbi rrugët e rritjes së eficiencës së shërbimeve të veta, u mbështetëm fort në informacionin dhe në të dhënat arkivore.

2. Lindja dhe zhvillimi i Gardës Shqiptare

Gjatë historisë së tij, populli shqiptar ka pasur kurdoherë një trupë të gatshme dhe të armatosur për të ruajtur dhe siguruar personalitetet shtetërore, krahinore, kuvendare, intelektuale dhe klerikale, e quajtur “Gardë”. Sipas “Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe”, kuptimësia e emrit “gardë”, shpjegohet si: “Repart i posaçëm, i përbërë nga trupa të zgjedhura ushtarake, që mbahen për të mbrojtur a për të ruajtur udhëheqësit e drejtuesit e lartë të një vendi.”³

Fillesat e Gardës Shqiptare. Në historinë e Shqipërisë, “. . . shekulli i pesëmbëdhjetë do të mbetet “Shekulli i Lavdisë së Madhe”, siç e quan De Rada. Për njëzetepesë vite radhazi, 1443-1468, Skënderbeu organizoi, drejtoi dhe udhëhoqi njëzetepesë beteja të mëdha, duke fituar me nder dhe lavdi njëzet e katër prej tyre. Ushtria e popullit të vogël u bë barriera kryesore në mbrojtje të qytetërimit. Krahas ushtrisë kombëtare, në përbërje të saj në këtë kohë (në kohën e Skënderbeut) u krijua dhe funksionoi “Garda Pretoriane”, ose siç do të quhej më vonë “Garda Mbretërore”. Në krye të “Gardës Pretoriane/ Mbretërore”, kanë qenë gjeneralët më të talentuar të Skënderbeut, si Ajdin Muzaka dhe Gjergj Balsha.

Garda në periudhën e Rilindjes Kombëtare. Në vitin 1878, (më 10.6.1878) u krijua Lidhja Shqiptare e Prizrenit, me qëllim mbrojtjen e kufijve shqiptarë nga copëtimi prej fuqive të mëdha. Lidhja e Prizrenit është e para organizatë politiko-ushtarake mbarëkombëtare shqiptare, e cila kishte një platformë të qartë ideologjike kombëtare, një organizim shtetëror në shkallë kombëtare, por dhe një ushtri të vetën. Në përbërje të saj u krijua edhe një strukturë e veçantë për ruajtjen dhe sigurimin e personaliteteve drejtuese të Lidhjes. Kjo strukturë ishte “Garda e Rilindjes Kombëtare”. Pas përmbylljes së periudhës së Rilindjes Kombëtare, nocioni “gardë” do të bëhej më i qartë.

“Garda e Shtetit” e Qeverisë së Vlorës. Më 23 nëntor 1912, kur Ismail Qemali do të nisej nga Durrësi për në Vlorë, do të përcillej nga një gardë ushtarake nderi. Kuvendi i mbledhur në Vlorë, i përbërë nga 83 delegatë, shpalli Pavarësinë Kombëtare. Në përbërje të Forcave të Armatosura, të cilat garantonin mbrojtjen dhe sigurimin kombëtar, do të funksiononte dhe një strukturë speciale e emërtuar “Kavaleri”, e cila do të kishte si detyrë të vetme që: “. . . të bënte shoqërimin e pushtetarëve e të shtetarëve, kur ata do të lëviznin dhe do të kryenin shërbimet ceremoniale..”. Ky nënrepart special i armatosur do të inkuadrohej në strukturën speciale të emërtuar “Garda e Shtetit”.

Krijimi i “Gardës Mbretërore”. Dekretligji i datës 24 qershor 1928⁴ është dokumenti autentik, që vërteton krijimin e gardës në sistemin e Monarkisë së Mbretit Zogu i I-rë. Në krye të Gardës Mbretërore u vendos kolonel Hysen Selmani. Më 27 nëntor të vitit 1929, u shpall ligji i ri “Për organizimin e fuqive armate” dhe me këtë ligj, struktura e

³ Androkli Kostallari, Jani Thomaj, Xhevat Lloshi, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë (Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë), Miço Samara . *Fjalori i gjuhës së sotme shqipe*, Tiranë, 1980: Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë.

Gjendet në version elektronik në: <http://www.fjalori.shkenca.org/>

⁴ Data 24 qershor 1928 njihet zyrtarisht si dita e krijimit të Gardës Shqiptare.

Sakaj, G.

« Garda e Republikës - vështrim historik mbi misionin dhe rolin e saj »

Policiimi dhe Siguria nr.5, 2017

Gardës Mbretërore, përmirësohet e paraqitet si vijon: komanda, batalion këmbësorie me 4 kompani, bateri artilerie me 4 topa 75/13mm, bandë presidenciale (orkestër frymore), togë kalorësish, një kompani, etj.

Rikrijimi i Gardës, më shkurt të vitit 1944. Gjatë Ofensivës së Dimrit, 1943-1944, u prish Qendra e Drejtimit dhe e Komandimit të SHPU (Shtabit të Përgjithshëm Usharak). Si vend më i përshtatshëm për vendosjen e tij të re, u gjet fshati Panarit, që ndodhej në jug të Vithkuqit, në rrethin e Korçës. Për ruajtjen dhe sigurimin e SHPU dhe drejtuesve të tjerë të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, lindi nevoja e ngritjes së një strukture të veçantë, e cila do të merrej me ruajtjen fizike të anëtarëve të shtabit dhe me sigurimin e mjediseve të punës e të banimit të tyre. Kështu, më 12 shkurt 1944, Haxhi Lleshi, me cilësinë e anëtarit të SHPU-së, komunikoi urdhrin për krijimin e repartit të posaçëm që do të kishte si detyrë: “të siguronte anëtarët e SHPU-së, të Komitetit Qendror të PKSH-së, si dhe ruajtjen e sigurimin e misioneve të huaja të atashuara pranë Shtabit të Përgjithshëm”. Në krye të kësaj kompanie u caktuan komandant Axhem Abazi dhe komisar Maqo Zoto. Në fillim, formacioni përbëhej nga 34 partizanë të zgjedhur, ndërkohë që, në fund të muajit prill 1944, numri i efektivit të repartit të posaçëm (Gardës) shkoi në 100 vetë. Kompania tashmë kishte tre toga me nga tre skuadra. Vartësia direkt e kompanisë së ruajtjes së SHPU-së dhe detyrat specifike, ishin nga shefi i SHPU-së, në atë kohë, major Spiro Moisiu.

Në tetor 1944, u zhvillua Konferenca e dytë e Këshillit. Më 25 tetor 1944, me vendim të Konferencës së dytë të KANÇL, në Berat u krijua Batalioni i Sigurimit të SHPUNÇL (në këtë kohë artikullohet termi “gardë”), i cili kishte 3 kompani, 9 toga dhe 27 skuadra. Detyra e tij ishte: “Të siguronte Personalitetet e Qeverisë Demokratike të Shqipërisë dhe Shtabin e Përgjithshëm të Ushtrisë Nacionalçlirimtare”. *Garda gjatë periudhës së shtetit monopartiak (1945-1990).* Në mars të vitit 1945, tre muaj pas çlirimit, Garda do të emërtohej “Batalioni Special i Shtabit të Përgjithshëm”, duke qenë strukturë brenda Divizionit të Mbrojtjes së Popullit (DMP), ndërkohë që, në shkurt të vitit 1947, reparti do të emërtohej për herë të parë si “Garda e Republikës”. Në vitin 1949, Garda rekrutoi për herë të parë, ushtarë të shërbimit të detyrueshëm ushtarak, sepse deri në atë kohë efektivi i saj përbëhej nga ish-partizanë të UNÇL-së. Në vitin 1951, Garda hyri në përbërje të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe vartësinë e detyrat i merrte nga “drejtoria e dytë”, e cila kishte si funksion ruajtjen dhe sigurimin e personaliteteve të larta shtetërore dhe drejtuesit e lartë të partisë në pushtet.

Gjatë këtyre viteve, deri në nëntor të vitit 1968, Garda u fuqizua dhe u modernizua me personel e teknikë bashkëkohore, ndërkohë që numri i efektivit arrinte në mbi 600 vetë. Më datë 8.2.1964, Presidiumi i Kuvendit Popullor, e shpalli “Gardën e Republikës” si njësi ushtarake më vete dhe i akordoi asaj, “Flamurin Luftarak”. Në vitin 1968, pas largimit dhe denoncimit të traktatit të Varshavës, Garda pësoi një shndërrim strukturor dhe një rritje sasiore të efektivave të veta.

Në vitin 1976, me miratimin e Kushtetutës së re, ndryshoi edhe emërtimi i Gardës: nga “Garda e Republikës”, ajo u quajt “Garda e Republikës Socialiste të Shqipërisë”, ndërkohë që në vitin 1984, Presidiumi i Kuvendit Popullor e dekoroi atë me “Urdhrin e Flamurit”.

Garda pas viteve nëntëdhjetë. Në fillim të viteve nëntëdhjetë, në vendin tonë ndodhën një sërë shndërrimesh politike, të cilat sollën ndryshime edhe në Gardën e Republikës. Ndër transformimet më kryesore, mund të përmendim vendosjen e gradave ushtarake, depolitizimin e saj dhe përfshirjen e ish-Drejtorisë së Dytë brenda strukturës

së Gardës, e cila deri në këtë kohë kryente detyrat e ruajtjes dhe sigurimit të afërt të personaliteteve. Parlamenti shqiptar, më datë 9.9.1992 miratoi ligjin “Për Gardën e Republikës”, në të cilin, për herë të parë, përcaktohej me ligj misioni dhe detyrat e saj. Ajo emërtohej: “Njësi e specializuar ushtarake” me detyrë “ruajtjen e personaliteteve të larta shtetërore, selive dhe rezidencave qeveritare të përcaktuara me ligj, ose që vendosen me urdhër të Ministrit të Brendshëm”. Gjithashtu, ajo ngarkohej me detyrimin ligjor për ruajtjen dhe mbrojtjen e personaliteteve të huaja që vizitojnë vendin tonë. Në vitin 1993, bazuar në dekretligjin e datës 24 qershor 1928 dhe në dokumente e burime të tjera arkivore, u vendos përfundimisht që data e krijimit të Gardës së Republikës të njihet 24 qershori i vitit 1928.

Viti 1997 do ta vinte Gardën e Republikës përballë sfidave të vështira, ashtu si tërë shtetin e popullin shqiptar. Më 24 qershor 1998 Garda e Republikës u dekorua me “Medaljen e Artë të Shqiponjës”. Në vitin 2003, Kuvendi i Shqipërisë miratoi ligji i ri “Për Gardën”, i cili përcakton misionin, organizimin dhe statusin e veçantë të Gardës së Republikës, brenda Ministrisë së Brendshme. Dëshmori i parë i Gardës, është Major Llesh Topollaj. Në historinë e saj, Garda e Republikës është drejtuar nga 23 komandantë. Dy prej tyre, mbajnë titullin “Hero i popullit”. Komandanti i parë i Gardës, është kolonel Hysen Selmani (1928- 1939).

3. Misioni dhe përgjegjësitë e Gardës së RSH-së

Kushtetuta e Shqipërisë dhe ligji organik për Gardën janë baza dhe burimi kryesor i përgjegjësisë dhe misionit të Gardës së RSH. Këto përgjegjësitë ligjore e përcaktojnë atë si struktura profesionale, e cila, me shërbimet e veta realizon mbrojtjen dhe ruajtjen e integritetit të institucioneve të rëndësishme shtetërore dhe garantimin e jetës e të veprimtarisë normale të personaliteteve dhe autoriteteve të larta shtetërore. Nga ana tjetër, kjo baze ligjore, misioni dhe detyrat që burojnë pre tyre e bëjnë atë nder institucionet me kontribute dhe pritshmëri të larta në rritjen e treguesve të sigurisë dhe ushtrimin nga institucionet dhe personalitetet të veprimtarisë dhe përgjegjësisë të tyre.

Nga një vështrim historik mbi zhvillimin e Gardës, qysh nga hershmëria e krijimit të këtij shërbimi e deri në ditët e sotme, gjejmë karakteristika që e dallojnë apo diferencojnë atë nga shërbime dhe struktura të tjera, me ngjyrimet e nuanca të pastra institucionale. Efektivisht, trupa apo “Garda Pretoriane ose Mbretërore” e Skënderbeut, përfshi edhe “Gardën e Rilindjes Kombëtare” të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, u formuan për kryerjen e shërbimeve të rëndësishme, siç ishte mbikëqyrja e rendit dhe sigurisë në territoret ku ushtroheshin pushtetet dhe atributet e institucioneve, ruajtja dhe siguria fizike e autoriteteve apo drejtuesve të kohës, si dhe grumbullimi i informacionit dhe mbikëqyrja e lëvizjeve të dyshimta të “armikut”. Këto hapa të parë, flasin për luftën dhe përpjekjet e shtetit shqiptar në përballjen dhe kapërcimin e sfidave të shumta të sigurisë, ashtu sikurse, nga pikëpamja institucionale, përbëjnë bazën, mbi të cilën evidentohen, por edhe qartësohen çështjet që lidhen me misionin, përgjegjësitë, statusin, atributet ligjore, apo probleme të tjera që kushtëzojnë përmbushje të veprimtarisë së tyre.

Duke e shtrirë studimin qysh nga “Garda Pretoriane/Mbretërore” e Skënderbeut, “Garda e Rilindjes Kombëtare” e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, “Kavaleria/Garda e Shtetit” e Qeverisë së Vlorës, “Garda Mbretërore” e periudhës së Monarkisë, “Batalioni i Sigurimit i SHPU-së” i periudhës së LANÇ-it, “Garda e RPSSH-së” e viteve 1976-1992 e deri te “Garda e Republikës”⁵ në ditët e sotme, synohet të qartësohet se kush ka qenë

Sakaj, G.
« Garda e Republikës - vështrim historik mbi misionin dhe rolin e saj »

Policimi dhe Siguria
nr.5, 2017

misioni dhe detyrat e kësaj strukture; si kanë evoluuar e ndryshuar këto nga njëra etapë e zhvillimit në tjetrën, etj.

Garda e Republikës së Shqipërisë, bazuar në ligjin, nr. 8869, datë 22.5.2003, “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”, përcaktohet si strukturë me status të veçantë “. . . që ka për mision ruajtjen dhe mbrojtjen e personaliteteve të larta shtetërore dhe të rezidencave, të përcaktuara në këtë ligj. Misioni dhe statusi i Gardës nuk ndryshojnë në gjendje të jashtëzakonshme apo në gjendje lufte”⁶. Këtë mision dhe këto përgjegjësi, personeli i strukturës së gardës, në të gjitha kohët i ka kryer me përkushtim dhe përgjegjshmëri. Ashtu sikurse është fakt që, dekadat e fundit, kemi përjetuar ngjarje dhe gjendje të pamjaftueshmërisë dhe moseficiencës së punës së personelit dhe drejtuesve të saj, duke vënë në rrezik sigurinë, integritetin dhe veprimtarinë e institucioneve shtetërore e deri jetën, shëndetin dhe pacenueshmërinë fizike të personaliteteve. Parimet bazë, mbi të cilat organizohet, funksionon dhe realizohet veprimtaria institucionale e Gardës janë: ligjshmëria, objektiviteti, profesionalizmi e besnikëria, asnjënia politike, ruajtja e informacionit të klasifikuar; organizimi e drejtimi i centralizuar, etj.

Përcaktimi i parimeve dhe kriterëve që ligji parashikon për punonjësit e gardës dhe sigurisë, ekzistojnë dhe zbatohen në praktikë si detyra, të cilat duhet të shërbejnë në jetësimin e misionit dhe përgjegjësi. Ndër to mund të përmendim: njohja mirë dhe respektimi i Kushtetutës, legjislacionit në fuqi dhe akteve nënligjore; njohja e objektit të shërbimeve të Gardës dhe përgjegjësitë e saj; komunikimi etik dhe korrektesa në detyrë, etj. Zbatimi i këtyre kërkesave, veçse shton e duhet të përmirësojë impenjimën e personelit të saj, duhet domosdo të rrisë përgjegjshmëritë e tyre për përmbushjen e përgjegjësi dhe misionit. Ndër përgjegjësitë më kryesore, ngarkuar Gardës së Republikës, janë ato të *mbrojtjes së pacenueshmërisë fizike* të autoriteteve dhe personaliteteve më të larta të vendit si, Presidenti i Republikës, Kryetari i Kuvendit dhe Kryeministri, si dhe të familjeve të tyre. Ashtu sikurse është përgjegjësi e saj edhe ofrimi i *mbrojtjes dhe sigurisë fizike* të personaliteteve të huaja, të një rangu me personalitetet tona (president, kryetar parlamenti, kryeministër, ministër, etj.), të cilët vijnë në vendin tonë.

Të njëjtat përgjegjësi ligjore, ka Garda edhe për *ruajtjen dhe sigurimin e jetës* e veprimtarisë së kryetarit të Gjykatës Kushtetuese, zëvendëskryetarëve të Kuvendit, anëtarëve të Këshillit të Ministrave, kryetarit të Gjykatës së Lartë, Prokurorit të Përgjithshëm, kryetarit të SHISH-it, kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, guvernatorit të Bankës së Shtetit, Avokatit të Popullit, kryetarit të KQZ-së, kryetarit të partisë më të madhe të maxhorancës parlamentare, kryetarit të partisë më të madhe të opozitës parlamentare dhe kryetarit të Bashkisë së Tiranës. Garda, ndër përgjegjësitë e saj, ka edhe *ruajtjen e sigurimin e rezidencave* presidenciale, të Kuvendit dhe të Këshillit të Ministrave. Brenda këtij kuadri, ajo ruan e siguron edhe seli, rezidenca apo mjedise të tjera ku gjenden personalitete të huaja që vijnë në vendin tonë, të një rangu me personalitetet tona (president, kryetar parlamenti, kryeministër, ministër, etj.), dhe objekte që përcaktohen me VKM.

Ajo ruan e siguron gjithashtu, banesat e personaliteteve të përmendur më lartë si: kryetarit të Gjykatës Kushtetuese, zëvendëskryetarëve të Kuvendit, anëtarëve të Këshillit të Ministrave, kryetarit të Gjykatës së Lartë, Prokurorit të Përgjithshëm, kryetarit të SHISH-it, kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, guvernatorit të Bankës së Shtetit, Avokatit të Popullit, kryetarit të KQZ-së, kryetarit të partisë më të madhe të

Sakaj, G.
« Garda e Republikës - vështrim historik mbi misionin dhe rolin e saj »

Policimi dhe Siguria
nr.5, 2017

⁵ Më datë 09.09.1992, Parlamenti shqiptar miratoi ligjin: “Për Gardën e Republikës”.

⁶ *Ligji, nr. 8869, datë 22.5.2003, “Për Gardën e RSH-së”, neni 2.*

maxhorancës parlamentare, kryetarit të partisë më të madhe të opozitës parlamentare dhe kryetarit të Bashkisë së Tiranës.

4. Sfidat dhe efektiviteti i shërbimeve të Gardës

Vështrimi i karakterit historik, por edhe arsyetimet e analiza e veprimtarisë së Gardës, gjatë periudhës që jam në drejtimin e saj, evidenton se situatat në vend dhe në rajon na kanë ballafaquar me sfida dhe problematika të ndryshme, të cilat janë përcjellë me kujdes në të gjitha rastet e paraqitura. Kjo është arritur me angazhimin maksimal të së gjithë strukturave, bazuar në përvojën dhe eksperiencën e krijuar ndër vite edhe nga rritja e efektivitet të punës së të gjitha hallkave drejtuese, menaxhuese dhe operuese.

Në optikën tonë është parë e qenësishme dhe imediate kryerja e detyrës me korrektesë ligjore dhe aftësi të larta profesionale. Ruajtja dhe sigurimi i PLSH-ve (Personaliteteve të Larta Shtetërore), si një detyrë e përditshme dhe e përhershme, kërkon impenjim, përgatitje të gjithanshme dhe vlerësim maksimal të çdo situatë. Për me tepër në ditët e sotme, kur kërcënimet terroriste nuk janë më një vegim imagjinar, por një përballje reale e botës së qytetëruar me sulmet eventuale të një bote arkaike, shtrohet nevoja e rritjes vazhdimisht e në çdo moment, së vigjilencës dhe gatishmërisë, për të mos u gjendur të befasuar në asnjë rrethanë. Për vetë misionin e saj, Garda e Republikës është pozicionuar si një organizëm kompleks dhe solid për parandalimin dhe eliminimin e çdo pasoje që mund të vijë nga tentativa të mundshme të elementëve në veprim, qofshin të organizuar e me qëllime të përcaktuara politike apo terroriste, qofshin dhe elementë të zakonshëm kriminalë.

Përmbushja e detyrave për marrjen plotësisht të masave të sigurisë, pa asnjë incident në të gjitha vizitat dhe takimet e nivelit të lartë është mundësuar, veç të tjerash, edhe me bashkëpunimin e bashkërendimin me shërbimet e tjera të sigurisë, si me ato brenda vendit edhe me shërbimet e sigurisë të vendeve përkatëse. Ndër to, përmendim vizitat shumë të rëndësishme e historike të personaliteteve të larta të huaja në vendin tonë, si vizita e Papa Françeskut, vizita e Sekretarit të Shtetit, Xhon Kerri, vizita e Kancelares gjermane, Merkel, si dhe e disa ministrave e kryeministrave, për të veçuar atë të Kryeministrit të Serbisë, Aleksandër Vuçiq; gjatë Samitit të NATO-s, në Tiranë, etj.

Vështrimi historik mbi gardën dhe zhvillimin e saj, veç anëve pozitive të veprimtarisë, evidenton edhe një set mangësish, të metash e defektesh, të cilat, duke i njohur do të na bëjnë të jemi më racionalë, më të efektshëm dhe më efektivë në përballimin e situatave e të ngarkesave, si dhe në korigjimin e mangësive. Nga analizat e ndryshme të bëra nga koha në kohë, mbi faktorët që kanë ndikuar në ngjarjet dhe situatën në tërësi, evidentohen edhe: mungesa e koordinimit dhe bashkëpunimit të thellë mes institucioneve e strukturave të sigurisë; mosfunksionimi i sistemit të paralajmërimit të hershëm për rreziqet e kërcënimet terroriste dhe mosshfrytëzimi sa e si duhet i kapaciteteve të inteligjencës; politika e qëndrime të gabuara me burimet njerëzore dhe trajtimin e personelit (shkarkime, transferime e lirime të motivuara politikisht dhe rekrutime e emërime nepotike e klienteliste); mos eficientia e mekanizmave të formimit dhe kualifikimit profesional duke i përfshirë të gjithë në një program bashkëkohor trajnimi, stërvitjeje dhe testimi; investime të munguara në modernizimin teknologjik të shërbimeve të sigurisë, me mjete e pajisje efikase dhe bashkëkohore, etj.

Të gjitha këto, por edhe të tjera mangësi e defekte, të cilat në mënyrë të dukshme

Sakaj, G.
« Garda e Republikës - vështrim historik mbi misionin dhe rolin e saj »

Policimi dhe Siguria
nr.5, 2017

kanë pasur dhe kanë impakt në efektivitetin e shërbimeve të ruajtjes dhe sigurimit të personaliteteve dhe institucioneve të larta shtetërore, për rrjedhojë edhe në nivelin e sigurisë, evidentohen si drejtimet në të cilat duhet përqendruar vëmendja e menaxherëve dhe drejtuesve të Gardës për evitimin e tyre.

5. Përmirësimi dhe reformimi i shërbimeve të Gardës

Detyrat e Gardës ashtu si dhe të strukturave apo shërbimeve të tjera të sigurisë, janë të një rëndësie të veçantë, për më tepër, në kushtet e sotme, të inovacionit teknologjik, të lehtësimeve për telekomunikacion dhe udhëtime ndërkombëtare, apo kur, as krimi e as terrorizmi nuk e kufizojnë veten në mënyrë territoriale. Kjo gjendje, na dikton të kuptojmë që aleancat me të tjerët, janë patjetër thelbësore, jo vetëm për luftën ndaj terrorizmit të brendshëm apo “në shtëpinë tonë”, por edhe jashtë nesh, në rajon e më gjerë. Rrjedhimisht, për të njohur e minimizuar këto kërcënime, ne kemi nevojë, madje nevojë emergjente, për shërbime të integruara sigurie, çka nënkupton një shkëmbim frekuent e të organizuar informacionesh të inteligjencës.

Për përbushjen e misionit të Gardës së Republikës, në kuadër të rritjes së masave të sigurisë, është ndërjet e ndjehet nevoja e bashkëpunimit dhe ndërveprimit të qëndrueshëm me të gjitha strukturat e sigurisë dhe organet ligjzbatuese të vendit. Rrjedhojë e bashkëpunimit të ngushtë dhe shkëmbimit të vazhdueshëm të informacionit me Policinë e Shtetit dhe Shërbimin Informativ Shtetëror, u mundësua sigurimi pa incidente i të gjitha vizitave dhe takimeve të nivelit të lartë, veçanërisht ato të viteve të fundit të cilat edhe i përmendëm.

Dëshiroj të theksoj se, veç bashkëpunimit të brendshëm, pjesë e suksesit për sigurimin e veprimtarive ndërkombëtare dhe vizitave apo pranisë së personaliteteve të larta të huaja në vendin tonë, është edhe bashkëpunimi e koordinimi i veprimeve të institucioneve tona të sigurisë, përfshi dhe Gardën, me përfaqësitë diplomatike (ambasadat) dhe strukturat e sigurisë së vendeve përkatëse. Falënderimet e përfaqësuesve të strukturave të sigurisë së vendeve të huaja, lidhur me suksesin e vizitave apo takimeve dhe efektshmërinë e shërbimeve të sigurisë të ofruara nga Garda, kanë qenë e mbeten padyshim, jo vetëm një motivim mjaft i mirë për efektivitetin, por edhe një eksperiencë tepër e çmuar, se cilës duhet t'i kthehemi hera herës.

Ndaj dhe, veç nevojës për një trupë shërbimesh sigurie të aftë, të arsimuar e kualifikuar, kjo gjendje sjell edhe një herë në vëmendje, kërkesën që veprimtaria e strukturave menaxheriale e drejtuese, veçse e bashkërenduar dhe e integruar me institucionet e tjera të sigurisë, duhet të jetë e fokusuar më mirë në kushtet dhe faktorët konkretë të riskut për sigurinë e institucioneve dhe personaliteteve të larta shtetërore. Është kjo një nga arsyet që, në punën që bëhet për reformimin e strukturave të sigurisë, duke filluar nga miratimi i “Strategjisë së Sigurisë Kombëtare të RSH-së” (me ligjin nr. 103/2014, datë 31.7.2014), etj., vlerësohet kujdesi i qeverisë që, këtij procesi zhvillimi e modernizimi, t'i bashkohen të gjitha institucionet e strukturat e sigurisë, më konkretisht ato të Gardës e të Policisë, si struktura me rol e pritshmëri të veçanta për të ardhmen dhe integrimin e vendit në institucionet evropiane.

6. Disa përfundime

- Misioni dhe përgjegjësitë ligjore të Gardës së Republikës, si struktura profesionale,

e cila, me shërbimet e veta realizon ruajtjen e integritetit të institucioneve të rëndësishme shtetërore dhe garantimin e jetës e të veprimtarisë normale të personaliteteve dhe autoriteteve të larta shtetërore, e bën atë ndër institucionet me kontribute dhe pritshmëri të larta, në rritjen e treguesve të sigurisë për ushtrimin nga institucionet dhe personalitete të veprimtarisë dhe përgjegjësive ligjore.

- Ruajtja e jetës, shëndetit dhe pronës së personave që gëzojnëtribute të veçanta (personalitete të larta dhe autoritete shtetërore) dhe pjesëtarëve të familjeve të tyre, - me qëllim frenimin e destabilizimin e rëndë të rendit dhe ngjalljen e pasigurisë në publik, - është detyrë e rëndësishme e institucioneve të veçanta të sigurisë, të krijuara në bazë e për zbatim të ligjit. Këto institucione, veçanërisht Garda, Policia e Shtetit, etj., për të përmbushur me sukses këtë detyrë dhe për të kontribuar në mënyrë efektive në forcimin e sundimit të rendit e ligjit, përveç profesionalizmit, komunikimit dhe bashkëpunimit ndërinstitucional, kanë nevojë të modernizohen e të konsolidohen.

- Duke u fokusuar në historinë e zhvillimit të Gardës së Republikës, që nga lindja e deri në ditët e sotme, me anë të një analize e vështrimi në retrospektivë, që pati për qëllim qartësimin e misionit dhe detyrat e saj, nga një kohë në tjetrën, evidentohen fakte të rëndësishme në përballjen dhe kapërcimin e sfidave të shumta të sigurisë dhe minimizimin e rreziqeve që prekin integritetin dhe veprimtarinë normale të institucioneve dhe personaliteteve të larta shtetërore.

- Gjykoj se shkrimi, realizoi synimet e veta për të evidentuar e nxjerrë në pah faktin se i kemi të gjitha potencialet e nevojshme (njerëzore, ekonomike e materiale), për të pasur një shërbim eficient të Gardës së Republikës, për të mbrojtur dhe zhvilluar më tej sigurinë e objekteve dhe personaliteteve të larta shtetërore. Ajo që lypset, e që natyrisht bën pjesë në rekomandimet e trajtesës, është që të evidentojmë rrugët, mjetet dhe mënyrat e rritjes së eficiencës së shërbimeve dhe personelit të saj, për realizimin e misionit dhe përgjegjësi në tërësi.

- Nevojat gjithnjë në rritje të personaliteteve dhe autoriteteve të larta shtetërore, por dhe i kërkesave të shtuara të shoqërisë demokratike shqiptare për autoritetet dhe institucionet shtetërore, diktojnë një proces të vazhdueshëm profesionalizimi të Gardës, për të ofruar shërbime sigurie dhe kushte optimale për një rol të shtuar të tyre në shërbim të qytetarëve dhe në mbështetje të autoriteteve civile. Zgjerimi i spektrit të angazhimeve të Gardës, në kushtet e rritjes së kërcënimeve dhe rreziqeve të sigurisë është një objektiv konstant e i rëndësishëm i saj.

- Sfidat e sotme, në përballjen kërcënimeve ndaj sigurisë së institucioneve dhe personaliteteve të larta shtetërore dhe përmbushjen e detyrimeve ndaj luftës kundër terrorizmit dhe krimit të organizuar, shtrojnë para Gardës, nevojën e përqendrimit maksimal në detyrë; përgatitjes më të madhe profesionale; përvetësimit të përvojave dhe teknikave më të avancuara në parandalimin dhe eliminimin e çdo tentative dhe incidenti të mundshëm gjatë kryerjes së misionit të saj.

Sakaj, G.
« Garda e Republikës - vështrim historik mbi misionin dhe rolin e saj »

Policimi dhe Siguria
nr.5, 2017

Bibliografi

1. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, ligji nr. 8417, datë 21.10.1998.
2. Strategjia e Sigurisë Kombëtare e RSH, miratuar me ligjin nr. 103/2014, datë 31.7.2014.
3. Ligji, nr. 8869, datë 22.5.2003, "Për Gardën e Republikës së Shqipërisë".
4. Ligji nr. 108/2014 "Për Policinë e Shtetit".
5. Historiku i Gardës së Republikës.

Studimet “Master”, kusht i domosdoshëm për një polici profesionale



■ Prof. Asc. Dr. **Pandeli TAÇI**
Akademia e Sigurisë

Abstrakt

Detyrat që kryejmë, objektivat për më shumë rend, siguri e luftë ndaj krimin, rreziqet nga krimi i organizuar dhe kërkesat në rritje të njerëzve për një polici profesionale e korrekte në shërbim të tyre, kërkojnë shtimin e vëllimit dhe kualitetit të dijeve. Në këto kushte, është normale që të gjithë t'i drejtohem shkollës, arsimimit, trajnimit e kualifikimit, si mjeti më i sigurt për shtimin e sasisë e cilësisë së dijeve dhe procesi i vetëm që krijon mundësinë e të qenit vazhdimisht konkurrues. Për të realizuar këtë dhe për të krijuar avantazhet e nevojshme në mjedisin policor dhe atë të luftës ndaj krimin, shoqëria ka krijuar sisteme moderne edukimi, të cilat kanë programe te veçanta studimi (pjesë e tyre janë programet e studimit master), si mënyra më e mirë që dijet e gjithsecilit t'i shndërrojmë në motivim dhe inovacion.

Një program master në Polici do të thotë njohuri të avancuara teorike dhe praktike në fusha të ndryshme brenda saj (të rendit, sigurisë, inteligjencës, luftës ndaj krimin, etj.), mendim i thelluar analitik e i pavarur, vlerësim kritik profesional, aftësi për të zgjidhur probleme komplekse dhe mundësi për një karrierë të suksesshme akademike e menaxheriale, me synime të qarta e të pastra për nivele më të larta menaxhimi e lidërshipi.

Përveçse përbën avantazh për t'u futur plotësisht në fushën e interesit të policisë dhe të individit në polici, një diplomë master përfaqëson një përvojë të çmuar dhe garanci për tregun e punës (konkurrimin), duke e bërë edhe më të zgjidhshme dilemën apo ngasjen se, nëse doni të bëni karrierë në polici, apo t'u përkushtoheni kërkimeve në fushën për të cilën keni aspiruar, domosdo duhet të studioni në një program master.

Fjalëkyçe:

Studime policore, program studimi, master profesional, dije teorike, njohuri praktike, karrierë policore.

¹ Shef i Sektorit të Botimeve në Qendrën e Kërkimeve Shkencore (Ndërdisciplinore), të Akademisë së Sigurisë.

1. Hyrje

Është fakt i njohur tashmë, se viti kalendarik 2015 dhe në vijim, viti akademik 2015 – 2016, përbëjnë evenimente të rëndësishme për ndryshimin historik që shënuan në zhvillimin institucional, akademik e shkencor të Shkollës Shqiptare të Policisë dhe për perspektiven që hapën për zhvillimin e mëtejshëm të saj. Nder to, përmendim ligjin “Për Policinë e Shtetit”, i cili riktheu arsimin e lartë policor, ligjin “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor...”, VKM-në për çeljen Akademisë së Sigurisë; hartimin e dokumentacionit për fillimin e studimeve në “Programin bachelor për rendin dhe sigurinë publike”, si dhe një veprimtari e gjerë dhe e frytshme studimore e akademike, për realizimin e projekteve, angazhimeve dhe objektivave tejet ambicioze të Akademisë së Sigurisë.

I përket kësaj periudhe kohore, më konkretisht periudhës mars-qershor 2016, edhe veprimtaria për hartimin e programit të studimeve “Master për rendin e sigurinë publike”, si dhe kadri ligjor e normativ për studimet doktorale dhe fitimin e titujve akademike, etj., gjë për të cilën u zhvillua një proces i gjerë konsultimi me faktorët institucionale, grupet e interesit dhe studiues, pedagogë e specialistë të fushës (dokumentacioni i përfutur është për shqyrtim e miratim në MAS).

Sfida e çdo specialisti në polici, i cili kërkon të jetë i suksesshëm në marrëdhëniet me punën, si dhe e çdo profesionisti në karrierë është që të jetë gjithnjë e më shumë konkurrues në një mjedis të brendshëm e të jashtëm në ndryshim të vazhdueshëm. Një diplomë master për menaxhim e drejtim policor, veçse një përvojë e çmuar, përbën avantazh dhe garanci për tregun e punës (konkurrimin), duke e bërë më të thjeshtë

Taçi, P.
« Studimet
“Master”,
kusht
i domosdoshëm
për një polici
profesionale. »

Policimi
dhe
Siguria
nr.5, 2017

karrierën në polici, apo aspiratën për t'u marrë me analizë, studime e kërkime shkencore në fushën e rendit, sigurisë dhe luftës ndaj krimit. Detyrat që kryejmë, objektivi për më shumë rend, siguri e lufte ndaj krimit dhe kërkesat gjithnjë në rritje të komunitetit, për një policim të efektshëm, profesional e korrekt, kërkojnë dije e përpjekje të shtuara.

Duke mbajtur në konsideratë zhvillimet brenda e jashtë policisë, terrenin ne te cilin ushtrohen detyrat dhe kërkesat e shtuara para Akademisë së Sigurisë si IAL, programi i ciklit të dytë, "Master profesional, për sigurinë publike" shtrihet në një vit akademik (dy semestra mësimore) dhe ka 60 kredite ECTS. Në të përfshihen lëndë dhe disiplina mësimore të karakterit të ngushtë profesional-politor, por dhe të karakterit të përgjithshëm shoqëror, kushtetues e juridik. Nëpërmjet tyre, menaxherët dhe drejtuesit e policisë, përfitojnë njohuri të avancuara teorike dhe praktike në fushat më kryesore të veprimtarisë, për organizimin dhe drejtimin e shërbimeve dhe efektivave policore për zbatimin korrekt të ligjit dhe kompetencave e attributeve policore. Të arrijnë mendim të thelluar analitik dhe vlerësim kritik e të pavarur, aftësi për të zgjidhur situata të vështira të rendit dhe mundësi për një karrierë të suksesshme në nivele të larta menaxhimi e lidershipi, gjithnjë në rritje.

Në artikull, nëpërmjet përshkrimit synohet të vlerësohet rruga metodike që u ndoq për hartimin, diskutimin dhe miratimin e programit të studimeve të ciklit të dytë "Master profesional, për rendin dhe sigurinë publike". Veçohet fakti që u shfrytëzuan dhe konsultuan si modele referimi programet, planet dhe rregulloret e masterave të universiteteve publike e private të vendit, programet e disa shkollave policore Perëndimore, si dhe programet e planet mësimore të Shkollës Pasuniversitare të Policisë Shqiptare të vitit 2003² (për fat të keq me jetëgjatësi një vit).

Në tërësinë e vet, programi master përfaqëson një unitet dokumentesh e materialesh në përmbushje të udhëzimeve të MAS "Për hapjen dhe organizimin e programeve të studimit të ciklit të dytë në institucionet publike të arsimit të lartë" dhe kërkesave të Statutit Akademik të AS-sa. Ai përbëhet nga tri pjesë kryesore: "Propozimi për hapjen dhe organizimin e programit të studimeve master"; nga "syllabuset", - si një përmbledhje apo pjesë substanciale e programit dhe objektivave mësimore të çdo lënde, si dhe nga "Rregullorja e programit master".

Në artikull, të gjitha sa përshkruam, trajtohen nëpërmjet shtjellimit të disa çështjeve kryesore, ndër të cilat veçojmë: analizën e zhvillimeve dhe faktorëve që diktojnë çeljen e programit të studimeve master, karakteristikat akademike dhe objektivat formuese të tij, profilin kulturor dhe kompetencat profesionale që fitohen në mbarim të programit, impaktin në veprimtarinë institucionale dhe përfitimet personale të studentëve, si dhe disa përfundime e ndonjë rekomandim për përmirësime.

Qëllimi: Nëpërmjet trajtimit gjithëpërfshirës të faktorëve që diktojnë hapjen e programit master dhe detyrat që zgjidh, synimet dhe objektivat formuese të tij, profilit kulturor e profesional të studentit, kompetencat që fiton dhe mundësitë për promovim në karrierë, etj., të ndërthurura me përvojën e fituar nga hartimi i programeve analogë, dëshirojmë të krijojmë një bazë teorike të referueshme në ndërmarrjen e hapave për nivele më të larta studimi.

Metodologjia: Arritja e standardeve metodike e shkencore të punimit, zgjidhja e detyrave akademike të shtruara dhe interpretimi i problematikave, kërkoi përdorimin

² VKM, nr. 524, datë 01.08.2003, "Për hapjen e Shkollës Pasuniversitare, pranë Akademisë së Policisë 'Arben Zylyftari'".

e metodave dhe teknikave të ndryshme, të pajtueshme me natyrën dhe qëllimet e punimit. Kështu, u përdorën: analiza e çështjeve dhe problemeve të evidentuara në fushën e edukimit dhe kualifikimit profesional, ballafaquar me nevojat e rritjes së niveleve të policimit për rend, siguri e luftë ndaj krimit. U përdor metoda e sintezës, e mbështetur në informacionin e të dhënat për të dalë me konkluzione sa më të bazuara për hapat e ndërmarra për gjendjen dhe krahasimet e nevojshme. Mbështetja në metodën e referimit të instrumentet juridike dhe aktet metodiko-akademike, për të argumentuar nevojën e thellimit dhe zgjerimit të studimeve.

2. Një program “Master profesional” në Polici

Nëse do t'i përgjigjeshim thjeshtë, me disa fraza, do të thoshim se, studimet master në Polici, apo një program “Master profesional për rendin dhe sigurinë”, do të thotë: njohuri të avancuara teorike dhe praktike në fusha të ndryshme të policisë (të rendit, sigurisë, inteligjencës, luftës ndaj krimit, etj.); mendim i thelluar analitik e i pavarur, vlerësim kritik dhe profesional, aftësi për të zgjidhur probleme komplekse dhe mundësi për një karrierë të suksesshme akademike, nivele më të larta menaxhimi e lidërshipi. Duke shtuar në fund se, diploma “master”, është një portë e hapur për karrierë policore apo akademike.

Por, nuk është ky qëllimi ynë, - ai shkon përtej përcaktimeve përmbledhëse. Ndaj dhe nëpërmjet trajtimit gjithëpërfshirës të thelbit të këtij cikli apo niveli studimesh, të faktorëve që diktojnë hapjen e programit master, detyrave që zgjidh, synimeve dhe objektivave formuese të tij, profilit kulturor e profesional të studentit, kompetencat që fiton dhe mundësitë për promovim në karrierë, etj., të mundemi të krijojmë kuptime të qarta se profesionist i suksesshëm në marrëdhëniet me punën bëhesh nëse integrohesh apo je bërë pjesë aktive e një procesi progresiv edukimi e kualifikimi.

Të gjitha programet e studimit të ciklit të parë, përveçse mundësojnë hyrjen e menjëhershme në tregun e punës, krijojnë edhe avantazhet për vazhdimin e mëtejshëm të studimeve. Përgatitja e fituar nëpërmjet këtij niveli studimesh për rendin, sigurinë dhe hetimin e krimit, mund të thellohet më tej nëpërmjet fokusimit në fusha disiplinare specifike, të cilat mundësojnë përballje të suksesshme në marrëdhëniet me punën.

Akademia e Sigurisë ofron programin e studimeve “master profesional”, me 60 kredite, për profesionistë me përvojë, të cilët janë në marrëdhënie pune. Ky program synon të rrisë cilësisht kapacitetet e tyre administruese, organizative dhe drejtuese në pozicionet e ardhshme duke përmirësuar më tej formimin profesional ekzistues. Nëpërmjet ofrimit të më shumë mësimave praktike dhe përvojave menaxheriale, të cilat shkojnë përtej njohurive të përgjithshme, synohet të sigurohet më shumë cilësi, profilizim e aftësim në fushën e menaxhimit.

Këto programe studimi, organizohen me kohë të plotë dhe ndërthurin e kombinojnë mësimet teorike në auditor, me praktikën në terrenin policor, duke u mundësuar studentëve të krijojnë dhe zhvillojnë aftësi të reja, ndërkohë që janë në punë. Në këtë mënyrë, për t'iu përshtatur nevojave të procesit akademik dhe studentëve, sugjerohet që mësimi të zhvillohet i alternuar, tri ditë të javës në auditor dhe ditët e tjera në punë, në strukturat policore ku janë efektive.

Në kushtet e sotme të zhvillimit të vendit si dhe për përmbushjen e nevojave të policisë për shtimin dhe zhvillimin e kapaciteteve profesionale e drejtuese të saj, me specialistë me njohuri të thelluara në fushën e rendit, të sigurisë publike dhe luftën ndaj

Taçi, P.
« Studimet
“Master”,
kush
i domosdoshëm
për një polici
profesionale.»

Policimi
dhe
Siguria
nr.5, 2017

krimit, programet e studimeve master, paraqiten të domosdoshme. Ashtu sikurse edhe në institucione apo organizata të tjera, në polici, vazhdimi i studimeve të nivelit “master profesional”, është një proces i nevojshëm, jo vetëm për ata që duan të përmirësojnë pozitën aktuale profesionale, apo për ata që krijojnë për herë të parë marrëdhënie me një post të ri më të lartë pune, por dhe për të gjithë specialistët që aspirojnë të bëjnë karrierë në polici (ndër kushtet ligjore për t’u bërë drejtues është kryerja e studimeve “master”).

3. Faktorët që diktojnë çeljen e programit

Sikurse për të gjitha ciklet e studimeve, edhe për pranimin dhe ndjekjen e programit “master profesional”, ekzistojnë kritere të veçanta e të përgjithshme, të cilat burojnë nga sistemi rregullator i fushës së studimeve të larta, (ligjet, vendimet, urdhrat apo akte të tjera normative) dhe kondicionohen nga nevojat e strukturës për menaxherë dhe drejtues të lartë policie. Për t’u pranuar në këtë program studimesh, kandidati duhet të përmbushë kritere të tilla, si: të zotërojë një diplomë universitare “bachelor” për studime policore, ose diplomë tjetër studimi, të fituar brenda apo jashtë vendit, të vlerësuar ekuivalente me të, në fushën përkatëse ose në fusha të përafërta me programin për të cilin aplikon - në rastin kur diploma nuk përputhet me fushën e programit të kërkuar, departamenti që mbulon programin përkatës të studimeve “Master profesional” (60 ECTS), vlerëson nëse kualifikimet dhe përvoja në fushë janë të mjaftueshme; të ketë rezultate të mira të studimeve bachelor dhe notë mesatare mbi tetë; të ketë dëshmi të njohjes së njëres prej pesë gjuhëve të huaja: gjuhë angleze, frënge, gjermane, italiane ose spanjolle; të ketë, të paktën, 5 vjet përvojë pune; të marrë pjesë dhe të jetë fitues në konkurrimin për pranim dhe në çdo testim ose intervistë të bërë nga departamenti.

Pas një viti mësimor nga rihapja e Akademisë së Sigurisë dhe fillimit të studimeve të ciklit të parë (bachelor), për të plotësuar nevojat dhe kërkesat e studentëve të profilit të “sigurisë publike”, natyrshëm i vjen radha çeljes së studimeve në programet e ciklit master. Ky është një cikël i ri studimesh, i nivelit më të lartë që u ofrohet punonjësve e studentëve të policisë, për të thelluar dijet dhe njohuritë në fushën profesionale, pajisjen me informacion bashkëkohor e të qëndrueshëm për rendin e sigurinë publike. Në interes të Policisë së Shtetit dhe në konformitet me ligjin për IAL dhe udhëzimet e MAS-it, është gjetur e përshtatshme që programi i ciklit të dytë, “Master profesional në siguri publike” të zhvillohet në një vit mësimor dhe të përfshijë lëndë e disiplina të veçanta mësimore të karakterit ngushtësisht e thellësisht profesional e policor.

Nga një vështrim i vëmendshëm analitik i kushteve të zhvillimit dhe rrethanave me ndikim në fushën e rendit dhe sigurisë, evidentohet se janë të shumte faktorët që diktojnë hapjen e programit të studimeve “master” për rendin dhe sigurinë publike, një pjesë e të cilave nevojitet të vlerësohen si objektiva apo synime me efektet afatgjata për policinë dhe personelin drejtues.

Së pari, rritja e nivelit të kualifikimit profesional të drejtuesve të policisë shqiptare, i cili për shkaqe të ndryshme, shfaq sot një prapambetje relative që përcjell indikacione serioze në performancën e shërbimeve të rendit e sigurisë. Hapat e rëndësishme ligjore e institucionale, të hedhura në vitet e fundit, përfshirja e arsimit policor në reformën e arsimit të lartë, çelja e programit të studimeve “bachelor” dhe këto hapa që po ndërmerren (hapja e niveleve të larta studimesh, etj.), veçse shënojnë një fazë të re zhvillimi, e bëjnë të domosdoshme, pse jo dhe emergjente, nevojën e shtimit të

Taçi, P.
«Studimet
“Master”,
kusht
i domosdoshëm
për një polici
profesionale»

Policimi
dhe
Siguria
nr.5, 2017

kapaciteteve profesionale dhe autoriteteve me grada të larta në Policinë e Shtetit.

Së dyti, plotësimi i “nevojave të tregut të punës”, të cilat, përkthyer në terma faktike do të ishin: “...nevojat e policisë për shtimin dhe zhvillimin e kapaciteteve profesionale e drejtuese të saj, me specialistë me njohuri të thelluara në fushën e rendit dhe sigurisë publike”. Zgjidhjen e nevojave të policisë për specialistë të lartë, me dije e njohuri të thella për rendin dhe sigurinë publike, të aftë për të shërbyer në të gjitha strukturat policore, shërbimet dhe funksionet drejtuese e manaxheriale, me kulturë të gjerë dhe standarde të larta etike e profesionale, por dhe me aftësi praktike e shprehi inovative në zgjidhjen e situatave të rendit e sigurisë.

Së treti, përfshirjen e policisë dhe ecjen e saj me të njëjtin temp e ritëm me zhvillimin social e kulturor të vendit, përmirësimin e niveleve menaxheriale e drejtuese të saj, të cilat i shoh të lidhura e në korrelacion të drejtpërdrejtë me shtimin në sasi dhe fusha shërbimesh, të specialistëve dhe ekspertëve të fushës së rendit, sigurisë dhe luftës ndaj krimit. Në këtë mënyrë, këto prurje kualitative, nga ana e tyre do të ndikojnë në realizimin më mirë të përgjegjësisve ligjore e institucionale dhe nevojave të publikut për më shumë rend e siguri.

Së katërti, nevoja për të përmbushur gjithnjë e më mirë detyrimet për bashkëpunimin policor ndërkombëtar dhe me agjencitë e tjera të zbatimit të ligjit, veçanërisht në luftën kundër krimit të organizuar dhe trafikëve kriminale, diktuar se shumti nga natyra transnacionale dhe karakteri global i luftës ndaj tij, duke vlerësuar se, bashkëpunimi ndërkombëtar nuk është një kërkesë e thjeshtë, por nevojë jetike për shtetin dhe shoqërinë.

Së pesti, zhvillimet dhe reforma në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor diktojnë nevojën e integritit të sistemit akademik dhe niveleve të caktuara të studimeve me sistemin e karrierës në polici, me synim që të kultivojë dhe nxisë më tej ndjenjën e realizimit të një karriere të suksesshme të personelit në nivele drejtuese në polici bazuar fort te merita, sipas kushtëzimeve dhe obligimeve ligjore për kryerjen e studimeve masteriale.

4. Programet “bachelor”, bazë për t’u pranuar në studimet “master profesional”

Sipas standardeve të Bolonjës dhe përcaktimeve në legjislacionin shqiptar të arsimit të lartë, pranimi në programet e ciklit të dytë të studimeve është i mundur për kandidatët që kanë përfunduar një program studimi të ciklit të parë dhe plotësojnë kriteret e pranimit të institucionit të arsimit të lartë ku ata aplikojnë³. Parimisht, në programet e cikleve të tjera, më të larta të studimeve, ruhet profili dhe fusha fillestare, përfshi dhe fushat thellësisht të përafërta. Por, zhvillimet në fushën e kriminalitetit dhe kompleksiteti i çështjeve që shtrohen për zgjidhje, ka shtruar nevojën e pranimeve edhe nga fushat më pak se të përafërta si, financat, kibernetika, etj.⁴

Efektivisht, si rrjedhojë e ndikimit të faktorëve të ndryshëm, sot në polici ekzistojnë kategori personeli me shkolla të ndryshme formimi, arsimimi dhe kualifikimi, të cilët

³ Ligj nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në institucionet e arsimit të lartë në RSH”, neni 76, “Pranimi në programet e ciklit të dytë të studimeve”, pika 1.

⁴ Është fakt që kohët e fundit në polici janë punësuar gjithnjë e më shumë specialistë nga IT, kimistë, financierë, etj.

Taçi, P.
« Studimet
“Master”,
kusht
i domosdoshëm
për një polici
profesionale. »

Policimi
dhe
Siguria
nr.5, 2017

kanë të drejtën e vazhimit të cikleve të tjera më të larta studimesh. Arsimitimi i lartë i tyre është i përafërt, por dhe i ndryshëm nga arsimitimi policor. Karshi këtij realiteti Akademia e Sigurisë nuk mund të rrijë indiferente, kjo sepse, si pjesë e arsimit të lartë publik, arsimitimi policor është e duhet vlerësuar si shërbim dhe e mirë publike, të jetë gjithëpërfshirës dhe jo “e drejtë apo atribut” i njerëzve apo subjekteve të veçantë.

Në këtë mënyrë, në programin e studimeve të ciklit të dytë “Master profesional për rendin dhe sigurinë publike”, u mundësohet pranimitimi studentëve e specialistëve të cilët, veçse janë punonjës efektivë të policisë së shtetit, plotësojnë edhe kushtin akademik të diplomimit në një program të ciklit të parë “bachelor”, të sistemit me 3 apo 4 vite studimi. Për të qartësuar gjithë problematikën rreth programeve të nivelit të parë (bachelor), që kanë mbaruar kategori të ndryshme të personelit policor, të cilët duan të vazhdojnë studimet “master”, por dhe për të evituar keqkuptimet e keqinterpretimet, po ndalemi në mënyrë të grupuar në disa prej tyre.

Së pari, programet e ciklit të parë nga i njëjti institucion i arsimit të lartë. Për shkak të ndryshimeve të ndodhura nga koha në kohë, po përmend emërtimet e ndryshme që ka marrë institucioni shqiptar i arsimit të lartë policor, prej formimit në vitin 1971⁵, deri në vitin 2015. Në këtë mënyrë, bëhet fjalë për të njëjtin institucion të arsimit të lartë policor, efektivisht edhe për kryerje të studimeve të ciklit të parë, nga specialistët e diplomuar në Shkollën e Lartë të Ministrisë së Punëve të Brendshme; në Institutin e Lartë të Rendit; në Akademinë e Rendit; në Akademinë e Policisë dhe në Akademinë e Sigurisë.

Së dyti, programe studimesh jopolicore të ciklit të parë, në fusha të përafërta. Studime të kryera në institucione të tjera të arsimit të lartë, dhe që aplikantët, për të qenë efektivë të policisë, kanë kryer kursin përkatës të kualifikimit policor, deri në një vit akademik. Fjala është për specialistët që janë punonjës efektivë të policisë si ekspertet e policisë shkencore, specialistë të krimit ekonomik, të krimit financiar, atij kibernetik, etj.).

Së treti, programet e ciklit të parë, në institucione të arsimit të lartë jashtë vendit. Specialistëve të diplomuar në institucione të arsimit të lartë policor, jashtë shtetit, në një program studimi të ciklit të parë “bachelor”, në fushën e rendit dhe sigurisë publike dhe kanë kryer njësimin e diplomës në zyrën përkatëse pranë ministrisë që mbulon arsimin e lartë.

Së katërti, programet e ciklit të parë, në institucione të tjera, me debite në formim. Specialistëve që janë punonjës të Policisë së Shtetit, të diplomuar në një program studimesh jopolicore, të ciklit të parë (“bachelor”), të cilët vlerësohen me mungesë lëndësh e kreditesh formimi, për shkak se nuk kanë kryer kursin përkatës të kualifikimit policor akademik.

Sugjerohet që për këtë kategori specialistësh, para pranimitimi në programin master, të bëhen verifikime nëse kanë jo më pak se 2/3 e numrit të përgjithshëm të lëndëve, ose 120 kredite të fituara me programin jopolicor. Në të kundërt, nëse ata kanë me pak se 120 kredite ECTS për llogari të programit policor, nuk mundet të regjistrohen në programin “Master profesional”.

b. Lehtësira të tjera për ndjekjen e studimeve të ciklit të dytë. Gjatë gjithë procesit akademik të profilizimit dhe zhvillimit të karrierës nëpërmjet përfshirjes në programet

⁵ VKM nr. 184, datë 20.12.1971, “Mbi riorganizimin e Shkollës së Ministrisë së Punëve të Brendshme”, neni 1: “Shkolla ekzistuese e Ministrisë së Punëve të Brendshme, të ngrihet në rang shkolle të lartë trevjeçare”.

master, Akademia e Sigurisë, ndërmerr hapa efektive lehtësues që mundësojnë konkurrimin dhe për lehtësimin e programit. Të tilla janë, njohja dhe transferimi i krediteve të vlefshme të fituara, programet e përafërimit, plotësimi i debitit të krediteve, etj.

Njohja dhe transferimi i krediteve. Përveç konsiderimit të programeve të fushave të përafërta, të përshkruara më sipër, në programin e studimeve të ciklit të dytë “Master profesional për rendin dhe sigurinë publike”, është parashikuar që aplikantëve u krijohen mundësitë e transferimit të studimeve dhe krediteve të fituara nga ndjekja e programeve të studimit të së njëjtit cikël (të ciklit të dytë).

Është detyrë e departamentit profesional, të bëjë përcaktimet se cilët programe të masterave vlerësohen dhe duhet njohur si të përafërta me “Masterin profesional për rendin dhe sigurinë publike” dhe rekomandon njohjen e lëndëve dhe krediteve. Këtu mbahet parasysh që, për llogari të studimeve “master profesional”, mund të njihen jo më shumë se 1/4 e numrit të përgjithshëm të lëndëve ose deri në 20 kredite ECTS.

Edhe në këto raste, si kriter i transferimit të studimeve është të qenit punonjës i strukturave të policisë, i regjistruar në një program master dhe koha relativisht e pakët nga mbarimi apo ndërprerja përkohësisht e studimeve master.

Plotësimi i debiteve formuese. Për plotësimin e debiteve të formimit policor, para pranimit në programin master, fakulteti dhe departamenti profesional përcakton listën e lëndëve dhe procedurat për kryerjen e këtyre plotësimeve, duke organizuar për këtë qëllim edhe shërbime lehtësuese për studentët. Ndër lëndët kryesore që shtohen për këtë qëllim mund të jenë nga shërbimet e rendit e sigurisë publike, menaxhimi policor, investigimi policor, hetimi procedural, siguria rrugore, menaxhimi i kufijve, etj.

Programi i përafërimit. Është programi që lehtëson studimin në një program master, i cili nuk përputhet plotësisht me fushën e diplomës universitare bachelor, si dhe programi që lehtëson kalimin nga një program i përafërt “master”, në një program “master profesional” policor. Ky parashikon një program shtesë, i cili plotëson formimin bazë në fushën e studimeve. Përmbajtja e këtij programi përcaktohet nga departamenti profesional që përgjigjet për programin dhe mund të parashikojë ndjekjen e kurseve të leksioneve ose realizimin e detyrave.

5. Vështrim analitik i strukturës së programit dhe raporteve brenda planit

Studimet “Master profesional për rendin e sigurinë publike” janë studime me kohë të plotë, të organizuara në bazë modulesh dhe të vlerësuara në kredite, sipas “Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve” (ECTS). Ato realizohen me një kohëzgjatje normale në një vit akademik dhe kanë 60 kredite ECTS.

Viti mësimor është planifikuar të zgjasë 30 deri 32 javë, i ndarë në dy semestra mësimore, me nga 15-16 javë dhe me sezone provimesh për çdo semestër. Në fund, studenti duhet të përgatisë një punim apo temë diplome, për të cilën vlerësohet me notë.

Në programin e studimeve “Master profesional për sigurinë publike”, i cili përbëhet nga 13 lëndë, përfshihen disiplina mësimore të karakterit të ngushtë profesional-policor, por dhe te karakterit të përgjithshëm shoqëror, kushtetues e juridik.

Ndër veprimtaritë formuese që parashikohen në program veçohen: mësimi në auditor (leksione, seminare, ushtrime, laboratorë); studimi individual (hulumtim, kërkim,

Taçi, P.
« Studimet
“Master”,
kusht
i domosdoshëm
për një polici
profesionale.»

Policimi
dhe
Siguria
nr.5, 2017

studim, punim relacionesh, detyrash apo projektsh, përgatitje provimesh, përgatitje e tezës së diplomës etj.) dhe veprimtari të tjera, si praktika profesionale dhe vendosja në rol pranë strukturave vendore të policisë.

Ndarja e krediteve sipas kategorisë së lëndëve. Një vështrim i përgjithshëm analitik e krahasimor mbi programin e studimeve dhe planin mësimor, për përkatësinë dhe karakterin e lëndëve, për raportet teori-praktikë, ndarjen e orëve dhe krediteve ECTS, evidentohet se:

a. Përkatësia e lëndëve të programit. Në tërësinë e krediteve që përfshin programi, 50% janë disiplinat e formimit profesional; 13.3% disiplinat e ngjashme me ato profesionale dhe/ose integruese; 13% disiplinat e formimit të përgjithshëm; 10% veprimtaritë praktike dhe aftësim informatik; 6.6% disiplina të zgjedhura nga studenti dhe 6.6% punimi i diplomës të marrë studenti që ndjek këtë program studimi, do të marrë së paku:

- Në grupin e lëndëve dhe moduleve profesionale, të kategorisë “B”, përfshi dhe kategoritë “C” e “D”, janë 10 lëndë, që zënë rreth 69.3 % dhe kanë 70% të krediteve ECTS.

- Pjesa tjetër, e lëndëve, 4 lëndë, ose 30.7%, i përkasin formimit universitar të kategorizuara në grupin “A” dhe “E”, të cilat kanë 30% të krediteve ECTS.

b. Raportet e brendshme në planin mësimor. Studimi i raporteve midis orëve, veçanërisht midis mësimave teorike (leksioneve) dhe seminareve, punës praktike dhe kontrollit të dijeve në auditor, përftohet konkretisht kjo ndarje:

- nga 1500 orë mësimi në total, rreth 705 orë, afërsisht 46%, janë orë mësimi në auditor (leksione, seminare, punë praktike, etj.);

- nga tërësia e tyre, 420 orë, ose 28% i zënë leksionet që zhvillohen në auditor apo mjedise të tjera akademike; ndërkohë që seminarat dhe mësimet praktike janë 345 orë dhe zënë rreth 23% të tyre dhe orët e punëve apo mësimave praktike janë 570 ose 50.9%;

- pjesa tjetër, 795 orë, ose rreth 54% e gjithë orëve të programit, janë studim individual i pavarur, të cilat i kushtohen kryesisht studimit të literaturës së rekomanduar, punim relacionesh, detyrash apo projektsh, përgatitje provimesh, etj. Sqarojmë se, në këtë grup orësh, përfshihen dhe veprimtari të tilla si praktika profesionale apo stazhi pranë strukturave vendore e rajonale të policisë dhe përgatitja e tezës së diplomës.

c. Impakti në formimin e studentëve. Nga ballafaqimi i shifrave të sipërpërmendura, e gjejmë me vend e të rregullt raportin në përqindje 54/46, të kohës së studimit individual dhe studimit në auditor. Rritja e kohës së studimit të pavarur apo individual, do të bëjë që, tek studenti të kultivohet e rritet përgjegjshmëria personale, ndjenja për të punuar në mënyrë të pavarur, për t’u përshtatur me situatat dhe për të zbatuar njohuritë në praktikë. Sikurse do të krijohen e zhvillohen tek ai aftësitë organizative të planifikimit e kontrollit, rritja e iniciativës dhe frymës sipërmarrëse, aftësive të komunikimit e bashkëpunimit me ekspertë të fushave të tjera, të vlerësimit dhe respektimit të zgjidhjeve alternative dhe mendimit ndryshe, etj.

6. Pritshmëritë dhe efektet e programit “master”

Programi i studimeve “Master profesional” është produkt i punës së profesorit dhe specialistëve me përvojë akademike të departamenteve të Fakultetit të Sigurisë, të cilët gjatë semestrit të dytë, krahas punës për realizimin e procesit mësimor, u përfshinë

në hartimin e planeve, programeve dhe kurrikulës së këtij programi studimesh. Vëmendje e posaçme iu kushtua takimeve me grupet e interesit dhe faktorët institucionale për marrjen e mendimeve, vlerësimeve dhe sugjerimeve të tyre, për disa nga çështjet më themelore si: drejtimit ku duhet të thellohet veprimtaria akademike për të rritur integrimin me veprimtarinë praktike; “në cilat aspekte mendohet se duhet përmirësuar profili i menaxherit profesionist të rendit, sigurisë dhe luftës ndaj krimit?”; “çfarë mekanizmash duhen aktivizuar që specialisti dhe menaxheri i ditëve tona të përvetësojë kulturë qytetare, dije të thella profesionale, aftësi dhe kompetenca menaxheriale?”; “çfarë përgatitje plus duhet për t’u përballur me zhvillimet në fushën e rendit dhe krimit?”, etj.

Mbështetur edhe në disa nga programet e shkollave të homologëve tanë Perëndimorë u hartuan objektiva të qarta formuese e profesionale, konkrete, të arritshme dhe me synime ambicioze për realizimin e programit, në pajtim me kërkesat e kohës. Të gjitha këto, rritin besueshmërinë tonë për efekte dhe pritshmëri pozitive. Në përfundim të këtij programi studimesh, menaxherët e ardhshëm të policisë, do të kenë përfituar:

- Njohuri e aftësi të gjera e të thelluara profesionale, aftësi për vlerësim kritik dhe mendim analitik të pavarur, për të zgjidhur probleme komplekse dhe për t’u rritur në karrierë. Këto do të reflektohen në përmirësimin e niveleve të drejtimit, menaxhimit dhe rritjes së kapaciteteve organizative, administrative e operacionale të strukturave dhe shërbimeve policore, si dhe realizimin e kompletimit me infrastrukturën e nevojshme ligjore, nënligjore e normative.

- Rritjen e aftësive analitike dhe gjetjen e shkaqeve që shtyjnë personelin policor në krime apo në cenim të marrëdhënieve me publikun; adaptimin e praktikave transparente për rekrutimin e personelit policor dhe veprimtari të tjera që lidhen me detyrat, të drejtat dhe karrierën përkundrajt gjetjes dhe zbatimit të procedurave që parandalojnë emërimet, gradimet, shkarkimet dhe përjashtimet e pamërituara. Rikonceptim i mënyrave të plotësimit të nevojave që ka policia për resurse të afta profesionalisht dhe specialistë me nivel të lartë e të përputhshëm me zhvillimin social e ekonomik, të cilët do të zhvillojnë më tej interesat e vlerat kombëtare.

- Hartimin e programeve të zhvillimit sipas standardeve të përafuara me institucionet e vendeve Perëndimore; shpejtimin e ritmeve për kualifikimin e trupës policore për plotësimin e nevojave për ndryshim dhe zhvillimin e kapaciteteve drejtuese të Policisë dhe strukturave të saja; kompetenca e njohuri të thelluara mbi organizimin, misionin dhe detyrat institucionale të policisë dhe sistemin normativ bazë që rregullon veprimtarinë e saj, për ligjet që ngarkojnë atë me detyra, të drejta e attribute, si dhe me koncepte e shprehje të qarta profesionale mbi policimin komunitar demokratik.

- Njohuri për metodologjitë parandaluese, mënyrat e zgjidhjes së konflikteve dhe masat e veprimet ligjore e procedurale në rast ngjarjesh e situatash të veçanta për rendin e sigurinë, duke bashkënduar e menaxhuar tërësinë e resurseve materiale dhe burimeve njerëzore. Rritjen e koordinimit dhe ndërveprimit për shërbimet ekzekutive për rendin, qarkullimin rrugor, shërbimet e emergjencës, kontrollin e krimit, etj., si dhe gjallërimin e mekanizmave monitorues të punës dhe performancës së sektorëve dhe drejtuesve të policisë.

- Njohuri të thelluara dhe aftësi menaxhuese e drejtuese lidhur me shërbimet ekzekutive për kontrollin e territorit, mbikëqyrjen dhe kontrollin e kufirit dhe migracionit, parandalimin e aksidenteve dhe rritjen e sigurisë rrugore, për shërbimet e

Taçi, P.
« Studimet
“Master”,
kusht
i domosdoshëm
për një polici
profesionale.»

Policimi
dhe
Siguria
nr.5, 2017

emergjencës dhe ndihmës së parë për qytetarët etj., dije të plota dhe aftësi analitike, abstraguese e përgjithësuese për veprimtarinë kriminale dhe dukuritë e cenimeve të renda të rendit e sigurisë, si dhe shprehitë e nevojshme për ushtrimin e veprimtarisë studimore e kërkimore në fushën e policisë etj.

- Dije të thella profesionale për ushtrimin me kompetencë të detyrave dhe atributëve të policisë gjyqësore në fushën e hetimit të krimeve dhe njohuri të plota teoriko-praktike për mjetet e metodat shkencore dhe teknikat speciale investigative të policisë, të autorizuar nga ligji procedural penal. të njohje plotësisht parimet dhe taktikat e operimit informativ e gjurmues dhe mënyrat e marrjes e të trajtimit të informacionit kriminal, etj.; njohës, zotërues e përdorues të metodave e teknikave bashkëkohore në luftën kundër krimit të organizuar, trafiqeve kriminale, të terrorizmit etj.

7. Përfundime

- Rihapja e Akademisë së Sigurisë, vazhdimi i studimeve në ciklin “bachelor” dhe kërkesa për çeljen e programit të studimeve të nivelit “Master për rendin dhe sigurinë publike”, do të rritin mundësitë e bashkëpunimit me institucionet e larta arsimore brenda dhe jashtë vendit dhe do të shpejtojnë procesin e eliminimit të pasojave negative në fushën e edukimit, shkaktuar nga mbyllja e Akademisë së Policisë dhe ndërprerja pa motiv e studimeve të larta për rendin, sigurinë publike dhe luftën ndaj krimit.

- Hartimi i programit të studimeve “Master profesional për rendin dhe sigurinë publike” dhe formalizimi në MAS, i kërkesës dhe dokumentacionit zyrtar për fillimin e studimeve të këtij cikli, përbën një eveniment të rëndësishëm për zhvillimin institucional, akademik e shkencor të shkollës shqiptare të policisë dhe realizimin e projekteve, angazhimeve e objektivave tejet ambicioze të Akademisë së Sigurisë.

- Çelja e studimeve materiale, veçse të qenit një hap i rëndësishëm, është edhe pjesë e vendimit për përfshirjen e institucioneve të arsimit policor në reformën madhore të arsimit të lartë në vend, është ndër zgjidhjet efikase me anë të së cilave shteti adresoi e vuri në rrugën e zgjidhjes nevojat e rritjes së aftësive dhe kapaciteteve profesionale të Policisë, në përmbushje të kërkesave të komunitetit për një polici efçente e korrekte në shërbim të tyre.

- Hapja dhe realizimi i programit të studimeve të ciklit të dytë “Master profesional” për rendin dhe sigurinë publike”, do të plotësojë nevojat e policisë për shtimin dhe zhvillimin e kapaciteteve profesionale e drejtuese të saj, me specialistë me njohuri të thelluara në fushën e rendit e sigurisë publike, të aftë për të shërbyer në të gjitha strukturat, shërbimet dhe funksionet drejtuese e menaxheriale, me kulturë të gjerë dhe standarde të larta etike e profesionale, por dhe me aftësi praktike e shprehi inovative në zgjidhjen e situatave të rendit e sigurisë.

- Objektivat për të përgatitur menaxhere dhe drejtues të lartë policie, me kulturë, me dije dhe standarde të larta etike e profesionale, njohës të mirë të ligjit, misionit dhe përgjegjësive të policisë, për t’iu kundërvënë perfeksionimit të metodave të elementeve kriminalë dhe veprimtarisë së tyre, përbëjnë një sfidë për studentët dhe personelin akademik.

- Hapja e këtij programi studimesh dhe diploma “master” është një portë e hapur për karrierë policore apo për të vazhduar nivele më të larta studimesh akademike, për “master i shkencave” dhe “doktoraturë”. Në këtë mënyrë, në një të ardhme të afërt, do të kemi edhe në polici një elite profesionistësh, të aftë për realizimin e përgjegjësive

ligjore e institucionale të Policisë së Shtetit dhe nevojave të publikut për më shumë rend, siguri dhe luftë ndaj krimit.

Bibliografi

1. Ligj nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në institucionet e arsimit të lartë në RSH".
2. Ligji nr. 108/2014 "Për Policinë e Shtetit".
3. VKM, nr. 524, datë 1.8.2003, "Për hapjen e Shkollës Pasuniversitare, pranë Akademisë së Policisë 'Arben Zylyftari'".
4. VKM nr. 184, datë 20.12.1971, "Mbi riorganizimin e Shkollës së Ministrisë së Punëve të Brendshme".
5. Ligj nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në institucionet e Arsimit të Lartë në RSH".
6. VKM nr. 185, datë 25.2.2015, "Për organizimin dhe funksionimin e Akademisë së Sigurisë".
7. Udhëzimin e Ministrisë së Arsimit nr. 14, datë 3.4.2008, "Për hapjen dhe organizimin e programeve të studimit të ciklit të dytë në institucionet publike të arsimit të lartë".
8. Statuti i Akademisë së Sigurisë.
9. Rregullore e Brendshme e Akademisë së Sigurisë.
10. Propozim për hapjen dhe organizimin e programit të studimeve të ciklit të dytë "Master profesional për rendin dhe sigurinë publike".
11. Rregullore e programit "Master profesional për rendin dhe sigurinë publike".

Taçi, P.

« Studimet "Master", kusht i domosdoshëm për një polici profesionale. »

Policimi dhe Siguria
nr.5, 2017

Përballja dhe lufta kundër korrupsionit policor, forcon organizatën tonë policore



■ **Dr. Xhavit SHALA**
Akademia e Sigurisë

Abstrakt

Objekti i studimit dhe i hulumtimit në këtë punim është trajtimi i korrupsionit policor si rrezik e kërcënim për sigurinë e legjitimitetin e organizatës policore, rëndësinë e përballjes me këtë fenomen si dhe rolin e institucioneve të mbikëqyrjes e kontrollit në luftën ndaj tij. Korrupsioni është një fenomen negativ i shoqërisë me rrezikshmëri shoqërore të madhe. Ai përbën një rrezik dhe, nëse nuk menaxhohet, nga rrezik kthehet në një kërcënim për sigurinë kombëtare. Edhe në strategjinë tonë të sigurisë kombëtare korrupsioni përfshihet në kategorinë e rreziqeve të cilat kanë prioritetin më të lartë për sigurinë e RSH-së dhe se gjërat e shfaqjes dhe pasojat e tyre për sigurinë kombëtare vlerësohen të larta. Korrupsioni policor minon efikasitetin e zbatimit të ligjit, efikasitetin dhe legjitimitetin e organizatës policore në kryerjen e funksioneve dhe gërryen besimin e publikut në zbatimin e ligjit dhe drejtësinë. Ai përfshin sjellje të paligjshme, por edhe veprime, të cilat, megjithëse nuk mund të jenë të paligjshme, mund të konsiderohen si sjellje të papërshtatshme për oficerët e policisë, sjellje që bien ndesh me integritetin policor, prirjen e punonjësve të policisë për t'i rezistuar tundimit të abuzimit me të drejtat dhe privilegjet që ofron profesioni i tyre.

Korrupsioni policor përbën një rrezik për besimin dhe legjitimitetin e organizatës policore dhe, nëse nuk menaxhohet apo keq menaxhohet, lufta ndaj këtij fenomeni, e kthen atë nga rrezik në një kërcënim ekzistencial për legjitimitetin e organizatës policore. Identifikimi, vlerësimi dhe përballja e organizatës sonë policore me këtë rrezik tregon aftësinë, forcën e jo dobësinë Policisë së Shtetit.

Gjatë këtij punimi janë aplikuar metodat dhe instrumentet bazë kërkimore shkencore, sasore dhe cilësore, si metoda e analizës dhe sintezës, analizës krahasuese, ajo historike, juridike, e krahasimit dhe konfrontimit si dhe e studimit të rastit. Në përfundim të punimit konkludohet, ndërmjet të tjerave se, sigurizimi i korrupsionit policor dhe intensifikimi i punës për parandalimin, zbulimin dhe goditjen e tij si nga vetë organizata policore, ashtu dhe nga strukturat e specializuara të mbikëqyrjes dhe kontrollit të saj, për të hequr jo vetëm "mollën e kalbur" apo "arkën me mollë të prishura", por edhe për të prerë nëse duhet edhe "degën e kalbur", është një investim i kryer në drejtimin e duhur për minimizimin e këtij rreziku për sigurinë dhe legjitimitetin e organizatës tonë policore.

Shala, XH.
« Përballja dhe lufta kundër korrupsionit policor, forcon organizatën tonë policore »

Policimi dhe Siguria nr.5, 2017

Fjalëkyçe:

korruption policor, rrezik, kërcënim, siguri, organizatë policore, SHÇBA, performancë, mbikëqyrje dhe kontroll i jashtëm.

1. Korrupsioni si rrezik e kërcënim për sigurinë

Korrupsioni përbën një rrezik¹ dhe nëse nuk menaxhohet ky rrezik, kthehet në një kërcënim² për sigurinë kombëtare, rajonale e më gjerë. Koncepti për korrupsionin në vetvete ka qenë në fokusin e shkencëtarëve të shkencave sociale për shumë vite. Kjo ndërthur në vetvete si anën juridike ashtu dhe psikologjike të perceptimit të saj. Për korrupsionin, ashtu si për krimin e organizuar dhe terrorizmin, akoma deri me sot nuk ka një përkufizim të pranuar ndërkombëtarisht. Pavarësisht kësaj, “Grupi i ekspertëve të Interpolit mbi korrupsionin” bie dakord të japë për korrupsionin një përkufizim të zgjeruar, duke përfshirë në të “çdo veprim ose mosveprim nga individë ose organizata, publike ose private, në kundërshtim me ligjin ose besimin për qëllime përfitimi”³. Ky përkufizim i gjerë mund të jetë i pranueshëm si për individë ashtu dhe grupe, pra si për punonjës policie, ashtu dhe për njësi policore. Ekzistojnë disa lloje korrupsioni. Në legjislacionin tonë, korrupsioni përgjithësisht njihet në dy forma, pasiv dhe aktiv, parashikuar përkatësisht nga nenet 244⁴ dhe 259⁵ të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

Shpesh përdoret dhe terminologjia si “korrupsioni i zi”, “korrupsioni i bardhë” apo dhe “korrupsioni gri”⁶. Kjo ndarje mbështetet në supozimin se disa shprehje të korrupsionit janë në themel të pranueshme nga publiku dhe zyrtarët publikë dhe se elitat dhe publiku kanë pikëpamje të ndryshme për atë se çfarë përbën korrupsion. “Korrupsioni i zi” perceptohet nga të dy palët si i papranueshëm, “korrupsioni i bardhë” perceptohet nga të dy palët si i mirë⁷, ndërsa “korrupsioni gri” është kur të dy palët kanë mosmarrëveshje rreth pranimit apo jo të tij.

Shala, XH.

« Përballja dhe lufta kundër korrupsionit policor, forcon organizatën tonë policore »

Policimi dhe Siguria
nr.5, 2017

Korrupsioni është një fenomen negativ i shoqërisë me rrezikshmëri shoqërore të madhe pasi cenon autoritetin e shërbimit publik dhe të vetë shtetit⁸, pengon rritjen ekonomike, rrezikon stabilitetin financiar, dobëson aftësitë e Shtetit për të siguruar të mirat e nevojshme, dekurajon bizneset e rregullta, dobëson klasën e mesme, pengon investimet e huaja, dëmton integritetin moral dhe deformat karakterin e njeriut⁹, kërcënon, integritetin e ligjit dhe veprimtarinë e institucioneve gjyqësore në vend, duke rrezikuar kështu sigurinë tonë kombëtare.

Edhe në strategjinë tonë të sigurisë kombëtare korrupsioni vlerësohet si rrezik për sigurinë kombëtare. Ai është përfshirë në kategorinë e rreziqeve të cilat kanë prioritetin më të lartë për sigurinë e RSH-së dhe se "...gjasat e shfaqjes dhe pasojat e tyre për sigurinë kombëtare vlerësohen të larta"¹⁰.

Në këtë dokument strategjik përcaktohet se "...siguria e vendit vijon ende të jetë e varur ndjeshëm edhe nga rreziqe me natyrë të brendshme. Ato burojnë mbi të gjitha nga korrupsioni dhe krimi i organizuar, të cilat cenojnë shtetin e së drejtës, institucionet tona kombëtare dhe prosperitetin e ekonomisë"¹¹. Kjo pasi "korrupsioni apo perceptimi mbi nivelin e tij, minon besimin e publikut tek qeverisja e mirë dhe sundimi i ligjit, si dhe dekurajon investimet e brendshme dhe të huaja, të nevojshme për të krijuar mundësi punësimi për të gjithë"¹². Kështu ai kthehet në një "...rrezik serioz për performancën e institucioneve shtetërore"¹³. Korrupsioni vlerësohet si rrezik në planin rajonal, por edhe atë global. "Krimi i organizuar rajonal, korrupsioni dhe interesat oligarkikë rrezikojnë qëndrueshmërinë e rajonit"¹⁴. Por "këto rreziqe komplekse mbartin, gjithashtu, edhe komponentë të jashtëm, duke krijuar sfida të reja në marrëdhëniet ndërkombëtare dhe kohezionin social"¹⁵.

Pra, korrupsioni përbën një rrezik dhe, mosmenaxhimi apo keqmenaxhimi në kohë i këtij rreziku, mund ta kthejë atë në një kërcënim serioz për sigurinë kombëtare, rajonale dhe më gjerë.

2. Korrupsioni policor si rrezik e kërcënim për sigurinë dhe legjitimitetin e organizatës policore.

Përkufizimi, tiparet e format kryesore të shfaqjes së tij.

Fushat në të cilat sot ekziston një rrezik i shtuar për korrupsion janë institucionet shtetërore që ofrojnë shërbime si sistemi doganor dhe tatimor; sistemi i drejtësisë, Policia¹⁶, etj. Rastet e korrupsionit në polici perceptohen dhe vlerësohen nga publiku si shumë më të rënda se rastet e ngjashme në strukturat e tjera të shtetit. Kjo sepse punonjësit e policisë janë "aktorët e vijës së parë" në sistemin e drejtësisë penale. Ata janë përgjegjës për zbatimin e ligjit, garantimin e sigurisë publike dhe mbrojtjen e jetës, shëndetit dhe të drejtave të qytetarëve¹⁷ dhe se publiku (dhe jo vetëm), në perceptimin e tij pret nga policia që të kontrollojë sjelljen e të tjerëve, përfshirë atë të zyrtarëve të shtetit dhe, nëse policisë nuk mund t'i besohet, nuk ka ndonjë agjenci tjetër tek e cila publiku të mund të mbështetet për të zbatuar ligjin dhe ruajtur rendin e sigurinë.

Korrupsioni policor minon efikasitetin e zbatimit të ligjit, efikasitetin dhe legjitimitetin e shërbimeve dhe forcave policore në kryerjen e funksioneve dhe gërryen besimin e publikut në zbatimin e ligjit dhe drejtësinë.¹⁸ Ai përbën një rrezik për besimin dhe legjitimitetin e organizatës policore dhe, nëse nuk menaxhohet apo keqmenaxhohet lufta ndaj këtij fenomeni, korrupsioni policor kthehet nga rrezik në një kërcënim ekzistencial për legjitimitetin e njësisë apo organizatës policore.

Shala, XH.
« Përballja dhe
lufta kundër
korrupsionit
policor, forcon
organizatën tonë
policore »

Policimi
dhe
Siguria
nr.5, 2017

Për këtë mjafton të marrim si rast studimor Komisariatin e Policisë Lushnjë në vitet 1997-1999. Kjo strukturë policore për shkak të korrupsionit policor dhe jo vetëm, humbi besimin dhe legjitimitetin përpara komunitetit. Njerëzit, për të zgjidhur problemet e tyre, shpesh i drejtoheshin të ashtuquajturit “Komisariati i Policisë Nr. 2”, një organizatë kriminale e paramilitare që kishte marrë edhe “kompetenca policore”.

Lufta kundër korrupsionit në polici merr një rëndësi të veçantë. Nisur nga kjo rëndësi dhe ndjeshmëri, Interpoli që në vitin 1998, angazhoi ekspertët më të mirë ndërkombëtarë të zbatimit të ligjit për të hartuar “Standartet ndërkombëtare kundër korrupsionit në forcat dhe shërbimet policore”, të cilat u miratuan nga Sesioni i 68-të i Asamblesë së Përgjithshme të Interpolit në vitin 1999, në Korenë e Jugut. Këtë dokument kam pasur fatin dhe privilegjin ta votoj si kryetar i delegacionit të Policisë Shqiptare në këtë sesion të Asamblesë së Përgjithshme të Interpolit, mbajtur në Seul¹⁹.

Në nenin 2/1 të këtij dokumenti korrupsionin policor përkufizohet si: “Kërkesa ose pranimi (i drejtpërdrejtë ose indirekt) nga personeli i policisë i parave, sendeve me vlerë, dhuratave, favoreve, premtimeve, shpërblimeve ose përfitimeve, për veten e tij/saj apo për këdo person, grup ose entitet, në këmbim të çdo veprimi apo mosveprimi (dështimi për të vepruar) të kryer ose premtuar për mosveprim ose mosveprim në të ardhmen gjatë kryerjes, ose që lidhet me kryerjen e çdo funksioni të kontrollit policor ose që lidhet me të²⁰”.

Korrupsioni policor përfshin sjellje të paligjshme, por edhe veprime të cilat, megjithëse nuk mund të jenë të paligjshme, mund të konsiderohen si sjellje të papërshtatshme për oficerët e policisë²¹. Është në njëfarë mënyre poli i kundërt i integritetit policor, i cili përshin “prirjen e punonjësve të policisë për t’i rezistuar tundimit për të abuzuar me të drejtat dhe privilegjet që ofron profesioni i tyre²²”.

Në literaturën ndërkombëtare njihen dhe të tjera emërtime për korrupsionin policor. Kështu, në raportin e Komisionit Knapp²³, i cili hetoi korrupsionin në Departamentin e Policisë së Nju Jorkut në vitin 1970 gjejmë terma si korrupsioni “barngrënës”(reagues) i cili i referohet situatës ku një oficer pranon një ryshfet kur i ofrohet, ndërsa korrupsioni “mishngrënës” (proaktiv) tregon situatën kur një oficer policie kërkon ryshfet. Etiketime të tilla për personat që zhvillojnë korrupsion gjen dhe në gjuhën shqipe. Kështu, korrupsionit “barngrënës” mund t’i shkonte për shtat në gjuhën shqipe shprehja “ai ha si miu”, ndërsa atij “mishngrënës” mund t’i përkonte shprehja shqipe “ai ha si ariu”. Programi i USAID mbi antikorrupsionin dhe integritetin policor²⁴ e klasifikon korrupsionin në katër kategori: korrupsion i vogël/individual²⁵, korrupsioni zyrtar (burokratik)²⁶, korrupsioni kriminal²⁷ dhe korrupsioni politik²⁸.

Departamenti Amerikan i Shtetit në “Raportin për të drejtat e njeriut - Shqipëria 2016” thekson se, edhe për vitin 2016 “...korrupsioni në radhët e policisë mbeti problem...”²⁹. Gjithashtu, Kryeministri i Shqipërisë, duke i bërë një analizë të thellë dobësive në përballjen me fenomenin e kultivimit të bimëve narkotike, evidentoi se “...pjesë e këtyre dobësive është edhe korrupsioni i punonjësve të policisë, korrupsioni i drejtuesve të policisë, i shefave të krimeve apo shefave të komisariateve, të përfshirë drejtpërdrejtë në një marrëdhënie krejtësisht kriminale me organizatoret e këtij rrjeti kultivimi dhe trafikimi...”³⁰. Prandaj në vendin tonë korrupsioni policor është një çështje që duhet mbajtur në vazhdimësi e sigurizuar³¹.

Përgjithësisht studiuesit bashkohen në evidentimin e tre tipareve të përbashkëta të korrupsionit policor që përbëjnë kërcënim për integritetin policor dhe konkretisht: “Tipari i parë është ai që quhet “muri blu” ose “kodi blu i heshtjes”³², një version

Shala, XH.
« Përballja dhe lufta kundër korrupsionit policor, forcon organizatën tonë policore »

Policimi dhe Siguria
nr.5, 2017

policor i “omertà”-s. Kjo mund të shfaqet në formën e thjeshtë të mbulimit të gabimeve të sinqerta të tjerëve apo për fshehjen e sjelljes së keqe të tyre. Anketimet e kryera në mesin e punonjësve tanë të policisë në vitin 2016, tregojnë se “kodi blu i heshtjes” është jo pak i përhapur dhe në organizatën tonë policore. Kultura e heshtjes ndaj denoncimit të akteve korruptive të kolegëve vazhdon të jetë kulturë dominuese edhe në Policinë e Shtetit dhe gatishmëria për raportimin e shkeljeve vazhdon të mbetet e ulët³³ (46% e punonjësve të policisë pranojnë se në PSH ka të korruptuar mes tyre dhe 12% e tyre thonë se korrupsioni në PSH është i përhapur në masë të konsiderueshme³⁴, ndërkohë që 95% e tyre thonë se nuk kanë denoncuar ndonjë punonjës policie dhe po 95% thonë se nuk kanë denoncuar eprorin për korrupsion)³⁵.

Tipari i dytë i korrupsionit policor është perceptimi midis punonjësve të policisë se disa aspekte të papërshtatshme të sjelljes së tyre janë të pranueshme. Ky koncept përmbledhet nga ata në termin “korrupsion për çështje të larta”, dhe është një shembull klasik i “korrupsionit gri”.³⁶ Në organizatën tonë policore, sipas një anketimi të kryer në vitin 2014, 34% e të anketuarve janë dakord dhe plotësisht dakord që disa rregulla edhe mund të shkelen nga oficerët e PSH për të mirën e punës³⁷.

Tipari i tretë i korrupsionit policor është “korrupsioni gjatë procesit”. Prej entuziazmit se po realizojnë me sukses dënimin e dikujt, punonjësit e policisë mund në disa raste të fusin (“falsifikojnë”), shtojnë (“mbushin”) dhe/ose fabrikojnë prova. Duke vepruar kështu ata dalin mbi ligjin dhe nuk ndjekin administrimin e drejtësisë sipas rregullave dhe parimeve³⁸. Në organizatën tonë policore, sipas anketimeve të vitit 2016, për 75% e të anketuarve manipulimin e provave nuk ndodh thujas asnjëherë ndërsa për 16% të tyre ndodh rrallëherë.³⁹

Forma më e përhapur dhe më e perceptuar e korrupsionit policor është pranimi i ryshfeteve. Llojet më të përhapura të korrupsionit për të cilat janë kryer hetime dhe hapur çështje penale përfshijnë korrupsionin pasiv, trafikimin apo kultivimin e narkotikëve, falsifikim të dokumenteve zyrtare, vjedhje, trafik të mjeteve motorike, përfshirje në shfrytëzim prostitucioni, etj.⁴⁰

Forma të tjera të sjelljes policore të cilat nëse lejohen, dëmtojnë besimin dhe imazhin e policisë në tërësi, dhe rrezikojnë legjitimitetin e organizatës policor janë: mospërfillja dhe anashkalimi e ligjit; mashtrimi; mohimi i kritikave, hetimeve të pavarura e sondazheve publike; ngacmimet brenda shërbimit policor; dhuna e tepërt dhe e panevojshme; paragjykim dhe racizmi; përzgjedhja dhe ngritja në detyrë me procedura të parregullta; kryerja e një pune të dytë në kundërshtim me ligjin; sjellja jo korrekte jashtë orarit të punës apo rastet e rënda të bashkëpunimit me kriminelët.

Sipas një anketimit të kryer në vitin 2016 nga IDM⁴¹, 36% e punonjësve të policisë të anketuar e kanë pranuar përhapjen e korrupsionit në organizatën policore “pak, raste të izoluara”, ndërkohë që për 28% të së anketuarve korrupsioni “ekziston, por nuk është në nivele serioze”; për 12% të së anketuarve korrupsioni “është i përhapur në një masë të konsiderueshme” dhe vetëm për 8% të anketuarve korrupsioni në organizatën policore “nuk ekziston”⁴².

Ndër shkaqet e brendshme, pagat e ulëta (52%), trajnimi i dobët (28%), dhe kultura e punës (28%) shihen si faktorët më me ndikim në përhapjen e korrupsionit policor⁴³. Anketimet brenda vetë organizatës tregojnë gjithashtu dhe për një shkallë të lartë tolerance ndaj shkeljeve dhe një nivel të ulët të gatishmërisë së punonjësve të policisë për të raportuar shkeljen e një kolegu⁴⁴.

Shala, XH.
« Përballja dhe
lufta kundër
korrupsionit
policor, forcon
organizatën tonë
policore »


Policimi
dhe
Siguria
nr.5, 2017

3. Përballja dhe lufta kundër korrupsionit policor forcon organizatën tonë policore.

Identifikimi, vlerësimi dhe vendosmëria e përtalljes së organizatës sonë policore me korrupsionin policor tregon aftësinë, forcën e jo dobësinë saj. “Të shikuarit në sy të këtij problemi nuk është aspak dobësi, por është forcë për t’u përballur me një dobësi që cenon në mënyrë tërësisht të padrejtë punën” e Policisë së Shtetit⁴⁵.

Më sipër trajtuam se korrupsioni policor përfshin sjellje të paligjshme, por edhe veprime, të cilat, megjithëse nuk mund të jenë të paligjshme, mund të konsiderohen si sjellje të papërshtatshme për oficerët e policisë, sjellje që binin ndesh me integritetin policor, prirjen e punonjësve të policisë për t’i rezistuar tundimit për të abuzuar me të drejtat dhe privilegjet që ofron profesioni i tyre. Parë nga ky këndvështrim parandalimi, zbulimi dhe goditja e korrupsionit policor nga vetë organizata policore merr një rëndësi të madhe. Edhe vetë punonjësit e policisë (63% e të anketuarve besojnë se Policia e Shtetit është plotësisht e aftë të luftojë korrupsionin brenda vetes, ndërsa 31% besojnë se ajo është e aftë ta bëjë këtë deri në një farë mase. Ndërkohë, vetëm 2% të punonjësve të policisë të anketuar nuk besojnë aspak se policia është e aftë të luftojë korrupsionin brenda vetes)⁴⁶

Për t’u përballur me këtë fenomen puna fillon që me vlerësimin e performancës⁴⁷ brenda vetë organizatës. Ky vlerësim i brendshëm bëhet në dy forma: si vetëvlerësim i strukturave të policisë dhe vlerësimi nga Drejtoria e Standardeve Profesionale, strukturë kjo e profilizuar për këtë problem brenda organizatës. Indikatorët kryesorë të vlerësimit të performancës janë ligjshmëria, integriteti, profesionalizmi, paanësia, transparencja. Dinamika e vlerësimit të performancës së strukturave policore, realizuar nga Drejtoria e Standardeve Profesionale nga viti 2009 deri në 6 mujorin parë të vitit 2016,⁴⁸ grafikisht paraqitet si më poshtë:



Shala, XH.
« Përballja dhe lufta kundër korrupsionit policor, forcon organizatën tonë policore »

Nga analiza grafike e të dhënave të vlerësimit të performancës së strukturave policore për vitet 2008-2016 konkludojmë se, ka një rritje të pakrahasueshme të numrit të strukturave policore që kanë kaluar në proces vlerësimi nga Drejtoria e Standardeve

Policimi dhe Siguria
nr.5, 2017

Profesionale, si dhe të punonjësve të ndëshkuar, por dhe të rekomandimeve të dhëna për përmirësimin e punës. Kështu numri i strukturave të vlerësuara në vitin 2015 krahasuar me ato të vlerësuara në vitin 2012 është rritur 6 herë, ndërsa numri i punonjësve të ndëshkuar për të njëjtën periudhë kohore është rritur 41.8 herë.

Edhe vetëvlerësimi i strukturave policore si dhe vlerësimi individual, puna parandaluese dhe ndëshkuese nëpërmjet procedimeve disiplinore që ato bëjnë për personelin e tyre ka shënuar një dinamikë në rritje. Dinamika e procedimeve disiplinore për periudhën 2008-2016, si dhe të masave të marra ndaj tyre, në paraqitje tabelore është si më poshtë.

Statistike e proceseve disiplinore 2008 - Shtator 2016								
VITI	Shkelje Disiplinore			Masa te marra për shkelje te rënda				
	Gjithsej	Te rënda	Te lehta	Perjashtime	Largime nga puna	Ujje në grade	Pezullim pa pagesë	Shtyrje e afatit te gradimit
2008	225	76	149	17		10	19	3
2009	464	273	191	39	2	26	53	72
2010	359	215	144	44	3	9	37	59
2011	389	232	157	62	12	10	46	60
2012	315	168	147	37	3	16	30	43
2013	349	261	88	68	10	23	76	84
2014	898	733	165	200	28	51	350	102
2015	778	386	392	115	7	20	108	136
2016	356	169	187	46	2	5	114	2
TOTALI	4133	2513	1620	628	67	170	833	561

Nga analiza e të dhënave statistikore të proceseve disiplinore si dhe të masave të marra për shkeljet e rënda konkludojmë se për vitet 2014 dhe 2015 ka një rritje të procedimeve disiplinore si dhe të masave të marra për shkeljet e rënda. Kështu, në vitin 2015, krahasuar me vitin 2012, numri i shkeljeve disiplinore të evidentuara është rritur 2.46 herë, ndërkohë që, për të njëjtën periudhë krahasuese, masat e marra për këto shkelje disiplinore kanë shënuar rritje përjashtimet nga policia 3.1 herë; largimet nga puna 2.3 herë; uljet në gradë 1.25 herë; pezullimet pa pagesë 3.6 herë dhe shtyrjet e afatit të gradimit 3.1 herë. Kjo tregon për një rritje të efektshmërisë së kontrollit të brendshëm në organizatën tonë policore.

Përveç kontrollit të brendshëm, një rol të rëndësishëm dhe të pazëvendësueshëm në luftën ndaj korrupsionit policor luajnë institucionet e mbikëqyrjes dhe kontrollit të jashtëm. Por, cilat janë dhe cili është roli i këtyre institucioneve në luftën kundër korrupsionit policor?

Në përgjithësi ekzekutivi, parlamenti, gjyqësori, avokati i popullit, institucionet investiguese të specializuara për parandalimin, zbulimin dhe hetimin e veprave penale, si dhe i shkeljeve të ligjit, të kryera nga punonjësit e strukturave policore gjatë ushtrimit të detyrës dhe për shkak të saj; organizatat e shoqërisë civile si dhe mediat pranohen si aktorë të ndryshëm të përfshirë në mbikëqyrjen dhe kontrollin e jashtëm të shërbimeve të policisë. Këto institucione ushtrojnë mbikëqyrje dhe kontrollin pro-aktiv dhe reaktiv të shërbimeve të policisë⁴⁹.

Mbikëqyrja dhe kontrolli pro-aktiv përfshin aktivitetet për të parandaluar


Shala, XH.
« Përballja dhe
lufta kundër
korrupsionit
policor, forcon
organizatën tonë
policore »

Policimi
dhe
Siguria
nr.5, 2017

korupsionin në polici para se ai të ndodhë. Ky aktivitet zakonisht fokusohet në identifikimin dhe adresimin e faktorëve sistematike që çojnë në korupsion si dhe në zgjidhjen e tyre me anë të legjislacionit, politikave dhe menaxhimit. Ndërsa mbikëqyrja dhe kontrolli reaktiv janë ngritur për të trajtuar rastet e korupsionit pasi të ndodhin. Një qasje reaktive e mbikëqyrjes ndaj korupsionit në polici mund të përkufizohet si përgjigje ndaj ankesave apo akuzave, dhe nëse janë konstatuar praktika korruptive, sanksionimin dhe hetim mbi individët e përfshirë dhe /ose rekomandim për reforma. Kjo ndihmon edhe në parandalimin e korupsionit në polici, pasi zbulimi dhe dënimi i oficerëve të policisë frenon anëtarët e tjerë të organizatës për të pranuar rryshfet.

Anketimet e bëra ndër qytetarët në përgjigje të pyetjes se “Sa besim keni se do të luftojnë korupsionin në polici institucionet e mbikëqyrjes së jashtme civile”, tregojnë se, krahasuar me vitin 2014, ka një rënie të theksuar të besimit të qytetarëve tek të gjitha institucionet, përveç SHÇBA-së dhe konkretisht: tek institucioni i Avokatit të Popullit kanë besim 32% e qytetarëve të anketuar ose 2% më pak se në vitin 2014; tek institucioni i Prokurorit të Përgjithshëm 24% ose 6 % më pak se në vitin 2014; tek institucioni i gjyqësorit 17% ose 4% më pak se në vitin 2014; tek Kontrolli i Lartë i Shtetit 23% ose 7% më pak se në vitin 2014; tek partitë politike 16% ose 2% më pak se në vitin 2014; tek SHÇBA-ja 33% ose njëlloj si në vitin 2014⁵⁰.

Për arsye kohe dhe vendi, nga institucionet e mbikëqyrjes dhe kontrollit të jashtëm në këtë punim do të trajtojmë vetëm rolin që luan SHÇBA-ja, si strukturë e jashtme e mbikëqyrjes dhe kontrollit, e specializuar për parandalimin, zbulimin dhe hetimin e veprave penale, si dhe të shkeljeve të ligjit, të kryera nga punonjësit e strukturave policore gjatë ushtrimit të detyrës dhe për shkak të saj. Këtë rol të rëndësishëm të saj e mbështetet edhe vetë organizata policore ku 55% e të anketuarve kanë shumë besim dhe besim në luftën antikorrupsion të SHÇBA-së (ndërkohë vetëm 24% nuk kanë besim dhe aspak besim se SHÇBA do të luftojë korupsionin)⁵¹. Rezultatet e luftës së SHÇBA-së në luftën kundër korupsionit policor ka shënuar ngritje. Për këtë mjafton të analizojmë të dhënat statistikore të numrit të punonjësve të policisë të proceduar penalisht dhe të atyre të arrestuar në vitet 2012-2015 të paraqitur në grafikët e mëposhtme.



Shala, XH.
« Përballja dhe lufta kundër korupsionit policor, forcon organizatën tonë policore »

52

Nga analiza krahasuese e të dhënave statistikore të numrit të punonjësve të policisë të proceduar penalisht dhe të arrestuar në vitet 2012-2013, me ato të viteve 2014-2015, gjejmë se në vitet 2014-2015, krahasuar me vitet 2012-2013, ka një rritje prej 1.8 herë të numrit të punonjësve të policisë të proceduar penalisht si dhe 2.4 herë, të

Policimi dhe Siguria
nr.5, 2017

numrit të punonjësve të policisë të arrestuar. Gjithashtu, për të njëjtën periudhë krahasuese janë rritur 10.6 herë numri i punonjësve të policisë në proces gjykimi; 1.66 herë numri i punonjësve të policisë të dënuar nga gjykata; 3.54 herë hetimet disiplinore; 2 herë inspektimet; 4.17 herë numri i ankesave të trajtuara.⁵³ Ndërkohë, edhe gjatë vitit 2016, në funksion të hetimit penal, nga strukturat vendore dhe qendrore të SHCBA-së janë dërguar pranë organit të Prokurorisë materialet kallëzuese ndaj punonjësve të policisë që dyshohet se kanë kryer elementë të veprës penale, konkretisht: 160 kallëzime penale për 180 persona, nga të cilët 42 punonjës policie i nivelit të parë drejtues dhe 127 punonjës policie të nivelit zbatues⁵⁴.

4. Përfundime

Pas studimit dhe hulumtimit në këtë punim të korrupsionit policor si rrezik e kërcënim për sigurinë dhe legjitimitetin e organizatës policore, rëndësinë e përballjes me këtë fenomen dhe rolin e institucioneve të mbikëqyrjes e kontrollit në luftën ndaj tij, arrijmë në këto përfundime:

- identifikimi, vlerësimi dhe përballja e organizatës sonë policore me korrupsionin policor është tregues i aftësisë, forcës e jo dobësisë së Policisë së Shtetit;

- korrupsioni policor përfshin sjellje të paligjshme si dhe veprime, të cilat, megjithëse nuk mund të jenë të paligjshme, mund të konsiderohen si sjellje të papërshtatshme për oficerët e policisë, sjellje që bien ndesh me integritetin policor, prirjen e punonjësve të policisë për t'i rezistuar tundimit të abuzimit me të drejtat dhe privilegjet që ofron profesioni i tyre;

- korrupsioni policor përbën një rrezik për besimin dhe legjitimitetin e organizatës policore dhe, nëse nuk menaxhohet apo keqmenaxhohet lufta ndaj këtij fenomeni, korrupsioni policor kthehet nga rrezik në një kërcënim ekzistencial për legjitimitetin e organizatës policore;

- parandalimi, zbulimi dhe goditja e korrupsionit policor nga vetë organizata policore merr një rëndësi të madhe. Përballja me këtë fenomen fillon me vlerësimin e performancës brenda vetë organizatës;

- SHÇBA-ja, si strukturë e jashtme e specializuar e mbikëqyrjes dhe kontrollit, po luan rol të rëndësishëm për parandalimin, zbulimin dhe hetimin e veprave penale, si dhe të shkeljeve të ligjit, të kryera nga punonjësit e strukturave policore gjatë ushtrimit të detyrës dhe për shkak të saj;

- sigurizimi i korrupsionit policor dhe intensifikimi i punës për parandalimin, zbulimin dhe goditja e tij si nga vetë organizata policore, ashtu dhe nga strukturat e specializuar të mbikëqyrjes dhe kontrollit të jashtëm, për të hequr jo vetëm “mollën e kalbur” apo “arkën me mollë të prishura”, por edhe për të prerë nëse duhet edhe “degën e kalbur”, është një investim i kryer në drejtimin e duhur për minimizimin e këtij rreziku për sigurinë dhe legjitimitetin e organizatës tonë policore.

5. Rekomandime

Disa rekomandime të shkurtra do të ishin si më poshtë:

- Ndjekja dhe zbatimi me korrektësi i masave që Strategjia e Rendit Publik për vitet 2015-2020 dhe Plani i Veprimit për zbatimin e saj, ka parashikuar, për forcimin e integritetit dhe uljen e nivelit të korrupsionit në polici.

Shala, XH.
« Përballja dhe
lufta kundër
korrupsionit
policor, forcon
organizatën tonë
policore »

Policimi
dhe
Siguria
nr.5, 2017

- Hartimi i “programeve të integritetit” dhe trajnimin e punonjësve të policisë me qëllim forcimin e integritetit policor si faktori kryesor për neutralizimin e korrupsionit policor dhe të sjelljeve të tjera negative të punonjësve të policisë.

- Përmirësimi i kapaciteteve trajnuese në Akademinë e Policisë përnjohjen dhe edukimin e punonjësve të policisë me rregullat antikorrupsion.

Referenca dhe shënime

1. Termi “rrezik” përfshin në vetvete një gjendje të përgjithshme jo të zakonshme, jo normale, e cila sjell destabilitet apo mënjanim nga zhvillimi normal i ngjarjeve dhe që rrezikon interesat kombëtare në përgjithësi.
2. Termi “kërcënim” nënkupton një zhvillim të shpejtë ose të përshkallëzuar të një rreziku konkret, të pa menaxhuar më parë ose të keq menaxhuar.
3. Leslie Holmes, *Corrupton and policing*, “Toolkiton Police Integrity”, DCAF, Geneva 2012, f.22.
4. Neni 244 i *Kodit Penal të RSH*, Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike.
5. Neni 259 i *Kodit Penal të RSH*, Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike.
6. Arnold J. Heidenheimer, Michael Johnston, *Political Corruption: Concepts nd Contexts*, New Jersey:2002, f.33,152,211.
7. *Forcimi i integritetit policor në Shqipëri*, IDM, Tiranë 2015, f.14.
Nga anketimet ka rezultuar se publiku toleron sjellje të caktuara korruptive apo dhe qëndrime jo të drejta të punonjësve të policisë ndaj korrupsionit. Kështu, 18% e të anketuarve “pranimin nga punonjës të policisë të shërbimeve falas nga subjekte private” nuk e konsiderojnë si shkelje, ndërsa 8-10% e të anketuarve nuk e konsiderojnë korrupsionin rastin kur një punonjës policie ndërhyr për të ndihmuar dikë për të përfutur një shërbim jashtë radhës, kur vetë punonjësi i policisë shkel rregullat e trafikut rrugor kur është jashtë shërbimit apo dhe në rast se punonjësi i policisë manipulon provat.
8. Kjo shprehet në formën e përfitimeve të paligjshme pasurore apo privilegje të tjera nga ana e funksionarëve publikë të cilëve u besohet miradministrimi i burimeve të caktuara.
9. Shala, Xhavit, “Korrupsioni dhe veçoritë e hetimit të tij”, ligjëratë e përgatitur për studentë të nivelit master në lëndën “E Drejtë Penale”.
10. *Strategjia e Sigurisë Kombëtare e Republikës së Shqipërisë*, miratuar me Ligjin Nr. 103/2014, f. 25.
11. Po aty, f. 5.
12. Po aty, f. 6.
13. Po aty, f. 20.
14. Po aty, f. 23.
15. *Strategjia e Sigurisë Kombëtare e Republikës së Shqipërisë*, miratuar me Ligjin Nr. 103/2014, f. 5. Burim i cituar.
16. Në përgjithësi, policia përkufizohet si një forcë civile, e cila ka përgjegjësi për të parandaluar dhe zbuluar krimin si dhe për të ruajtur rendin publik. Me këtë emër thirren të gjitha agjencitë e zbatimit të ligjit të cilat ushtrojnë “kompetenca policore”, veçanërisht kompetencat për të arrestuar dhe mbajtur nën arrest. (The civil force of a state, responsible for the prevention and detection of crime and the maintenance of public order; <https://en.oxforddictionaries.com/definition/police/22.10.2016>)
17. *Forcimi i integritetit policor në Shqipëri*, IDM, Tiranë 2015, f. 5.
18. Ronald K. Noble, in “The fight against corruption, Global Standards to Combat Corruption in Police Forces/ Services”. Publikuar në www.interpol.int/22.10.2016.
19. Sesioni i 68-të i Asamblesë së Përgjithshme të Interpolit është mbajtur në Seul, Koreja e Jugut nga 8 deri 12 nëntor 1999.
20. Për më tepër shih: IGEC definition of police corruption in Article 2 of its “Global Standards to Combat Corruption in Police Forces/Services” 2.2. Dhënia ose ofrimi, (i drejtpërdrejtë ose indirekt) nga personeli i policisë i parave, sendeve me vlerë, dhuratave, favoreve, premtimeve, shpërblimeve ose përfitimeve, për personelin e policisë apo për cilindo person, grup ose entitet, në këmbim të çdo veprimi apo mosveprimi (dështimi për të vepruar) të kryer ose premtuar për mosveprim ose mosveprim në të ardhmen gjatë kryerjes, ose që lidhet me kryerjen e çdo funksioni të kontrollit policor ose që lidhet me të; 2.3. Çdo veprim ose mosveprim (dështim për të vepruar) gjatë kryerjes së detyrës nga një polic i cili në mënyrë të padrejtë mund të paraqesë ngarkimin me faj ose dënimin për një kundërvajtje penale të një personi ose në mënyrë të padrejtë mund të kontribuojë që një person të mos ngarkohet me faj ose të shkarkohet nga një kundërvajtje penale; 2.4. Shpërblim dhe paaautorizuar e informacionit policor të besueshëm ose të klasifikuar qoftë për shpërbim apo arsye të tjera; 2.5. Çdo veprim ose mosveprim (dështim për të vepruar) gjatë kryerjes së detyrës nga një polic me qëllim marrjen e parave, sendit me vlerë, dhuratës, favorit, premtimit, shpërblimit ose përfitimit për veten e tij/saj ose çdo personi tjetër, grupi ose entiteti; 2.6. Çdo veprim ose mosveprim (dështim për të vepruar) i cili përbën akt korrupsionit sipas legjislacionit të vendit anëtar; 2.7. Pjesëmarrja si kryerës kryesor, bashkëkryerës, iniciues, nxitës, bashkëpunëtor, ndihmës përpara kryerjes së një vepre, ndihmës mbas kryerjes së një vepre, dhe komplotues në vepra të cituara në dispozitat

Shala, XH.
« Përballja dhe lufta kundër korrupsionit policor, forcon organizatën tonë policore »

Policimi dhe Siguria
nr.5, 2017

pararendëse të këtij neni.”

21. Kutnjak Ivkovic, S. *Fallen Blue Knights: Controlling Police Corruption*. New York: Oxford Press. Cituar në: *Forcimi i integritetit policor në Shqipëri*, IDM, Tiranë 2005, faqe 8.
22. Carl B. Klockars, Sanja Kutnjak Ivkoviæ, Maria R. Haberfeld. 'Enhancing Police Integrity'. Springer 2006. f.1. Cituar në: *Forcimi i integritetit policor në Shqipëri*, IDM, Tiranë 2005, f. 8.
23. Komisioni i njohur jo zyrtarisht si Komisioni Knapp, (mori emrin e kryetari të tij Whitman Knapp) ishte një panel prej pesë anëtarësh, i formuar fillimisht në prill të vitit 1970 nga kryetari i Bashkisë së Nju Jorkut, John V. Lindsay, për të hetuar korrupsionin brenda Departamentit të Policisë së qytetit të Nju Jorkut.
24. Rachel Neild, "USAID program brief: anticorruption and police integrity." USAID, 2007. Cituar në: *Police Integrity and Corruption in Albania*, The Institute for Democracy and Mediation, Tiranë 2014, f. 23.
25. *Police Integrity and Corruption in Albania*, The Institute for Democracy and Mediation, Tiranë 2014, f.24. [Sipas këtij klasifikimi korrupsioni i vogël përfshin: Marrja e ryshfeteve të vogla nga qytetarët e zakonshëm (në mënyrë të veçantë nga punonjës të policisë së trafikut); pranimi i dhuratave dhe shërbimeve falas; shitja e informacionit nga dosjet penale; "humbja" me qëllim e provave, dëshmime, etj.; vjedhja gjatë kontrolleve; marrja e mallrave të konfiskuara nga kontrabandës; dhënia e ndihmës të burgosurit për t'u arratisur; përdorimi i burimet policore për qëllime personale (përdorimi i automjeteve të policisë të shëtitur me familjen, dhënia në përdorim armëve të shërbimit të policisë kriminelëve, etj.).]
26. *Ibid*, f. 24. [Sipas këtij klasifikimi korrupsion zyrtar(burokratik) përfshin: Kontraktimi dhe blerjet e privileguara, etj.; vjedhja e aseteve dhe burimeve të policisë (nga pagat, sistemi i shpërblimeve, etj.); shitja informacionit nga dosjet penale; "humbja" me qëllim e provave, dëshmime; dhënia e licencave dhe lejeve në mënyrë të parregullt; prishja e disiplinës së brendshme të hetimeve; marrja apo kërkimi i ryshfeteve për rekrutimin, diplomimin, trajnimin, emërimin, etj.].
27. *Ibid*, f. 24. [Sipas këtij klasifikimi korrupsion kriminal përfshin: marrja e ryshfeteve apo përqindjeve nga kriminelë të njohur; zhvatja e pagesave në mënyrë të rregullt nga grupe kriminale, etj.; dhënia e mbështetjes për aktivitetet kriminale me pajisje, informata, mbulim të aktivitetit, etj.; pjesëmarrja e drejtpërdrejtë në krim apo veprimtari krimi të organizuar (trafikimi i drogës, grupe pengmarrësish, etj.); vjedhja e mallrave kontrabandë të konfiskuara; mbrojtja e aktiviteteve ekonomike të paligjshme].
28. *Ibid*, f.25. [Sipas këtij klasifikimi korrupsion politik përfshin: Manipulimi i hetimeve penale; Iniciimi i hetimeve të rreme; dhënia e informacionit konfidencial politikanëve; shkelja e lirisë së të shprehurës dhe të protestës (demonstratës publike, grevës dhe aktiviteteve të tjera opozitare); kryerja ose mbulimi i vrasjeve politike; shkelja e lirisë politike, e të drejtës së informimit dhe e aktivitetit të ligjshëm të partive politike; dhënia e informacionit grupeve të armatosura të paligjshme].
29. <https://al.usembassy.gov/wp-content/uploads/sites/140/2017/03/Shqipëria-2016.pdf>. Faqe 6/04.03.2017.
30. Pjesa nga fjala e Kryeministrit Edi Rama, në prezantimin e Planit i ri Kombëtar në Luftën Antikancanis. Mbjatur me 03.03.2017. <http://www.kryeministria.al/al/newsroom/lajme/plan-i-ri-kombetar-ne-luften-antikanabis-1488563753/04.03.2017>.
31. "Sigurizimi" si term i referohet klasifikimit të disa fenomeneve, personave ose entiteteve etj., si kërcënimet ekzistenciale që kërkojnë masa të jashtëzakonshme. Kur një çështje klasifikohet në kategorinë e çështjeve të sigurisë bëhet sigurizimi i saj. Një çështje sigurizohet kur kërkohet veprime urgjente për të trajtuar diçka si një kërcënim ekzistencial dhe për të mundësuar një thirrje për masa urgjente dhe të jashtëzakonshme për t'u marrë me këtë kërcënim". Ky koncept është futur nga Shkolla e Kopenhagës. Për më tepër, shih përfaqësuesit e kësaj shkolle Buzan, Waever, de Wilde, 1998: 23.
32. Louise Westmarland, "Police Ethics and Integrity: Breaking the Blue Code of Silence". *Policing and Society, An International Journal of Research and Policy*, 19 Aug 2006, f.145.
33. *Integriteti dhe Korrupsioni Policor në Shqipëri*. Botimi i Dytë, IDM, Tiranë, 2016, f. 9.
34. Po aty, f. 59.
35. Po aty, f. 62.
36. Kështu ata mund të bëjnë ujdi me një kriminel – duke premtuar dënim më të lehtë, ose edhe të bëjnë sikur nuk shohin që ka shkelje të ligjit – në këmbim për më shumë informacion i cili mund t'i ndihmojë në gjetjen, arrestimin ose dënimin e dikujt që dyshohet se ka kryer një krim më të rëndë. Në këtë rrethanë, punonjësit e policisë më dijeni anashkalojnë ose edhe thejnë ligjin bazuar në konceptin e etikës relative.
37. Për më tepër, shih sondazhin e publikuar nga IDM në vitin 2014: *Integriteti dhe Korrupsioni Policor në Shqipëri*, f. 88.
38. Leslie Holmes, *Corrupt and policing*, "Toolkiton Police Integrity", DCAF, Geneva 2012, p.25. Burim i cituar.
39. *Integriteti dhe Korrupsioni Policor në Shqipëri*. Botimi Dytë, IDM, Tiranë 2016, f.122.
40. Po aty, f. 50-51.
41. Anketimi i IDM është realizuar në kuadër të Projektit "*Indeksi i Integritetit të Policisë*" i cili u mbështet nga një grant i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Holandës në kuadër të Programit Matra për bashkëpunim Evropian.
42. *Integriteti dhe Korrupsioni Policor në Shqipëri*. Botimi Dytë, IDM, Tiranë 2016, f. 112.
43. Po aty, f. 61.

Shala, XH.
« Përballja dhe
lufta kundër
korrupsionit
policor, forcon
organizatën tonë
policore »

Policimi
dhe
Siguria
nr.5, 2017

44. *Forcimi i integritetit policor në Shqipëri*, IDM, Tiranë 2015, f. 25. Burim i cituar.
45. Pjesa nga fjala e Kryeministrit Edi Rama në prezantimin e Planit i ri Kombëtar në Luftën Antikanabis. Mbajtur me 03.03.2017.<http://www.kryeministria.al/al/newsroom/lajme/plan-i-ri-kombetar-ne-luften-antikanabis1488563753/04.03.2017>. Burim i cituar.
46. *Integriteti dhe Korrupsioni Policor në Shqipëri*. Botimi Dytë, IDM, Tiranë 2016, f. 134. Burim i cituar.
47. Vlerësimi i performancës së strukturave policore është i përcaktuar në Rregulloren e Policisë së Shtetit, në Pjesën e Dytë, Kreu X, nenet 96-104, miratuar me VKM Nr.750, datë 16.9.2015. Ky vlerësim bëhet sektori përkatës brenda Drejtorisë së Standardeve Profesionale në përputhje me Procedurën Standarde "Vlerësimi i performancës së strukturave të Policisë së Shtetit", miratuar me urdhër të Drejtorit të Policisë së Shtetit nr. 66, datë 19.01.2016.
48. Të dhënat janë të Drejtorisë së Standardeve Profesionale
49. *Toolkiton Police Integrity*, DCAF, Geneva 2012, f.193.
50. *Integriteti dhe Korrupsioni Policor në Shqipëri*, IDM, Tiranë 2016, f. 55. Burim i cituar.
51. Po aty, f. 134.
52. Po aty.
53. Të dhënat statistikore janë marrë nga Raporti Vjetor i SHÇBA-së për vitin 2015, publikuar në www.punetebrendshme.gov.al/04.03.2017.
54. *Raporti Vjetor i Punës i SHÇBA-së për vitin 2016*, f. 8. Publikuar në www.punetebrendshme.gov.al/04.03.2017.

Bibliografi

1. Leslie Holmes, *Corrupton and policing*, "Toolkiton Police Integrity", DCAF, Geneva 2012,
2. Arnold J. Heidenheimer, Michael Johnston, *Political Corruption: Concepts and Contexts*, New Jersey: 2002.
3. Ronald K. Noble, in "The fight against corruption, Global Standards to Combat Corruption in Police Forces/ Services". Publikuar në www.interpol.int/ 22.10.2016.
4. Kutnjak Ivkovic, S. *Fallen Blue Knights: Controlling Police Corruption*. New York: Oxford Press.
5. Carl B. Klockars, Sanja Kutnjak Ivkoviæ, Maria R. Haberfeld. "Enhancing Police Integrity". Springer 2006.
6. Rachel Neild, *USAID program brief: anticorruption and police integrity*. USAID, 2007.
7. Louise Westmarl "Police Ethicsand Integrity: Breaking the Blue Code of Silence", *Policing and Society, An International Journal of Research and Policy*, 19 Aug 2006,p.145.
8. Xhavit Shala, "Korrupsioni dhe veçoritë e hetimit të tij", ligjëratë e përgatitur për studentë të nivelit master shkencor në lëndën "E Drejtë Penale".
9. *Strategjia e Sigurisë Kombëtare e Republikës së Shqipërisë*, miratuar me Ligjin Nr. 103/2014.
10. *Police Integrity and Corruption in Albania*, The Institute for Democracy and Mediation, Tiranë 2014
11. *Forcimi i integritetit policor në Shqipëri*, Tiranë 2015: IDM.
12. IGEC definition of police corruption in Article 2 of its "Global Standards to Combat Corruption in Police Forces/Services".
13. Të dhëna të Drejtorisë së Standardeve Profesionale.
14. *Raporti Vjetor i SHÇBA-së për vitin 2015*, publikuar në www.punetebrendshme.gov.al.
15. *Raporti Vjetor i SHÇBA-së për vitin 2016*, publikuar www.punetebrendshme.gov.al.

Shala, XH.
 « Përballja dhe lufta kundër korrupsionit policor, forcon organizatën tonë policore »

Policimi
 dhe
 Siguria
nr.5, 2017

Siguria rrugore: sfida jonë e përbashkët



■ **MSc. Ardi VELIU**
Drejtor i Policisë Rrugore

Abstrakt

Aksidentet rrugore, qofshin këto me pasoja të rënda apo të lehta, janë duke u rritur nga njëri vit në tjetrin. Fenomeni nuk është i lokalizuar, por është ndërkombëtar, ku organizata me besueshmëri të lartë, e vendosin atë të tetin në renditje të faktorëve që shkaktojnë numër të lartë të vdekshmërisë. Ato sugjerojnë se trendi do të jetë rritës, nëse nuk merren masat e duhura, në kohën e duhur. Një situatë e tillë, vihet re nga statistikat përkatëse edhe në vendin tonë. Për reduktimin e problemit, është shumë e nevojshme gjetja e faktorëve shkakorë dhe hartimi i strategjive të duhura, në koordinim të veprimeve të shumë institucioneve për të marrë rezultatet e duhura. Pavarësisht nga kjo, kultura e një kombi për të pranuar dhe zbatuar me korrektësi ligjet dhe rregullat, si dhe ndëshkimi i shkelësve të ligjit, duket se është “çelësi i artë” i minimizimit të fenomenit, i cili merr edhe përmasa sociale.

Fjalëkyçe:

Policia, siguria rrugore, aksidente rrugore, ngjarjet rrugore, normat e sjelljes, përdoruesit e rrugës.

Veliu, A.
« Siguria
rrugore:
sfida jonë e
përbashkët »

Policimi
dhe
Siguria
nr.5, 2017

1. Hyrje

Termi i “sigurisë rrugore”, përfshin një kompleksitet bashkëveprimesh të aktorëve dhe përdoruesve të rrugës, duke nënkuptuar këtu rrugë të sigurta, mjete rrugore në parametra cilësisht të pranueshëm, të cilat nuk vënë në rrezik jetën e drejtuesit të mjetit dhe pasagjerëve të tij e po kështu, edhe të përdoruesve të tjerë të rrugës. Rrjedhimisht, siguria rrugore kërkon si parakusht themelor, drejtues mjeti, pasagjerë dhe përdorues rruge më të ndërgjegjshëm ndaj pasojave që mund të sjellë një ngjarje rrugore. Këta duhet të jenë më vigjilentë në përdorimin e saj, të jenë të informuar në kohë reale (nga përgjegjësit direkt) për rreziqet e mundshme të gjendjes së rrugës për shkaqe nga më të ndryshmet. Pikërisht në këtë kontekst, ku ndërthuren probleme të rrugëve, por edhe të edukatës së përgjithshme qytetare, të një tradite të munguar, rritja e numrit të aksidenteve nga viti në vit, duhet të përbëjë një shqetësim shumë të madh qytetar dhe institucional. Nëse nuk merren masat e duhura dhe lejohet vazhdimi i kësaj prirjeje, numri i vdekjeve nga aksidentet do të ketë tendencë rritjeje. Përqindjen më të lartë të aksidenteve me humbje jete e përbëjnë:

- së pari, shkelja e rregullave të qarkullimit nga drejtuesit e automjeteve dhe,
- së dyti, mos zbatimi i rregullave të qarkullimit nga këmbësorët.

Aksidentet në trafikun rrugor, përbëjnë një nga tetë shkaqet e vdekjeve në nivel global dhe shkak kryesor i vdekjes për të rinjtë e grupmoshës 18-29 vjeç¹. Drejtuesit

¹ Allianz SE, 2014: “Traffic accidents is number one worldwide cause of death among youths”, Munich, Oct 30, 2014. Gjetet në version elektronik në:
https://www.allianz.com/en/press/news/commitment/community/141029-allianz-on-road-safety.html/?search.query=safety%20R%20roads&search.filter=-_contentType:editorial

e rinj të mjeteve, mendoj, kanë norma të larta aksidentesh për shkak të përvojës, moshës dhe gjinisë.² Zvogëlimi i numrit të viktimave nga aksidentet e shkaktuara prej drejtuesve të rinj të automjeteve, do të kërkonte fokusim në një qasje të koordinuar të gjithë aktorëve, ku përfshihen: edukimi, trajnimi, licencimi, zbatimi, komunikimi dhe përdorimi selektiv i teknologjisë, në kombinim me masat e tjera të sigurisë rrugore si, rrugë të sigurta, mjete rrugore të sigurta, ndërgjegjësim dhe informim të përdoruesve të rrugës etj.

Duke vlerësuar rëndësinë e sigurisë rrugore, politikat duhet të përqendrohen në thyerjen e lidhjes së rrezikshme, të zhvilluar historikisht, në mes papjekurisë dhe mungesës së përvojës nga njëra anë dhe, nga ana tjetër, drejtimit të mjeteve në një mjedis sfidues, që është trafiku. Po kështu, komunikimi dhe edukimi duhet të kenë për qëllim të theksojnë rëndësinë që ka siguria rrugore, duke u bërë pjesë e kurrikulave shkollore.

2. Policia dhe siguria rrugore

Policia rrugore dhe siguria rrugore është shumë e vështirë të veçohen ose të shikohen si të palidhura me sigurinë e qytetarëve, sepse në një mënyrë ose në një tjetër, ato janë pazgjydhshëmrisht ose bashkudhëtare. Policia është ndër institucionet apo strukturat e sigurisë me mision mbikëqyrjen drejtimin e trafikut rrugor në rrugë për përdorim publik, në përputhje me legjislacionin rrugor. Detyrimi ligjor për përdoruesit e rrugës dhe të automjeteve, konsiston në detyrimin për të respektuar rregullat. Drejtuesit i kërkohet gjithashtu, që të respektojnë normat e sjelljes në rrugë, si përdorues i saj; rregulla, që nuk kanë një përcaktim të saktë në Kodin Rrugor, por që rrjedhin nga detyrimi i caktuar për çdo drejtues automjeti, që të respektojnë çdo situatë, me një sjellje të përshtatshme për të shmangur ngjarje të dëmshme duke i zbatuar këto norma të sjelljes, të sugjeruara edhe nga përvoja. Kjo gjen një përcaktim më të qartë në formulimin e nenit 138 të Kodit Rrugor, i cili parashikon se: “Përdoruesit e rrugës duhet të sillen në mënyrë të tillë që të mos përbëjnë rrezik ose pengesë për qarkullimin dhe në mënyrë të tillë që në çdo rast të ruhet siguria rrugore”³.

Rëndësia themelore e rregullit, konsiston në mundësinë e ngarkimit të drejtuesit të mjetit me një ngjarje të caktuar të dëmshme, edhe pse ai, nuk ka shkelur në të vërtetë rregullat e veçanta të sjelljes, të përfshira në Kodin Rrugor. Në thelb, neni 140 i cakton çdo drejtuesi automjeti, detyrimin për të përshtatur sjelljen e tij me kërkesat e sigurisë në trafik, duke shmangur, aq sa është e mundur, ndodhjen e ngjarjeve të dëmshme ndaj përdoruesve të rrugës. Mund të konstatohet se interesi i sigurisë, i mbrojtur nga neni 140, duhet të konsiderohet me prioritet ndaj interesave të veçanta, të mbrojtura nga rregulla të tjera të përcaktuara nga Kodi Rrugor, për të cilin, nën hipotezën që drejtuesi i automjetit, për të shmangur aksidentin me një këmbësor, duhet të bëjë një manovër të papritur dhe të kapërcjë - për shembull, kufirin e shpejtësisë, - nuk do të ishte fajtor për shkeljen e këtij rregulli.

2.1 Aspekte morale të sigurisë rrugore

Përcaktimi i detyrave morale, të lidhura me qarkullimin rrugor dhe sigurinë, është akoma edhe më i paqartë. Në fakt, morali është tërësia e rregullave të jetës që një njeri

Veliu, A.
« Siguria rrugore: sfida jonë e përbashkët »

Policimi dhe Siguria
nr.5, 2017

² Referuar edhe Statistikave të Drejtorisë së Policisë së Shtetit.

³ Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë, miratuar me Ligjin Nr. 8378 datë, 22.07.1998, i ndryshuar.

e ka të nevojshme, pavarësisht nga njohuritë që të tjerët mund të kenë për veprimet e tij dhe gjykimi që mund t'i japin. "Përpjekja më e rëndësishme njerëzore është orvatja për moralitet në veprimet tona. Baraspesha jonë e brendshme e madje, ekzistenca jonë, varet nga kjo. Vetëm morali në veprimet tona mund t'i japë dinjitet jetës."⁴ Këto rregulla mund të ndryshojnë në përputhje me parimet filozofike dhe fetare nga të cilat burojnë. Megjithatë, ekzistojnë disa rregulla bazë që mund të mbështeten nga të gjithë njerëzit në shoqëri. Kështu, është i pranueshëm nga të gjithë rregulli i pashkruar, si një normë e një shoqërie moderne, i detyrimit për të mos vrrarë apo rrezikuar ekzistencën dhe integritetin e tjetrit dhe, për të mos imponuar arrogancë mbi vullnetin e të dobët.

Kjo normë duket se kundërshtohet nga ngjarjet e fundit: hedhja e gurëve nga tejkalimet e shpejtësisë, garat e rrezikshme të automjeteve që lëvizin krah për krah në rrugë të hapura për trafikun publik, etj., janë shembuj tipik të prekjes së kësaj norme. Këto sjellje absurde, të cilat shqetësojnë ndërgjegjen, lidhen shpeshherë me krizën e identitetit të grupmoshave shoqërore, të cilat kanë probabilitet të lartë kundërshtimi të kësaj norme shoqërore, nëpërmjet veprimeve apo mosveprimeve të tyre. Këto raste, që për fat të mirë janë të rralla, besohet, se nuk zhvlerësojnë rregullat themelore, të cilat ndajnë turmën njerëzore nga shoqëria njerëzore. Megjithatë, jo vetëm drejtuesit e automjeteve janë të pakujdesshëm, por edhe përdoruesit e tjerë të rrugës, ku shpeshherë janë njerëz me integritet të lartë në jetën e tyre dhe, ndodh që "t'i harrojnë" këto norma të sjelljes rrugore. Një tjetër burim i kërkesës për përgjegjësi morale përfaqësohet nga "ndjenja sociale". Njeriu ka nevojë për shoqëri, ndihmë, bashkëpunim, komunikim me njerëzit e tjerë. Nga kjo, burojnë të drejta dhe detyra sociale si besnikëria, drejtësia, solidariteti, të cilat të përmbledhura, shprehin "ndjenjen sociale" që çdo ditë kërkojmë ta tregojmë në rrugë ndaj përdoruesve të tjerë.

Shkeljet dhe neglizhencat e përdoruesve të rrugës, shkaktojnë pasoja të ndryshme, shkatërrojnë pasurinë, shkaktojnë lot, familje të ndara dhe të shkatërruara, paaftësi që lënë shenjë për gjithë jetën. "Mëkati i rrugës" është një problem shoqëror. Përgjegjësia morale, lind jo vetëm atëherë kur vepra e ngjarjes së makinës shkakton një aksident automobilistik. Në fakt, pasaktësia, mania për t'u dukur, ekzaltimi i instinktit të pushtetit, ngjarja e makinës në gjëndje të dehur apo, më keq, nën ndikimin e drogës, mund të të shpëtojnë nga policia, por jo nga përdoruesit e tjerë tek të cilët shkaktojnë reagim apo imitim. Në këtë kuptim "mëkati shoqëror" ka një ndikim negativ arsimor dhe aspektin anti-social që bie ndesh me vlerat sociale dhe arsimore të nxitura nga një lëvizje e lirë, e rregullt dhe bashkëpunuese.

2.2 Aksidentet rrugore si fenomene kriminale

Krimi është një nocion në kriminologji, i cili nuk shpreh një kriminalitet apo vepër penale të veçantë. Ai përfaqëson tërësinë e kriminalitetit që ndodh në një hapësirë dhe kohë të caktuar, në një mjedis të caktuar⁵. Ky nocion, i pranuar gjerësisht nga shoqëria, nënkupton vetëm krimet e vrasjes, kur në fakt ai ka kuptim shumë më të gjerë dhe në të përfshihen të gjitha format e kriminalitetit që mund të ndodhin në një strukturë

⁴ Ching-Hung Woo. "Einstein's Morality". *Philosophy Now*, Apr/May 2017, Issue 119.


Ching-Hung Woo, Professor Emeritus i fizikës në Universitetin e Maryland. Materiali gjendet elektronikisht në: https://philosophynow.org/issues/109/Einsteins_Morality

⁵ Shabani, Alisabri dhe Muhamed Budimliq. *Kriminologjia*, Mustafë Reçica (përk.). Sarajevë/Prishtinë, 2007: Universiteti u Sarajevu.

Gjendet elektronikisht në: <http://aab-edu.net/uploads/docs/librat/Kriminologjia%20-%20Alisabri%20%C5%A0ABANI%20&%20Muhamed%20BUDIMLI%20C3%86.pdf>

shoqërore. Krimi, jo vetëm kohët e fundit, por edhe më parë ka qenë një dukuri e zakonshme. Në strukturën e këtij kriminaliteti, përfshihen një sërë veprash penale si: vrasjet, plagosjet e lehta apo të rënda, dhunime verbale, fizike, psikologjike e seksuale, vjedhje, grabitje, kanosje, marrëdhënie seksuale, ngjarje rrugore (aksidentet me pasoja fatale ose të rënda). Sipas statistikave që rezultojnë nga ngjarjet e evidentuara në periudhën 2005 deri në 2015, në vendin tonë janë evidentuar 1265 vrasje, 2438 vetëvrasje dhe 3341 aksidente rrugore me pasoja fatale (Grafiku nr. 1).⁶

Grafiku nr. 1: Ecuria e ngjarjeve gjatë harkut kohor 2005-2015 në vendin tonë



Burimi: Qendra Kërkimore Shkencore e Akademisë së Sigurisë, Korrik 2016

Krimi i vrasjes është më i ndjeshëm për opinionin, pasi paraqet rrezikshmërinë më të lartë shoqërore. Pavarësisht dukurive dhe veçorive të vrasjeve në tërësi si: egërsia e ashpërsia e mekanizmit kriminal ku mund të përfshihen motivet, format, metodat dhe mjetet e kryerjes së krimit, ajo ngelet një plagë e rëndë për shoqërinë. Por, nëse marrim në analizë numrin e vrasjeve të evidentuar në dhjetëvjeçarin e fundit (1265), krahasuar me ngjarjet rrugore (aksidentet me pasoja fatale) 3488, shohim se vrasjet përbëjnë 36.2% të aksidenteve me pasoja fatale, ashtu si duket edhe në grafikun nr. 1. Shifra është për t'u marrë në konsideratë dhe duhet të shqetësojë gjithë shoqërinë, pasi pasojat që rrjedhin nga aksidentet rrugore, statistikisht janë tre herë më të mëdha se sa krimi i vrasjes.

Në të gjithë analizat, konferencat, “workshop”-et apo kumtesat, të cilat zhvillohen sot në mjedisin e shoqërisë shqiptare, mbizotëron ndjeshmëria për të diskutuar mbi krimin e vrasjes, por se cilat janë pasojat që ndien shoqëria jonë nga aksidentet rrugore, ngelet në plan të dytë ose në hije. Bie sy dukshëm, nga statistikave që kemi prej vitit 2005 deri në 2015, se vetëm jetë të humbura janë 3488, por nëse do të analizonim pasojat që ka shoqëria jonë mbi dëmin ekonomik që shkaktohet për të lënduarit, vihet re se janë 19.360 raste (plagosjet e rënda apo të lehta); pa llogaritur këtu dëmet materiale të shkaktuara nga karambolet. Nëse i referohemi aspektit material të dëmtimit nga ngjarjet rrugore, për një person të vetëm i cili ka paaftësi të përkohshme kostoja e dëmit shëndetësor shkon në 229.350 lekë.⁷

Veliu, A.
« Siguria rrugore: sfida jonë e përbashkët »

Policimi dhe Siguria
nr.5, 2017

⁶ Bilbil Memaj, Xhavit Shala, Anisa Agastra: Studimi “Vetëvrasja në Shqipëri, prognozë analitike e psikosociale dhe rekomandimet për hartimin e politikave. Fokusi në vitet 2005-2015”. Tiranë: Akademia e Sigurisë, Qendra Kërkimore Shkencore, 2016 (në qarkullim të brendshëm)

⁷ Neni 19 i Rregullores nr. 53 datë 25.06.2009 të nxjerrë nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare në zbatim të ligjit nr. 10076 datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”.

Po kështu:

- për dëme shëndetësore me pasojë paaftësinë e përhershme, kostoja është 1.281.576 lekë;⁸

- për dëme materiale, kostoja është 102.665 lekë;⁹

- për dëme me pasojë humbjen e jetës, kostoja është 2.740.157 lekë.¹⁰


Pavarësisht faktorëve të cilët shkaktojnë një ngjarje rrugore, qoftë kjo me pasoja fatale ose jo, si: shpejtësia, përdorimi i pijes alkoolike, parakalim i gabuar, përdorimi i celularit, manovër e gabuar, gjendja teknike e automjetit, rruga apo mosrespektimi i normave të sjelljes nga këmbësori, ne si shoqëri, duhet të jemi më të ndjeshëm për të kontribuar për minimizimin e këtyre pasojave. Rrjedhimisht edhe shoqëria vetë do të përfitojë nga një sjellje e tillë.

3. Parandalimi dhe reduktimi i shkeljeve në qarkullimin rrugor

3.1 Situata e ngjarjeve rrugore në Shqipëri

Mosrespektimi vullnetar dhe i vetëdijshëm ndaj detyrave është faj moral, pavarësisht nga pasojat që krijon, madje edhe në mungesë të aksidentit apo dëmit të shkakuar ndaj vetes së tyre apo edhe ndaj të tjerëve. Një sjellje e tillë mund të mos vihet re nga të tjerët, por sigurisht nuk mund t'i shpëtojë gjykimit të ndërgjegjes së drejtuesit të automjetit. Shkelja e rregullave dhe pakujdesia nga përdoruesit e rrugës, shkakton vdekjen e njerëzve dhe dëmtime fiziko-psikologjike të rënda të tyre, duke implikuar një drejtim, – cilësisht, - ndoshta më të keq të jetës së tyre. Për të krijuar një ide në lidhje me këtë drejtim të fenomenit, grafiku nr. 2 ofron përqindje të situatës të së plagosurve (qofshin këta, me pasoja të rënda apo të lehta) në raport me numrin e aksidenteve të ndodhura në vitin përkatës, - llogaritur ky variabël, për aksidentet e ndodhur në Republikën e Shqipërisë, në një periudhë kohore, nga viti 2005 deri në vitin 2015.

Grafiku nr. 2: Raporti i të plagosurve në aksidentet e ndodhura në harkun kohor 2005-2015.



Burimi: Drejtoria e Policisë së Shtetit, 2015

⁸ Nenet 16-18 dhe 28-31, të Rregullores nr. 53 datë 25.06.2009 të nxjerrë nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare në zbatim të ligjit nr. 10076 datë 12.02.2009 "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit".

⁹ Nenet 21-27, të Rregullores nr. 53 datë 25.06.2009 të nxjerrë nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare në zbatim të ligjit nr. 10076 datë 12.02.2009 "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit".

¹⁰ Nenet 12-15 dhe 28-31, të Rregullores nr. 53 datë 25.06.2009 të nxjerrë nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare në zbatim të ligjit nr. 10076 datë 12.02.2009 "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit".

Veliu, A.
« Siguria rrugore: sfida jonë e përbashkët »

Policimi dhe Siguria
nr.5, 2017

Analiza e grafikut pasqyron qartë se ky është një problem social shumë i rëndë, me kosto ekonomike të larta, duke marrë parasysh edhe efektet, sëmundjet e rënda për t'u luftuar, për të cilat investohen shuma të konsiderueshme edhe në kërkime shkencore. Pavarësisht ndryshimit në diferenca, prej vitit 2005 deri në vitin 2015, viti 2009 është viti me rezultatin më të ulët të këtij variabëli (me vetëm 8.1 % të aksidenteve të ndodhur në vitin 2009) dhe viti 2014, viti me rezultatin më të lartë (me 10.0% të plagosurve, në raport me aksidentet e tjera). Nëse shohim ndryshimin ndërmjet këtyre dy viteve referues, norma e ndryshimit nuk është e konsiderueshme me vetëm 23.4%, duke reflektuar për një prezencë konstante kohore të problemit. Megjithatë, duhet theksuar se përgjegjësia në këto raste nuk është vetëm e drejtuesit të automjetit, por edhe e përdoruesve të tjerë të rrugës.

Në këtë aspekt, ka shumë për të folur, pasi janë një sërë fenomenesh të cilët kanë qenë mjaft dinamike, duke iu referuar një periudhe kohore nga postkomunizmi e deri tani. Ndryshimet e infrastrukturës rrugore, influencat në stilin e jetesës me hapjen ndaj botës jashtë (përdorimi në masë i makinave dhe motorëve të ndryshëm), - duke mos u shoqëruar kjo me nivelet e duhura të kulturës rrugore të aplikuara gjerësisht nga përdoruesit rrugorë shqiptarë jashtë vendit dhe jo aq shumë brenda vendit, - mungesa shumë e dukshme e kulturës nga ana e këmbësorëve, rritin probabilitetin e ndodhjeve të ngjarjeve rrugore, përsëri edhe aktualisht. Shoqëria shqiptare duhet të jetë më e ndjeshme dhe edukimi i saj shikohet si çelësi kyç për minimizimin e ngjarjeve rrugore. Aksidentet rrugore dhe pasojat e tyre janë një problem jo vetëm për shoqërinë shqiptare, por për mbarë njerëzimin. Aktualisht, vlerësohet se sot, 1/3 e vdekjeve nga aksidentet rrugore janë të rinj të grupmoshës 15-29 vjeç¹¹. Kjo gjë nënkupton se humbasin më shumë se 400.000 jetë, në një periudhë relativisht njëvjeçare dhe që, kjo shifër e tejkalon madje numrin e vdekjeve të shkaktuara nga sëmundjet, përdorimi i drogës, vetëvrasjet dhe pasojat e luftërave. Referuar AZT-së¹², vdekjet e të rinjve nga aksidentet rrugore, variojnë në një shifër prej 31.5% për vendet me të ardhura të ulëta, në 32.0% për vendet me të ardhura të mesme dhe 28.5% për vendet me të ardhura të larta. Shifrat (afërsisht të ngjashme) nënkuptojnë se “variabëli, e ardhur ekonomike”, nuk është një faktor vendimtar në ekzistencën e këtij problemi, më shumë sesa ç’është kultura e kombit në lidhje me këtë çështje; gjithashtu, e rëndësishme është edhe mënyra sesi vendet përgatitin brezin e ri për të pranuar normat shoqërore dhe minimizuar sjelljet negative sociale, të cilat ndikojnë ndjeshëm apo janë shpeshherë shkaktare të aksidenteve rrugore.

Sipas “Raportit të Statusit Global”, publikuar nga organizata WHO¹³, 2015 aksidentet rrugore renditen të tetat në listën e faktorëve të cilët shkaktajnë vdekjet. Studimi tregon se nëse nuk merren masa të përshtatshme nga ana e qeverive të ndryshme, deri në vitin 2030, trendi i këtij problemi do ta rendis këtë shkaktar në vendin e pestë. Minimizimi i tyre përcakton strategji të njohura tashmë, por mënyra sesi reagojnë ndaj këtyre masave të ndërmarra, janë të lidhura ngushtësisht me kulturën e shoqërisë përkatëse. Efektet e strategjive të ndërmarra, do të shtrihen gjatë në kohë nëse shoqëria nuk i

¹¹ Allianz SE, 2014: “Traffic accidents is number one worldwide cause of death among youths”, Munich, Oct 30, 2014. Gjetet në version elektronik në:

https://www.allianz.com/en/press/news/commitment/community/141029-allianz-on-road-safety.html/?search.query=safety%20R%20roads&search.filter=-_contentType:editorial

¹² Po aty.

¹³ Organizata WHO (World Health Organization) raporti Global Status Report on Roads Safety, website: http://www.who.int/violence_injury_prevention/road_safety_status/2015/en/

pranon lehtësisht masat, – duke qenë skeptike për to dhe shpeshherë duke i paragjykuar, nëse ato janë ndërmarrë për herë të parë, apo vet shoqëria “vuan” nga probleme sociale të lidhura me celulën bazë të saj që është familja. Nëse fokusohemi në Europë, vëmë re se Gjermania ka një normë vdekje nga aksidentet rrugore prej 4.7 ndër 100.000 banorë, duke e renditur të pestën ndërmjet 28 vendeve të EU-së dhe Suedia ka normën më të ulët me 3.0 ndër 100.000 banorë. Greqia ka normën më të lartë me 12.2 të vdekjeve nga aksidentet rrugore, ndërsa Shqipëria e ka 9.2¹⁴. Duke iu referuar këtyre shifrave, mendimi i sipërpërmendur përforcohet dhe madje tregon dukshëm që krijimi i një filozofie të duhur në lidhje me normat rrugore, duke u bërë ndjeshëm pjesë e kulturës kombëtare, është një kusht i nevojshëm dhe i domosdoshëm për uljen e aksidenteve rrugore.

Ndër masat kryesore, të zbatuara dhe nga vende të ndryshme, duket qartë një koordinim i shumë agjentëve si:


- rregullim në industrinë e makinave/motorëve,
- forcimi i kriterëve dhe ashpërsimi i marrjes së lejeve të drejtimit,
- kryerja e ndryshime të nevojshme në kodin rrugor,
- përmirësimi i infrastrukturës rrugore,
- edukimi i përdoruesve të rrugës,
- nisma të njëpasnjëshme fushatash sensibilizuese (masmedia, “workshop”-e dhe fletëpalosje)

Performanca e strategjive, varet shumë nga sinergia e institucioneve përkatëse që marrin pjesë në të, si dhe nga reagimi i komunitetit ndaj këtyre veprimeve.

3.2. Mosrespektimi i normave të sjelljes

Kur shkelen normat e sjelljes dhe kjo zbulohet nga punonjësit e policisë, drejtuesi i automjetit duhet t’i nënshtrohet ndëshkime (dënimeve). Megjithatë, shkelja e ligjeve ose rregulloreve (që përbën faj) duhet të jetë vullnetar (pra të paraqesë një sjellje të qëllimshme) ose ndryshe, përcaktohet si neglizhencë, pakujdesi, apo mungesë përvojë.

Grafiku nr. 3: Ecuria e llojit të aksidenteve në harkut kohor 2005-2015¹⁵



Burimi: Drejtoria e Policisë së Shtetit, 2015

Në vlerësim të analizës së ngjarjeve rrugore të evidentuara nga vitet 2005 deri në

¹⁴ Statistikat e Policisë së Shtetit, 2015.

¹⁵ E dhëna “1” i referohet vitit 2005 dhe në rend rritës, e dhëna “11” i referohet vitit 2015.


Veliu, A.
« Siguria rrugore: sfida jonë e përbashkët »

Policimi dhe Siguria
nr.5, 2017

2015, për mekanizmin ose dinamikën e ndodhjes së tyre, ku mund të përfshijmë “automjet me automjet”, “automjet me këmbësor” dhe “automjet me çiklist”, si ngjarjet me fluksin më të shpeshtë të ndodhjes, shohim se në vendin e parë renditen ato të tipit “automjet me këmbësor”. Duke iu referuar grafikut nr. 3, viti 2007 rezultoi viti me ngjarjet e ndodhura me të ulëta, me 230 raste dhe viti me frekuencën më të madhe është viti 2015, me 671 raste. Po kështu, për ngjarjet rrugore të tipit “automjet me automjet”, rezultoi se viti me frekuencë më të ulët është viti 2005, me 140 raste dhe ai me frekuencën më të lartë, është viti 2015, me 456 raste. Në rrugë, shpeshherë ndeshen edhe raste ku në ngjarje rrugore kemi të përfshirë “automjet me çiklist” dhe, nëse i referohemi treguesve dhe grafikut, frekuenca e ndodhjes më e ulët, ka qenë viti 2005, me 82 raste dhe më e larta, ajo e vitit 2015, me 124 raste.

Nëse përqendrohemi tek faktorët që shkaktajnë aksidente, në vendin e ngjarjes, do të shohim se numrin më të lartë, gjatë periudhës kohore 10-vjeçare 2005-2015, e ka viti 2005, i cili rendit të parin variabëlën “defekte në mjet”; në vitin 2009 variabëli “rrugë me problematikat e veta infrastrukturore” dhe në 2011 variabëli “drejtues mjeti” (grafiku nr. 4). Këto rezultate e kanë një rrjedhë logjike të tyre dhe theksojnë se ku duhet të përqendrohen veprimet përkatëse. Nga viti 2005 e këtej, vendi ynë, për vetë zhvillimin e tij ekonomiko-social, do t’i reflektonte këto ndryshime edhe në këtë fenomen. Gjetja e makinave me kosto të ulët dhe përdorimi jo shumë i madh i tyre nga popullatë, në atë kohë, do të evidentonte variabëlën “defekte mjeti” si kryesorin, shoqëruar më pas nga ai i “infrastrukturës rrugore”, variabël i cili është dhe derivat i zhvillimit ekonomik të vendit. Por, vitet e fundit evidentohet kultura e dobët e drejtuesve të mjetit, të cilët në mënyrë të vullnetshme apo jo, nuk zbatojnë rregullat apo normat e sjelljeve rrugore duke shkaktuar shpeshherë marrje jete dhe dëme të shumta materiale, shoqëruar me kosto të larta financiare.

Grafiku nr 4: Faktorët e aksidenteve në harkut kohor 2005-2015



Burimi: Drejtoria e Policisë së Shtetit, 2015

Veliu, A.
« Siguria
rrugore:
sfida jonë e
përbashkët »

Policimi
dhe
Siguria
nr.5, 2017

Rrjedhimisht, nëse bëjmë një përmbledhje të situatës, në tërësi, shohim qartë prirjen në rritje të ndodhjes së ngjarjeve rrugore nga njëri vit në tjetrin dhe, domosdoshmërinë e marrjeve të masave përkatëse, për edukimin e drejtuesve të mjetit e shfrytëzimit të

rrugës në mënyrën e duhur, pa rrezikuar në asnjë rast përdoruesit e saj.

4. Përfundime dhe rekomandime

Fenomeni i aksidenteve rrugore ka përmasa ndërkombëtare dhe kërkon vëmendje të madhe, pasi referuar statistikave të fundit të raporteve nga organizata prestigjioze, ai ka një trend rritës. Reduktimi i tij është i lidhur ngushtësisht me kulturën kombëtare në lidhje me normat shoqërore të së jetuarit në komunitet, pa cenuar integritetin dhe jetën e gjithsecilit. Ekzistenca e vlera antisociale, “të përçafuara” shpeshherë nga grupmosha të reja për shkak të problemeve socioekonomike, çon në domosdoshmërinë e marrjes së masave nga ana e institucioneve përkatëse, për parandalimin e aksidenteve rrugore.

Me parandalim, në përgjithësi kuptohet një veprim i drejtpërdrejtë për të parandaluar ndodhjen e ngjarjeve të padëshiruara apo të dëmshme. Me “parandalim rrugor”, kuptohet studimi dhe zbatimi i masave për përdoruesit e rrugës në tërësi dhe i mjedisit që mundëson njohjen, parashikimi dhe shmangia e rreziqeve, pengesave, sjelljeve të papërshtatshme, mosfunksionimit të trafikut dhe aksidenteve. Kuptohet gjithashtu, njohja dhe vënia në zbatim e teknikave të përshtatshme për të ulur pasojat e aksidenteve rrugore, në rast se ato ndodhin. Në parandalime, përfshihen përdoruesit e rrugës (drejtuesit e automjeteve, këmbësorët dhe pasagjerët), organizatat shoqërore, administrative, (ligjvënësit, edukatorët, organet e policisë, mjekët, personeli i autoshkollave, ekzaminierët, etj.) pronarët e rrugëve me projektuesit e tyre dhe ndërtuesit e automjeteve.

Për këtë, vendosja në kurrikulat shkollore, e programeve për sigurinë rrugore, do të ndikonte pozitivisht në uljen e numrit të ngjarjeve rrugore, pasi njohuritë e përfituara për sigurinë rrugore do t'i shoqëronin përdoruesit e rrugës që nga bankat e shkollës deri në autoshkollat për marrjen e lejes së drejtimit si dhe gjatë përdorimit të rrugës. Do të ishte shumë efikase që gjatë përthithjes së informacionit për sigurinë rrugore, të përdoreshin metodat e duhura edhe me shembuj ilustrues, duke nxitur në këtë mënyrë bashkëveprimin ndërmjet nxënësve dhe ngulitjen e këtyre njohurive sa më gjatë në kohë. Pajisja e akteve rrugore me sinjalistikën e nevojshme, horizontale dhe vertikale, bashkëngjitur edhe elementët e tjerë si, përvijuesit e rrugës, barrierat trafikndarëse, ndriçimin e duhur, tabelat orientuese etj., do të ndikonte në rritjen e cilësisë rrugore.

REFERENCA

1. Allianz, SE, “Traffic accidents is number one worldwide cause of death among youth”, 2014 Munich, Germany.
2. Carvajal, K. (2015) “How can we make our roads safer?”, WEF.
3. Ligji nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”.
4. Ligji Nr. 8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.
5. Ligji nr. 10076 datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, Republika e Shqipërisë.
6. VKM. nr. 153, datë 07.04.2000 “Rregullore për zbatimin e Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.
7. Rregullore nr. 53 datë 25.06.2009 të nxjerrë nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare në zbatim të ligjit nr. 10076 datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, Republika e Shqipërisë.
8. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 125, datë 23.02.2011 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Sigurinë Rrugore dhe Planit të Veprimit 2011-2020” si dhe Vendimin e Komitetit Ndërmirësimor të Sigurisë Rrugore nr. 1 datë 20.03.2014 “Për miratimin e paketës së masave për përmirësimin e Sigurisë Rrugore”
9. Ingraham, C. (2015) “How inequality affects roads safety”, WEF.
10. Rios, M. (2015) “How South Korea has dramatically reduced roads deaths?”, WEF.
11. Statistikat vjetore nga viti 2005 -2015, Drejtoria e Policisë së Shtetit.

Veliu, A.
« Siguria rrugore: sfida jonë e përbashkët »

Policimi dhe Siguria
nr.5, 2017

Ndihma shtetërore në BE dhe ndikimi, në ekonominë dhe sigurinë e përbashkët



■ **Msc Argjenda PRIFTI**
Drejtorja e Policisë së Shtetit

Abstrakt

Legjislacioni i Bashkimit Evropian në fushën e konkurrencës trajton dy çështje: legjislacionin antitrust dhe politikat e ndihmës shtetërore. Ai përfshin rregulla që parandalojnë dhe ndëshkojnë sjelljet që dëmtojnë konkurrencën e lirë si: abuzimi i pozitës dominuese, marrëveshjet për ndarje tregu apo vendosje çmimesh etj. Këto janë rregulla që përcaktojnë kushtet në të cilat mund të bëhet bashkimi i dy ose më shumë ndërmarrjeve dhe, rregulla mbi kushtet ku në të cilat shtetet anëtare mund t'u ofrojnë ndërmarrjeve të tyre ndihmë shtetërore, pa dëmtuar konkurrencën në tregun e brendshëm. Ndihma shtetërore rregullohet nga Komisioni Europian, Drejtorja e Përgjithshme e Konkurrencës. Vendet anëtare duhet t'i raportojnë të gjitha masat e ndërmarrja Komisionit dhe këto masa, mund të implementohen vetëm pas aprovimit të Bashkimit Evropian. Departamenti i ndihmës humanitare dhe mbrojtjes civile i Komisionit Evropian (ECHO) u themelua në 1992. Aktivitetet humanitare tani përbëjnë pozitën kryesore të aktiviteteve të jashtme të Bashkimit Evropian, vërtetë BE-ja është lojtar kryesor botëror në këtë fushë. Rreth 150 milionë njerëz marrin ndihmë çdo vit me anë të ndihmave humanitare të BE-së. Kjo ndihmë ndahet përmes 200 partnerëve, siç janë organizatat bamirëse dhe agjencitë e Kombeve të Bashkuara. Ndihmat bazohet në parimet humanitare të mosdiskriminimit dhe paanësisë.

Prifti, A.
« Ndihma shtetërore në BE dhe ndikimi, në ekonominë dhe sigurinë e përbashkët »

Fjalëkyçe:

Ndihmë shtetërore, Komisioni Europian, konkurrencë, transparencë dhe paanësi.

1. Hyrje

Politika industriale është një mjet i rëndësishëm i krijimit të politikave ekonomike, veçanërisht që nga fillimi i krizës globale financiare, në vitin 2008. Në këtë punim, është studiuar efekti i politikës së ndihmës shtetërore në rritjen ekonomike dhe të investimit, duke përdorur një sërë të dhënash, panel i cili mbulon 27 vendet e Bashkimit Evropian për periudhën 1992-2011 (gjatë kësaj periudhe Kroacia nuk ishte vend anëtar i BE-së). Rezultatet sugjerojnë se ndihma shtetërore nuk është një mjet efektiv për të arritur normat e larta të rritjes ekonomike dhe të investimeve. Sipas metodologjisë së BE-së, ndihma shtetërore horizontale jepet për një numër të madh përfituesish, pa dhënë preferenca për ndonjë aktivitet ekonomik, ndërmarrje ekonomike, produkt apo shërbim, duke minimizuar efektet në konkurrencë. Ndhima shtetërore sektoriale jepet për aktivitete dhe sektorë të veçantë, duke pasur një ndikim më të madh në konkurrencën në treg. Kohët e fundit, janë rritur shqetësimet në lidhje me konkurrencën ndërkombëtare të vendeve të Evropës, së bashku me deindustrializimin e tyre, gjë që ka stimuluar një debat të ri rreth politikës industriale. Kjo, është veçanërisht e vërtetë në kontekstin e krizës ekonomike dhe financiare globale. Gjatë krizës, Bashkimi Evropian ka përcaktuar një strategji të re të integritit të politikës industriale e cila thekson rëndësinë e sektorit të fortë dhe të larmishëm, të prodhimit për konkurrencën dhe potencialin e krijimit të Bashkimit Evropian. Ka ardhur në rritje rëndësia e politikave industriale, si një mjet i hartimit të politikave ekonomike në vendet e Bashkimit Evropian, e për më tepër, është e komplikuar nga fakti se politika e konkurrencës së BE-së, në të njëjtën kohë, imponon kufizime të rrepta në aftësinë e shteteve anëtare, për të ndjekur objektivat

Prifti, A.
« Ndhima shtetërore në BE dhe ndikimi, në ekonominë dhe sigurinë e përbashkët »

Policimi dhe Siguria
nr.5, 2017

e tyre të politikave industriale. Prandaj, politika industriale dhe efektet e saj janë një çështje me rëndësi të madhe, veçanërisht në kontekstin e integritimit evropian. Megjithatë, numri i studimeve që shqyrton efektivitetin e politikave industriale në vendet e Bashkimit Evropian është i ulët. Në këtë punim, do të përpiqemi për të mbushur këtë boshllëk në literaturë, duke studiuar efektet e politikës së ndihmës shtetërore në rritjen ekonomike dhe investimet në vendet e Bashkimit Evropian. Ne do të përdorim të dhënat më gjithëpërfshirëse të vendosura në dispozicion në ndihmën shtetërore dhe i marrim në konsideratë të gjitha vendet e Bashkimit Evropian.

2. Reforma e politikës së ndihmave shtetërore në BE

Ndihma shtetërore është përcaktuar nga Bashkimi Evropian si: “avantazh i çdo forme, dhënë sipërmarrjeve mbi baza selektive nga autoritetet kombëtare publike dhe Komisioni Evropian. Nga nenet 107-109 i TFBE-së, rregullohet aplikimi dhe kontrolli i politikës së ndihmës shtetërore në shtetet anëtare të Bashkimit Evropian. Gjithashtu, neni 107§1, në linja të përgjithshme, ndalon çdo formë ndihme shtetërore, e cila prish ose rrezikon të prishë konkurrencën, neni 107§2 dhe 107§3, përcakton përjashtimet nga ky ndalim.¹

Përkatësisht, përjashtimet e ndihmës shtetërore vijnë në: ndihmat me karakter social, kompensimin e dëmit të shkaktuar nga katastrofat natyrore, promovimin e zhvillimit ekonomik në zona ku standardi i jetesës është tejet i ulët, promovimin e projekteve me interes të përbashkët në nivel Bashkimi Evropian që kuron problemet shqetësuese të ekonomisë evropiane, lehtësimin e zhvillimit të aktiviteteve të përcaktuara në fushën ekonomike që promovojnë kulturën dhe mbrojtjen e trashëgimisë. Kësajsoj, qeveritë mund tu ofrojnë ndihmë industrive dhe firmave specifike, atëherë kur qëllimi i shpenzimeve përputhet me kufijtë e vendosur nga legjislacioni i bashkimit.

Ndihma shtetërore rregullohet nga Komisioni Evropian, Drejtoria e Përgjithshme e Konkurrencës. Vende anëtare duhet t'i raportojnë të gjitha masat e ndërmarra Komisionit dhe këto masa mund të implementohen vetëm pas aprovimit në nivel të Bashkimit Evropian. Gjithashtu, ndihma shtetërore, ka qenë efektivisht e kontrolluar nga Bashkimi Evropian gjatë viteve të fundit dhe ngritja e këtij modeli kontrollimi nga BE, mori kohë të gjatë dhe ka disa arsye për vonesat. Së pari, kontrolli i ndihmës shtetërore është politikisht sensitiv. Së dyti, nenet e traktatit që rregullojnë këtë sektor janë kompleksë dhe nuk vendosin rregulla në nivel kombëtar. Së treti, vendet anëtare nuk ishin të etshëm të bashkëpunojnë me Komisionin, me qëllim që të realizonin nenet e traktatit dhe të vepronin me përputhje me detyrimet e vendosura. Gjithsesi, në raport me planin e veprimt të ndihmës shtetërore (State Aid Action Plan) që ka si qëllim pakësim dhe targetim më të mirë të ndihmës shtetërore, rregullat e kësaj politike janë bërë më transparente dhe më të lehta për t'u implementuar. Kësajsoj, në pamje të parë, politika e ndihmës shtetërore të vendeve anëtare, ndodhet në një pozicion shumë më të mirë sesa vite më parë. Në Bashkimin Evropian, shpenzimet e ndihmës shtetërore ndahen në dy kategori kryesore: shpenzime horizontale dhe shpenzime sektoriale. Shpenzimet horizontale mbulojnë ndihmat e zhvillimit rajonal, ndihma ambientale, (duke përfshirë dhe kursimin e energjisë) ndihma në fushën e kërkim zhvillimit dhe inovacionit, ndihma

Prifti, A.
« Ndhima shtetërore në BE dhe ndikimi, në ekonominë dhe sigurinë e përbashkët »

Policimi dhe Siguria
nr.5, 2017

¹ Traktati për Funkcionimin e Bashkimit Evropian, nenet 107-109, publikuar nga Ministria e Integritimit Evropian, faqet 91-92.

Gjendet në: <http://www.integrimi.gov.al/dokumente>

për sipërmarrje të vogla dhe të mesme, (përfshirë dhe riskun e kapitalit). Shpenzimet sektoriale janë të përbëra nga ndihma shpëtimi dhe ristrukturimi dhe ndihma për transportin, peshkimin, agrikulturën, akuakulturën, qymyrin dhe çelikun, dhe ndërtimin e mjeteve të transportit detar. Statistikat tregojnë se evoluimi total i ndihmës shtetërore, duke përfshirë edhe nënkomponentët, për Bashkimin Europian gjatë dekadës të fundit dhe, shpenzimet totale të ndihmës shtetërore, kanë pësuar rënie nga 1.10% në 0.51%. Gjithashtu, ndihma shtetërore në industri dhe shërbime dhe ndihma shtetërore sektoriale kanë pësuar të njëjtin trend si politika e ndihmës shtetërore, duke përfshirë këtu nismën shtetërore që i përket shpenzimeve horizontale. Shpenzimet horizontale kanë shfaqur rritje gjatë viteve të fundit. Ky zhvillim, i përkon edhe reformës së ndërmarrë nga Komisioni Europian, reformë e cila thekson më tepër ndihmën shtetërore në shpenzimet horizontale, për shkak se, ndihmat shtetërore në shpenzimet elektorale krijojnë efekte që mund të dëmtojnë konkurrencën. Shpenzimet e ndihmës shtetërore kanë pësuar rënie që nga viti 1992, ndërsa të dhënat ndryshojnë në vendet e ndryshme të Bashkimit Europian. Përkatësisht Malta shpenzon (3.03%), Qipro (1.71%), Hungaria (1.71%), Portugalia (1.70%) Finlanda (1.68%) të GDP-së për ndihmën shtetërore. Në kontrast nga këto shtete shpenzimet për ndihmën shtetërore arrijnë nën 0.50% të GDP-së përkatësisht: Holanda (0.48%), Luksemburgu (0.42%), Bullgaria (0.41%), Mbretëria e Bashkuar (0.30%) dhe Estonia (0.26%)². Si konkluzion, është e rëndësishme të kujtojmë se shumica e ndihmës shtetërore varion në çdo vend anëtar të Bashkimit Europian. Këto shpenzime kanë rënë në mënyrë të dukshme, në nivelin e Bashkimit Europian, përgjatë dekadës së fundit. Për më tepër, në harmoni me rregullimet e reja të Bashkimit Europian në fushën e ndihmës shtetërore, kompozimi i ndihmës shtetërore ka ndryshuar nga dominimi i masave sektoriale, duke i dhënë peshë më të madhe masave financiare horizontale. Situata aktuale e burimeve të pamjaftueshme dhe kriza e thellë financiare, ka sjellë kërkesën e projekteve adekuate që meritojnë të mbështeten financiarisht nga Bashkimi Europian dhe shtetet anëtare. Politika e ndihmës shtetërore ka shfaqur deficienca në përballimin e sfidave të tilla; ndjekja e procedurave është shfaqur e ngadaltë; sistemi rregullator është shumë i vështirë të zbatohet, dhe ajo ç'ka është më e rëndësishme, janë shfaqur vakuume ligjore në këtë fushë. Në maj të vitit 2012, Komisioni Europian, deklaroi projektin e modernizimit të sistemit të ndihmës shtetërore, duke përfshirë një numër reformash.³

3. Ndihmat shtetërore në planin institucional

Një seri vendimesh spektakolare të ndihmës shtetërore, në vitin 1994, kanë shkaktuar një debat të gjallë në lidhje me efikasitetin dhe meritat e kontrollit shtetëror të ndihmës së Komisionit. Do të shqyrtojmë disa elemente strukturore të kontrollit të ndihmës shtetërore dhe do të përqipemi të rrisim nivelin e të kuptuarit, për atë që është padyshim një nga detyrat më të vështira dhe delikate të Komisionit. Rritja e debatit publik për ndihmat shtetërore dhe kontrollin nëpërmjet Komisionit, është i shëndetshëm dhe i mirëpritur. Këshilli i Evropës ka deklaruar vazhdimisht se kontrolli i rreptë i ndihmës shtetërore është një element thelbësor për funksionimin efikas të Tregut të Brendshëm.

² B. Tunaluy and Jan Fidrmuc, *State Aid Policy in the European Union 2015*, page 7, Brunel University press London

³ Shih: Neni 108 TFEU, publikuar nga Ministria e Integritetit, faqe 91-92.

Gjithashtu: *Rregulloren e Këshillit* 659/1999 që përcakton rregulla të hollësishtme për zbatimin e nenit 93 të Traktatit të KE-së, 1999, OJ L83 / 1.

Prifti, A.
 ❖ Ndihma shtetërore në BE dhe ndikimi, në ekonominë dhe sigurinë e përbashkët ❖

Policimi dhe Siguria
nr.5, 2017

Pati debate të diskutueshme publike, në të dyja forumet demokratike të institucionalizuara dhe në mediet jo të institucionalizuara, që do të kontribuonin në politikën e ndihmës shtetërore dhe në rritjen e shpejtë të numrit të vendimeve të Gjykatës, të cilat janë një shprehje e dukshme e mënyrës eksponenciale të rritjes së aplikimeve për gjykatat evropiane dhe juridiksionale përkatëse, të kontrollit të ndihmës shtetërore. Pika fillestare njihet mirë, por ia vlen të kujtohet shkurtimisht. Kontrolli i ndihmës shtetërore është tradicionalisht i panjohur për shtetet, qofshin këto të organizuara si shtete qendrore, federatave apo konfederatave.

Kontrolli i ndihmës shtetërore është një tipar unik i Bashkimit Evropian. Kjo është përvoja e Bashkimit Evropian që ka inspiruar kodet e njëpasnjëshme të subvencioneve të GATT dhe eksportet e saj të fundit, të mekanizmave të kontrollit të ndihmës shtetërore në Zonën Ekonomike Evropiane dhe në vendet fqinje, veçanërisht në Evropën Lindore dhe Qendrore. Kontrolli i ndihmës shtetërore në BE duhej vendosur në mënyrë progresive nga e para. As autorët e traktateve dhe as Autoriteti i Lartë i Qymyrit dhe Çelikut të Komunitetit Evropian (“ECSC”) dhe Komisioni i Komunitetit Ekonomik Evropian (“EC”) nuk mund të kenë bërë rekurs ndaj praktikave të mëparshme ndërkombëtare ose kombëtare. Edhe sot, kuptimi i kontrollit të ndihmës shtetërore është i pazhvilluar; krahasoni sasinë e madhe e të shkruarit në antitrust dhe pyetjet për mungesën e botimeve mbi çështjet e ndihmës shtetërore. Një nga pyetjet më të dukshme, e cila duhet të intrigojë ekonomistët dhe juristët po ashtu, shkon në thelb të kontrollit të ndihmës shtetërore. Pse mundet të funksionojë Federata pa ndonjë monitorim qendror të mekanizmit? A është procesi demokratik ai që e bën të tepërt kontrollin e ndihmës shtetërore? A janë subvencionet shtetërore *de facto*, të disiplinuar nga regjistrimet e shpenzimeve dhe kompetencat e federatës? A ka ndonjë mekanizëm tjetër që plotëson rolin që merr përsipër në BE, shteti, për kontrollin e ndihmave nga Komisioni?

Kontrolli i ndihmës shtetërore në BE është i natyrës kushtetuese. Me përjashtim të Politikave të përbashkëta, bujqësisë, peshkimit dhe transportit, qymyrit dhe çelikut dhe, ndërtimit të anijeve, Këshilli nuk ka miratuar legjislacionin sekondar për kontrollin e ndihmës shtetërore. Pajtueshmëria e subvencioneve shtetërore është shqyrtuar në bazë të rregullave thelbësore të nenit 92 dhe në përputhje me dispozitat procedurale të nenit 93 të Traktatit të KE. Neni 94, i cili lejon Këshilli për “të bërë ndonjë rregullore të përshtatshme për zbatimin e neneve 92 dhe 93”, ka mbetur territor i paprekur (këto nene, tashmë në TFBE, janë 101-109). Në këtë kuptim, ajo është mjaft e ndryshme nga neni 87, i cili është përdorur me bollëk për zbatimin e sundimit antitrust të Traktatit të KE-së. Në reflektimin dhe në dritën e përvojës, mungesa e rregulloreve të Këshillit dhe e propozimeve të Komisionit është krejtësisht e kuptueshme. Gjatë vitit 1960, paaftësia e Këshillit për të arritur marrëveshjet, bllokoi të gjitha përpjekjet për të nxjerrë ligje sipas nenit 94.⁴ Komisioni ka abstenuar, që nga bërja e propozimeve. Qeveria italiane ndërmori nismën e fundit për të risjellë nenin 94 në gjashtëmuorin e parë të vitit 1991, kur ajo kryesoi Këshillin. Iniciativa u refuzua, nga të paktën prej gjysmës së shteteve anëtare. Përvojat e fundit në sektorin e çelikut, demonstrojnë se Këshilli nuk është në gjendje që të merret me çështje të ndihmës shtetërore, në mënyrë racionale. Shprehje të tilla si “kalë tregtie” ose “marrje peng”, vijnë në mend, kur dikush dëshiron të kualifikojë sjelljen e Këshillit në rastet e ndihmës shtetërore.

Prifti, A.
« Ndhima shtetërore në BE dhe ndikimi, në ekonominë dhe sigurinë e përbashkët »

Policimi dhe Siguria
nr.5, 2017

⁴ Christian Buelens, Gaëlle Garnier, Matthew Johnson dhe Roderick Meiklejohn. *Publications BU-1 B - 1049 Brussels, Belgium*, faqe, 1-4
http://ec.europa.eu/economy_finance/publications/pages/publication9549_en.pdf

3.1 Çfarë është modernizimi i ndihmës shtetërore

Duke filluar nga maj i vitit 2012, Komisioni Europian filloi adoptimin e një pakete madhore reformash të quajtur Modernizimi i Ndhmës Shtetërore (State Aid Modernization SAM). Kjo reformë është një ndryshim në menaxhim dhe zbatimin e politikës së shteteve anëtare të BE-së, e cila jep mundësinë për alokimin më të mirë të resurseve publike dhe promovon efikasitet më të lartë e cilësi më të mirë aty ku ndërhyhet me mekanizmat e kësaj politike. Mes pikave dhe objektivave kyçe të reformës, janë shkurtimet e ndjeshme burokratike, promovimi dhe përdorim më efikas i resurseve të pamjaftueshme publike nga shtetet anëtare dhe kontributi më i madh i ndihmës shtetërore në rritjen ekonomike. Në korrik të viti 2014, disa ndryshime rregulloresh hynë në fuqi dhe e bënë më të lehtë dhënien e ndihmës për projekte që promovojnë rritjen ekonomike e që kanë efekte minimale të prishjes së tregut të vetëm europian. Këto ndryshime të reja, janë mbështetur në marrëveshje mbi standarde të larta të transparencës dhe llogaridhënies së ndihmës shtetërore. Masat e përbashkëta do të garantohen nga shtetet anëtare të Bashkimit Europian në partneritet të afërt me Komisionin Europian. Komisioni⁵ nga ana e vet, në mënyrë proaktive do të udhëzojë shtetet anëtare në hartimin e planeve, të cilat janë të mirëdetajuara dhe të cilat kontribuojnë në arritjen e rezultateve të dëshiruara, nga modernizimi i politikës të ndihmës shtetërore. Si pjesë e paketës MNSH-së (modernizimi i ndihmës shtetërore), Komisioni ka adoptuar dhjetë udhëzime në fushën e kërkim-zhvillimit dhe inovacionit, lidhjeve me “band” të gjerë, energjisë dhe mjedisit, financimit të riskut të SVM-ve (sipërmarrje të vogla dhe të mesme) ndihmave rajonale dhe të tjera, të bazuara në parimet e përgjithshme. Gjithashtu, Komisioni Europian ka adoptuar pesë rregullore, për t’i bërë instrumentet e kontrollit dhe procedurat e ndihmës shtetërore më efçente.

3.2 Cili do të jetë ndikimi i rregullave të reja

Një ndër gurët themelorë të reformës është “rregullorja për përjashtim në bllok” (General Block Exemption Regulation GBER), e cila thjeshtëzon procedurat e dhënies së ndihmave nga shtetet anëtare, duke i autorizuar ato, pa pasur nevojën e njoftimit për një numër të gjerë masash, me qëllim përmbushjen e objektivave në interesin e përbashkët. Në të ardhmen, tre të katërtat nga masat aktuale të ndihmës shtetërore dhe rreth dy e tretat e shumës së ndihmës, mund të mbulohen nga rregullorja e re. Kjo masë mund të shtrihet gati në tërësi ose në shifra përqindje më të larta - ka gjasa të rritet deri në 90% e ndihmave shtetërore që shtetet anëtare përdorin. Kjo do të thotë, që subjekt i shqyrtimit *ex ante* (ushtrimi i procedurës me njoftim paraprak) do të jenë vetëm rastet me potencial prishje të konkurrencës së tregut të vetëm të Bashkimit Europian. Aktualisht mundësia për përjashtim në bllok, mbulon një numër të gjerë sektorësh dhe masa ndihmash:

- Kategori të reja për përjashtim nga njoftimi, pas adoptimit të vendimit për zbatimin e rregullores: siç është ndihma në fushën e inovacionit deri në sipërmarrje të mëdha, transmetimi në “band” të gjerë dhe transmetimet audio-vizive.

- Forma të reja përjashtimi në kategoritë ekzistuese, sikundër është koncepti më i gjerë në ndihmat e riskut financiar, ndihma në investimin për infrastrukturën e kërkimit,

Prifti, A.
☛ Ndhimja shtetërore në BE dhe ndikimi, në ekonominë dhe sigurinë e përbashkët ☛

Policimi dhe Siguria
nr.5, 2017

⁵ Njoftim nga Komisioni në një procedurë të thjeshtuar për lloje të caktuara të ndihmës shtetërore, COM 2009 / C 136/03, OJ C136 / 3, par. 13F

mundësi të reja për sektorin energjetik dhe mjedisin.

- Prague më të larta njoftimi dhe dendësi më të madhe ndihmash⁶. Për shembull, pragu i njoftimit në fushën e kërkim-zhvillimit dhe ndihma në inovacion është dyfishuar. Shtetet anëtare, aktualisht mund të japin ndihma për zhvillime eksperimentale deri në 15 milion euro për projekte dhe përfitime në këtë fushë, pa ndërmarrë veprimin e njoftimit dhe aprovimin e Komisionit, duke e krahasuar këtë, me rregullat e mëparshme që lejonin deri më 7.5 milion euro. Për sipërmarrjet e vogla dhe të mesme, aksesit i riskut financiar, pragu i njoftimit, është rritur për ndihmat që shkojnë deri në 15 milion euro, nga sa ishte më parë: 1.5 milion euro; kjo, deri në ciklin e plotë të zhvillimit të kompanisë.

Kjo masë e re, e ndërmarrë nga rregullorja e re e Bashkimit Europian, do të ketë një ndikim të fortë në përfitimet e ndihmave dhe autoriteteve që i lëshojnë këto ndihma⁷. Kështu, kemi akses më të shpejtë në ndihma, sepse shmangim dukshëm procedurën e njoftimit dhe reduktimin e barrierave administrative, për shkak se kushtet janë lehtësuar duke demonstruar efektet shtytëse ekonomike.⁸

3.3 Më shumë fleksibilitet më shumë përgjegjësi

Me vendosjen e rregullave të reja, autoritetet që lëshojnë ndihmat përfitojnë shkallë më të gjerë mundësie për të dizajnuar dhe implementuar masat e ndihmës shtetërore. Në të njëjtën kohë, Komisioni duhet të luajë rolin e tij të plotë, si rojtari i mbrojtjes së konkurrencës së ndershme në tregun e vetëm të Bashkimit Europian. Rregullat e reja të reformës së ndihmës shtetërore vendosin një balancë mes variabëlve për shtetet anëtare të Bashkimit nga njëra anë, ndërsa, nga ana tjetër vendos rregulla që mbrojnë dhe janë në përputhje me konkurrencën e ndershme në tregun e vetëm. Një numër iniciativash kanë si qëllim të mbrojnë këtë balancë:

- Transparenca, dhënia e ndihmave do të jetë publike në nivel individual. Kjo do të sigurojë verifikim mes partnereve, kontroll publik dhe llogaridhënie.

- Monitorimi, përforcon kontrollin *ex post* dhe përputhshmërinë me kushtet formale për përjashtim nga njoftimi.

- Vlerësimi *ex post* i planeve të mëdha: një metodë më e qëndrueshme dhe më efektive për të garantuar ndihmat me efekt shtytës, gjithashtu do të ndihmojë në hartimin e planeve më të mira me impakt të limituar në konkurrencë dhe tregti.

3.4 Ndarje dhe domethënie në nivel lokal dhe në nivel kombëtar

Shumica e rregullave hyri në fuqi më një korrik të vitit 2014 dhe benefitet e asociuara do të fillojnë materializimin e tyre në mënyrë graduale. Në të ardhmen, planet ekzistuese kanë nevojë të adaptohen dhe masat do të implementohen nga vendet anëtare të BE-së nën projektionin e rregullave të reja. Në të njëjtën kohë, vendet anëtare, duhet të ndërmarrin hapat e tyre për të garantuar transparencën dhe vlerësimin për zhvillim, për vitet pasardhëse. Sikundër dhe tregojnë statistikën, zbatimin e rregullores varion në mënyrë të konsiderueshme mes shteteve anëtare. Ka një fushëveprim të gjerë për të ushtruar potencialin e plotë të rregullave të reja. Komisioni jep mbështetjen e plotë të tij,

Prifti, A.
« Ndhima shtetërore në BE dhe ndikimi, në ekonominë dhe sigurinë e përbashkët »

Policimi dhe Siguria
nr.5, 2017

⁶ Për shembuj të ndryshëm, shih regjistrin e ndihmës shtetërore :

http://ec.europa.eu/competition/elojade/isef/index.cfm?fuseaction=dsp_sa_by_date~~HEAD=dobj .

⁷ Uriá Menéndez, *La reforma del régimen de ayudas de Estado en la Unión Europea pdf 342013*, seen at <http://www.uria.com/documentos/publicaciones/3815/documento/UE01.pdf?id=4589>

⁸ B. Tunalý and Jan Fidrmuc, *State Aid Policy in the European Union 2015*, page 11-12 Brunel University press London, working paper Nr. 14

si shembull duke vizituar të gjitha vendet anëtare, duke dëgjuar shqetësimet e tyre për të ofruar këshillimet praktike të rastit. Paketa e rregullave gjithëpërmbledhëse vendos në mënyrë efektive një partneritet të ri mes shteteve anëtare dhe Komisionit Europian. Komisioni dhe shtetet anëtare së bashku, luajnë rol domethënës. Komisioni fokusohet në rastet me impakt madhor, në fushën e konkurrencës dhe merr proceset e marrëveshjeve me shtetet anëtare në mënyrë prioritare. Shtetet anëtare do të kenë më shumë përgjegjësi për hartimin dhe implementimin e planeve, pa pasur nevojën e njoftimit paraprak dhe zbatimin e kontrolleve efçente në nivel kombëtar (kontrolli i cili mund të arrihet me ngritjen e institucioneve përshtatëse nga shtetet anëtare). Për këtë qëllim, është e domosdoshme dhënia e asistencës teknike nga ekspertët të fushës, e trajnimeve dhe dhënia e njohurive nga autoritetet europiane, kombëtare dhe lokale.

3.5. Çfarë e bën një masë të konkurrueshme me tregun e vetëm të Bashkimit European

Modernizimi i ndihmës shtetërore qartëson kriteret për gjetjen se kur një ndihmë shtetërore është konkurruese në përputhje me rregullat e tregut dhe se si aprovohet ajo:

- masa e ndihmës shtetërore, duhet të jepet në përputhje me objektivin e interesit të përbashkët;

- duhet të adresohet ndaj një situatë, ku ndihma shtetërore sjell përmirësim material, kur tregu vet nuk mund të zgjidhë problemin, si për shembull duke korigjuar dështimet e tregut ose adresuar barazi në lidhje me shqetësimet e ngjashme;

- duhet të jetë një instrument politik për zgjedhjen e objektivave në interes të përbashkët;⁹

- ndihma duhet të ndryshojë sjelljen e sipërmarrësve, në lidhje me shqetësimin mbi zënieën e aktiviteteve shtesë, të cilët nuk mund të korrin sukses pa ndihmë shtetërore, ose t'ia dalin mbanë në mënyrë të kufizuar, të ndryshme apo të lokalizuar;

- sasia e ndihmës duhet të jetë e limituar në minimalen e nevojshme dhe të shkaktojë investime apo aktivitete shtesë;

- efektet negative në konkurrencë dhe shkëmbimin tregtar mes vendeve, duhet të qëndrojnë në nivelet më të limituara të mundshme;

- aktet relevante dhe informacioni përkatës rreth dhënies së ndihmave duhet të jenë transparentë.

4. Prioritet kombëtare dhe europiane në fushën e ndihmave shtetërore

Sikundër dhe kemi cituar në paragrafët pararendëse, strategjia për modernizimin e politikës të ndihmave shtetërore, u prezantua nga Komisioni European gjatë muajit maj të vitit 2012 dhe përmban vendosjen e disa prioriteteve, mes të cilëve veçojmë si më të rëndësishëm:

- stimulimin e rritjes ekonomike dhe formimin e një tregu të vetëm dinamik, të përforcuar dhe konkurrues;

- përqendrimin në implementimin e rasteve me ndikim më të madh në tregun e vetëm;

⁹ Directorate-General of the European Commission. "State aid modernisation – a major revamp of EU State aid control". *Competition policy brief, Issue 11, November 2014*, European Commission.

- thjeshtëzimin e rregullave për marrjen e vendimeve në mënyrë më të shpejtë;

Projektimi i këtyre masave të njohura si “qëllime të mira”, ka synim në vetvete që të mirat publike të shpenzohen në mënyrë të drejtë dhe efektive. Sikundër edhe qëllimet e përcaktuara në strategjinë 2020, politika e ndihmave shtetërore është një paralele për arritjen e një tregu më konkurrues, punësim më të madh, mbrojtjen e mjedisit, stimulimin e investimeve në fushën e kërkim-zhvillimit dhe zhvillim të qëndrueshëm ekonomik. Ndërhyrja nga shteti, me të mira publike, shfaqet e detyrueshme për sipërmarrësit që gjenden në prag falimenti ose në vështirësi financiare për të mbrojtur investimet e tyre dhe kjo ka ndikim në të mirën e përbashkët komunitare, duke pasur në fokus mosprishjen e tregtisë mes vendeve anëtare të Bashkimit Europian. Garantimi i udhëzimeve që përcaktojnë rregullat se kur duhet të ndërhyjë shteti anëtar dhe, se kur duhet të realizohet procedura e njoftimit në nivel kombëtar, e ka lehtësuar kontrollin e ndihmave dhe shmangien e efektit negativ në tregun e përbashkët.¹⁰

5. Rregullorja

Rregullorja për përjashtimin në bllok, ose e njohur ndryshe si rregullorja 651/2014, ka hyrë në fuqi në vitin 2014. Kjo rregullore është dhe baza e reformës për modernizimin e ndihmës shtetërore. Në të vërtetë, objektivi parësor i modernizimit të kësaj politike, është shtyrja e shteteve anëtare që të aplikojnë rregulloren për një numër të gjerë të masave të ndihmës shtetërore, të cilat, kanë buxhet të vogël; të punësojnë njerëz dhe të zbatojnë instrumente politike të pajtueshme. Arsyeimi i Komisionit, është se shtetet duhet të limitojnë procedurën e njoftimit për masat që nuk marrin pjesë të mëdha të fondeve publike apo, të përdorin instrumente politike me ndikim madhor. Komisioni ka zbatuar masat rutinë të shqyrtimit të marrjes së resurseve madhore, gjithsesi, kjo nuk shton më tepër kompetenca sepse efektet e këtyre masave, janë relativisht minimale. Komisioni argumenton se: resurset që duhen kontrolluar nga ana e tij, janë ato me ndikim në konkurrencën e lirë të tregut të vetëm europian. Komisioni mund të ushtrojë kompetencën e kontrollit të ndihmave shtetërore, në shuma që kalojnë pragun e vendosur nga ky i fundit.¹¹

5.1 Konkluzione

Rregullorja e re, qartëson ndjeshëm financimet e BE-së, të cilat menaxhohen nga niveli BE-së dhe nuk janë subjekt kontrolli i shteteve anëtare e nuk konsiderohen si ndihma shtetërore. Nëse financime të tilla të BE-së, kombinohen me ndihmat shtetërore, kjo gjë bëhet vetëm për qëllime përputhshmërie me pragjet, procedurat e njoftimit paraprak dhe për të respektuar dendësinë maksimale të shumave të ndihmës. Ndihma me përzgjedhje kostoje të identifikueshme, mund të bashkohet me ndihma të tjera shtetërore, nëse kostot e përzgjedhjes janë të ndryshme; këto kosto mund të bashkohen gjithashtu edhe me kosto më të vogla, gjithmonë pa kaluar shumën

Prifti, A.
« Ndihma shtetërore në BE dhe ndikimi, në ekonominë dhe sigurinë e përbashkët »

Policimi dhe Siguria
nr.5, 2017

¹⁰ Ivanova, Theodora, “Ministry of Finance department of state aid”, 25 mars 2015, gjendet në faqen: www.stateaid.minfin.bg

¹¹ Commission Regulation (EU) No 651/2014, 17 June 2014, “Declaring certain categories of aid compatible with the internal market in application of Articles 107 and 108 of the Treaty Regulation”, Gjendet në faqen: http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=uriserv%3AOJ.L_.2014.187.01.0001.01.ENG

maksimale të lejuar. Ndihma pa kosto të identifikueshme përzgjedhjeje (shembull risku financiar), mund të bashkohet me ndihma të tjera me kosto përzgjedhjeje të identifikueshme. Gjithashtu, lejohet bashkimi me ndihma të tjera me kosto përzgjedhjeje të paidentifikuar nëse pragu financiar nuk tejkalohet. Ndihma shtetërore nuk mund të bashkohet me ndihma minimale për të njëjtën kosto përzgjedhjeje, nëse pragu i lejueshëm është tejkaluar.

5.2 Publikimet

Shtetet anëtare duhet të publikojnë informacionin në një faqe interneti të posaçme për ndihmat shtetërore, si në vijim:

- një raport përmbledhës informacioni,
- tekstin e plotë të çdo mase të ndihmës shtetërore,
- çdo grand apo ndihmë individuale i cili tejkalon shumën e 500 000 eurove.

Shtetet anëtare kanë afat dyvjeçar për të përmbushur detyrimet në lidhje me publikimin në faqen e internetit dhe publikimin e ndihmave për individ.

5.3 Monitorimi

Komisioni mund të tërheq investimet, bazuar mbi rregulloren 651/2014 nëse një shtet anëtarë nuk vepron në përputhje me kushtet e përgjithshme apo specifike. Komisioni mund gjithashtu të tërheq përfitimet e alokuara duke marrë në konsideratë dhe format e lejuara të ndihmës, për marrësin dhe dhënësin e ndihmës.

5.4 Raportimi

Shtetet anëtare duhet t'i dorëzojnë Komisionit një raport informues brenda afatit kohor të 20 ditëve punë, për zbatimin e masës. Gjithashtu, shtetet anëtare janë të detyruara t'i dërgojnë Komisionit raporte vjetore. Shtetet duhet të mbajnë të dhëna të detajuara për 10 vjet dhe, nëse Komisioni kërkon informacion të përshtatshëm, shtetet duhet ta dërgojnë atë brenda afatit 20-ditor.

6. Përfundime

Rregullorja për përjashtime në bllok (651/2014), është padyshim një gur kilometrik për regjimin e ndihmave shtetërore për periudhën 2014-2020. Kjo rregullore mbulon të gjitha kategoritë e ndihmës shtetërore dhe shtetet anëtare duhet ta ushtrojnë atë në mënyrë të gjerë. Gjithsesi, duhen vënë në dukje dy rezerva. Së pari, duhet të shihet se sa e dobishme do të jetë rregullorja e re (651/2014), për shtetet anëtare, të cilat nuk do të jenë në gjendje të kenë të njëjtën shkallë të sigurisë ligjore, në procesin e kërkimit të ndihmës shtetërore. Së dyti, nuk mund të përjashtohet mundësia, që shteti anëtar të ketë tendencën e abuzimit, duke parë këtu, gjerësinë e përmbajtjes së rregullores dhe mundësinë e manovrimit për shkak të shumë fushave; kjo mund ta çojë një shtet drejt marrjes së masave të papajtueshme me tregun e përbashkët. Nisur nga pozicionimi i Komisionit, i cili kërkon publikimin e planeve dhe vlerësimin e ndihmës, duket se

Prifti, A.
☛ Ndihma shtetërore në BE dhe ndikimi, në ekonominë dhe sigurinë e përbashkët ☛

Policimi dhe Siguria
nr.5, 2017

konkurruesve u kërkohet që të jenë vigjilent në çdo rast nëse do të kishte abuzime me ndihmën.

Mbetet për tu parë nëse Komisioni u ka dhënë konfidencën e duhur konkurruesve, për zbatimin korrekt të kësaj politike. Modernizimi i ndihmës shtetërore vendos pragjet e njoftimit; thjeshtëzon dhënien e ndihmave, për veprime, të cilat rrisin efikasitetin e politikës së ndihmave shtetërore; sjell shtysa ekonomike për shtetet anëtare, të cilat ofrojnë ndihma për kompani në nevojë, pa prishur konkurrencën e ndershme dhe me qëllim kontributin në mënyrë direkt për hapjen e vendeve të punës dhe rritjen ekonomike; ndihma shtetërore kontribuon për një cilësi më të mirë në shërbimet publike, duke zbatuar parimet e transparencës dhe të llogaridhënies.

Referenca

1. *Traktati për Funksionimin e Bashkimit Europian*, publikuar nga Ministria e Integritimit Europian.
Gjendet në: <http://www.integrimi.gov.al/al/dokumente>
2. B. Tunaluy and Jan Fidrmuc, *State Aid Policy in the European Union*, London, 2015: Brunel University press.
3. *Rregulloren e Këshillit 659/1999* që përcakton rregulla të hollësishtme për zbatimin e nenit 93 të Traktatit të KE-së , 1999, OJ L83 / 1.
4. Christian Buelens, Gawlle Garnier, Matthew Johnson dhe Roderick Meiklejohn. *Publications BU-1 B - 1049 Brussels*, Belgium.
Gjendet në: http://ec.europa.eu/economy_finance/publications/pages/publication9549_en.pdf
5. Njoftim nga Komisioni në një procedurë të thjeshtuar për lloje të caktuara të ndihmës shtetërore , COM 2009 / C 136/03, OJ C136 / 3, par . 13F
6. Regjistri i Ndhmës Shtetërore. Gjendet në:
7. http://ec.europa.eu/competition/ejojade/isef/index.cfm?fuseaction=dsp_sa_by_date~~HEAD=dojb.
8. Uría Menéndez, “*La reforma del régimen de ayudas de Estado en la Unión Europea*”.
Gjendet në: <http://www.uria.com/documentos/publicaciones/3815/documento/UE01.pdf?id=4589>
9. Directorate-General of the European Commission. “State aid modernisation – a major revamp of EU State aid control”. *Competition policy brief, Issue 11, November 2014*, European Commission.
10. Ivanova, Theodora, “Ministry of Finance department of state aid”, 25 mars 2015,
gjendet në faqen: www.stateaid.minfin.bg
11. Commission Regulation (EU) No 651/2014, 17 June 2014, “Declaring certain categories of aid compatible with the internal market in application of Articles 107 and 108 of the Treaty Regulation”,
Gjendet në faqen:
http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=uriserv%3AOJ.L_2014.187.01.0001.01.ENG

Prifti, A.

☛ Ndhma shtetërore në BE dhe ndikimi, në ekonominë dhe sigurinë e përbashkët ☛

Policimi dhe Siguria
nr.5, 2017

Policimi në komunitet: “Zyrat e Shërbimit të Qytetarëve” të Komisarariatit të Policisë Durrës, në kuadër të kësaj strategjie



■ Dr. proc. **Anisa HYESANI***
Komisariati i Policisë Durrës

Abstrakt

Ka modele të ndryshme të policimit ku përpos policimit tradicional, policimit inteligjent, policimit siguries etj., kemi dhe atë që quhet policimi në komunitet. Policimi në komunitet, në esencën e tij, është një bashkëpunim ndërmjet policisë dhe komunitetit, për të identifikuar dhe zgjidhur problemet e sigurisë së përbashkët. Në këtë paradigmë, policia nuk është “ruajtësi” i vetëm i ligjit dhe rendit, por të gjithë anëtarët e komunitetit supozohet të bëhen aleatë aktivë në përpjekje për të përmirësuar sigurinë dhe cilësinë e jetës. Policia Shqiptare prej disa vitesh, po rishikon në mënyrë graduale organizimin, proceset e punës, metodat dhe praktikat e policimit, si dhe po përpiqet të ndërtojë një kulturë të organizatës të bazuar në filozofinë e policimit në komunitet.¹ Policimi në komunitet ndryshon nga policimi tradicional, në mënyrën sesi komuniteti perceptohet dhe qëllimet e zgjeruara të cilat përfshin. Ndërsa kontrolli mbi krimin dhe parandalimi ngelen qëllime prioritare, policimi në komunitet përdor një sërë metodash dhe strategjish për të adresuar këto objektiva. Forcimi i policimit në komunitet sjell një adresim nevojash më të saktë dhe zgjidhje sa më pranë realitetit të problematikave. Qëllimi përfundimtar i Policimit në Komunitet është të krijojnë një mjedis të sigurt duke ndërtuar bashkëpunim dhe struktura të qëndrueshme të komunitetit si dhe një instrument për të promovuar bashkëpunimin midis Policisë së Shtetit dhe institucioneve të qeverisjes lokale, aktorë dhe grupe të tjera interesi. Një ndër pikat me të cilat një strategji efektive e policimit në komunitet duhet të merret, është pikërisht ndërveprimi me publikun e paorganizuar², ku sigurisht përfshihet dhe komuniteti i qytetarëve, subjekteve dhe bizneseve që marrin shërbim për praktika dhe procedura të ndryshme pranë komisariateve apo drejtorive vendore të policisë. Për këtë arsye në 2015, filloi krijimi në pothuaj të gjithë komisarariatet dhe drejtoritë vendore të policisë shqiptare i Zyrave të Shërbimit të Qytetarit (ZSHQ). ZSHQ-të kanë sjellë një ndërveprim të ri, jo vetëm në marrëdhënien e komunikimit me qytetarin dhe biznesin, por njëkohësisht kanë ndikuar në efikasitetin e komunikimit dhe realizimit të praktikave dhe procedurave në strukturat ndërmjetëse përkatëse. Më tej në këtë punim përpos avantazheve a priori të krijimit të këtyre zyrave, duke sjellë si kampion studimi ZSHQ-në e Durrësit, e cila është njëkohësisht në funksion të drejtorisë vendore të policisë si dhe Komisarariatit të Durrësit, duke dashur të hedh dritë mbi opinionin e qytetarëve lidhur me këtë zyrë të re shërbimi si dhe deri diku matjen e “pulsit” institucional, pas krijimit të ZSHQ-së.

Hysesani, A.
« Policimi në
komunitet:
“Zyrat e
Shërbimit të
Qytetarëve”
të Komisarariatit
të Policisë
Durrës, në
kuadër të kësaj
strategjie »

Policimi
dhe
Siguria
nr.5, 2017

Fjalëkyçe:

Policimi në komunitet, Zyrat e Shërbimit të Qytetarëve, marrëdhënie publike.

1. Hyrje

Ka modele të ndryshme të policimit ku përpos policimit tradicional, policimit inteligjent, policimit siguries, etj., kemi dhe atë që quhet policimi në komunitet. Policimi në komunitet, në esencën e tij, është një bashkëpunim ndërmjet policisë dhe komunitetit, për të identifikuar dhe zgjidhur problemet e sigurisë së përbashkët. Në këtë paradigmë, policia nuk është “ruajtësi” i vetëm i ligjit dhe rendit, por të gjithë anëtarët e komunitetit supozohet të bëhen aleatë aktivë në përpjekje për të sigurinë dhe përmirësuar cilësinë e jetës. Policia shqiptare prej disa vitesh po rishikon në mënyrë graduale organizimin, proceset e punës, metodat dhe praktikat e policimit, si dhe po përpiqet të ndërtojë një kulturë të organizatës të bazuar në filozofinë e policimit në komunitet.³ Implementimit të policimit në komunitet i nevojiten ndryshime esenciale në strukturën dhe menaxhimin e Policisë. Policimi në komunitet ndryshon nga policimi tradicional, në mënyrën sesi komuniteti perceptohet dhe qëllimet e zgjeruara të cilat përfshin. Ndërsa kontrolli mbi krimin dhe parandalimi ngelen qëllime prioritare, policimi në komunitet përdor një sërë metodash dhe strategjish për të adresuar këto objektiva. Forcimi i policimit në komunitet sjell një adresim nevojash më të saktë dhe zgjidhje sa më pranë realitetit të problematikave. Qëllimi përfundimtar i policimit në komunitet është të krijojnë një mjedis të sigurt duke ndërtuar bashkëpunim dhe struktura të qëndrueshme të komunitetit si dhe një instrument për të promovuar bashkëpunimin midis PSH dhe institucioneve të qeverisjes lokale, aktorë dhe grupe të tjera interes. Një ndër pikat me të cilat një strategji efektive e policimit në komunitet duhet të merret, është pikërisht ndërveprimi me publikun e paorganizuar, ku sigurisht përfshihet dhe komuniteti i

*Aktualisht doktorante si dhe pedagoge e jashtme e marrëdhënieve publike pranë Fakultetit të Shkencave Sociale, Tiranë si dhe funksionare në Zyrën e Shërbimit ndaj Qytetarëve, Komisariati i Policisë Durrës (grada: civile)

¹ *Manual i Policimit në Komunitet*, f. 7.

² *Ibid*, f. 73

³ *Manual i Policimit në Komunitet*, f. 7.

⁴ ZSHQ.

Hysesani, A.
« Policimi në
komunitet:
“Zyrat e
Shërbimit të
Qytetarëve”
të Komisarariatit
të Policisë
Durrës, në
kuadër të kësaj
strategjie »


Policimi
dhe
Siguria
nr.5, 2017

qytetarëve, subjekteve dhe bizneseve që marrin shërbim për praktika dhe procedura të ndryshme pranë komisariateve apo drejtorive vendore të policisë. Për këtë arsye në maj 2015, filloi krijimi në pothuaj të gjithë komisarariatet dhe drejtoritë vendore të policisë në Shqipëri, i Zyrrave të Shërbimit të Qytetarit⁴. ZSHQ-të kanë sjellë një ndërveprim të ri, jo vetëm në marrëdhënien e komunikimit me qytetarin, biznesin dhe subjektet private, por njëkohësisht ka ndikuar në efikasitetin e komunikimit dhe realizimit të praktikave dhe procedurave në strukturat ndërmjetëse të komisariateve. Duke performuar në mënyrë optimale dhe duke ndikuar pozitivisht në marrëdhëniet me publikun. Më tej në këtë punim përpos avantazheve *a priori* të krijimit të këtyre zyrrave, duke sjellë si kampion studimi ZSHQ-ja e Durrësit, e cila është njëkohësisht në funksion të drejtorisë, përpiqem të hedh dritë mbi opinionin e qytetarëve lidhur me këtë zyrë të re shërbimi si dhe deri diku matjen e pulsit institucional me të cilën këto zyra funksionojnë.


2. Metodologjia

Metodologjia e këtij punimi, bazohet pikërisht me kampionimin rastësor nëpërmjet të cilit, është realizuar një minisondazh, ku sipas personave që morën shërbim në një ditë të caktuar, pranë ZSHQ-së të Komisarariatit të Policisë, Durrës (nga 30 anketime të mundshme, 3 dolën të pavlefshme për shkak të mosplotësimit korrekt), janë përzgjedhur dhe respondentët. Më poshtë kam realizuar disa interpretime, bazuar në të dhënat statistikore të marra nëpërmjet minisondazhit dhe të përpunuara me SPSS. Njëkohësisht, janë shfrytëzuar teori të ndryshme mbi modelimin e komunikimit të administratës publike, për të bazuar interpretimin mbi rezultatet e opinionëve të qytetarëve. Duhet theksuar që ky sondazh dhe artikulli, nuk synon të përcaktojë apo përkufizojë asgjë përfundimtare, por thjesht të kuptojë trendin e ri që krijimi i ZSHQ-ve, ka synuar të sjellë në kuadër të policimit të komunitet dhe atë që deri aktualisht ka mundur të realizojë nga qëllimi fillestar duke marrë si njësi të vetme analitike ZSHQ-në e Komisarariatit të Policisë Durrës.

3. Interpretimi statistikor




Respondentët variojnë nga grupmosha 16-25 vjeç deri 4-50 vjeç. Sipas ndarjes bazuar në gjini, respondentët më të shumtë në numër janë meshkujt me një peshë prej 59.2%, ndërsa femrat kanë një peshë prej 40.7 %, të respondentëve në total.



MOSHA
SHERBIMI I

Sipas kryqëzimit së të dhënave të moshës me përgjigjet ndaj pyetjes, nëse kjo ishte hera e parë, që po merrnin shërbim pranë Zyrës së Shërbimit ndaj Qytetareve, Komisarati Policisë Durrës, rreth 66.6 % e respondentëve në total, kanë pohuar që ky ishte shërbim për herë të parë, ndaj dhe pesha më e madhe e përgjigjeve vijuese, nuk mund të kenë reflektim krahasimor, me ndonjë shërbim të mëparshëm së të njëjtin respondent, pranë së njëjtës ZSHQ, ndërkaq 24.3% e respondentëve në total, kanë pohuar se ky nuk është shërbimi I që marrin pranë ZSHQ-së përkatëse.




SHERBIMI I
GJINIA

Hysesani, A.
« Policimi në komunitet: “Zyrat e Shërbimit të Qytetarëve” të Komisaritit të Policisë Durrës, në kuadër të kësaj strategjie »


Policimi dhe Siguria nr.5, 2017

Gjithashtu në kryqëzimin e variabëlit të gjinisë, me pyetjen a po merrnin shërbim për herë të parë pranë ZSHQ-së së Komisaritit të Policisë Durrës, rezulton se nga 40.7% e femrave në total që janë respondent, krahasuar me meshkujt , për 72.7% të tyre, ishte hera e parë që merrnin shërbim pranë ZSHQ-së. Ndërsa për totalin prej 59.2 % të respondentëve meshkuj, për 62.05% të tyre ishte hera e parë që merrnin shërbim, pranë këtyre zyrave.



**IMAZHI
MOSHA**

Sigurisht, që një kriter i rëndësishëm për të studiuar feedback-un mbi imazhin, është të zbulojmë se cila grupmoshë e ka më së shumti të reflektuar “imazhin pozitiv”, “negativ” ose “neutral” për Policinë, bazuar në shërbimin që marrin pranë ZSHQ-ve. Sipas grafikut të paraqitur, mund të kuptojmë që perceptimin më pozitiv e ka grupmosha 30-35 vjeç; “neutralët” përfaqësohen nga grupmosha 16-25 vjeç; ndërsa



**IMAZHI
GJINIA**

Hysesani, A.
« Policimi në komunitet: “Zyrat e Shërbimit të Qytetarëve” të Komisaritit të Policisë Durrës, në kuadër të kësaj strategjie »

Policimi dhe Siguria nr.5, 2017

një pjesë e respondentëve, midis moshës 40-50 vjeç, kanë preferuar të mos i përgjigjen kësaj pyetje. Nga totali i 27 respondentëve, 23 respondentë ose 85.2% janë përgjigjur që ZSHQ-të, kanë krijuar një imazh pozitiv për Policinë e Shtetit. Interesante është gjetja, sipas së cilës asnjë individ nuk ka deklaruar “Jo” si përgjigje, por janë përgjigjur vetëm në dy mënyra: “Po” ose “Nuk e di”.

Një tjetër kriter i rëndësishëm për të matur imazhin, është të zbulojmë se cila grupgjinië, ka më së shumti të reflektuar "imazhin pozitiv", "negativ" ose "neutral" për Policinë. Sipas të dhënave të paraqitura në grafik, zbulojmë se nga 40.7% e femrave në total që janë respondent, po aq kanë deklaruar që ZSHQ-të kanë ndihmuar në krijimin e një imazhi pozitiv për Policinë e Shtetit. Ndërsa për sa u përket respondentëve meshkuj rreth 75 % të tyre janë përgjigjur pozitivisht, ndërsa rreth 18.7 % janë përgjigjur që nuk dinë.

4. Opinionet mbi shërbimin pranë ZSHQ-së

Një pyetje tjetër në sondazh, e cila është lënë e hapur, për të lënë sa më shumë variacion feedback-u, ka qenë lidhur me mendimin që respondentët, për shërbimin e marrë gjatë kohës apo shërbimin e sapo marrë dhe përgjigjet e tyre sipas kësaj skeme përshkruese kanë qenë si më poshtë vijojnë:

RESPONDENTËT PËRGJIGJET	
1.	INF. SAK. STAF SPE. KURS. KOHË
2.	SHËRBIM I SHPEJTË, STAF I KUALIFIKUAR
3.	SHËRBIM I SHPEJTË, STAF I KUALIFIKUAR
4.	SHËRBIM I SHPEJTË
5.	PROFESIONALIZËM
6.	SHËRBIM I MIRË
7.	SHËRBIM I SHPEJTË, KULTURË QYTETARE
8.	NUK KA KOMENTUAR
9.	SHËRBIM AFËR QYTETARËVE
10.	NUK KA KOMENTUAR
11.	NA INFORMOJNË MË MIRË
12.	SHËRBIM I SHPEJTË ME CILËSI
13.	NUK KA KOMENTUAR
14.	NUK KA KOMENTUAR
15.	NUK KA KOMENTUAR
16.	NUK KA KOMENTUAR
17.	NUK KA KOMENTUAR
18.	SHËRBIM AFËR QYTETARËVE, PROCEDURAT PËRFUNDOJNË MË SHPEJT
19.	NUK KA KOMENTUAR
20.	NUK KA KOMENTUAR
21.	NUK KA KOMENTUAR
22.	NUK KA KOMENTUAR
23.	NUK KA KOMENTUAR
24.	NUK KA KOMENTUAR
25.	NUK KA KOMENTUAR
26.	NUK KA KOMENTUAR
27.	NUK KA KOMENTUAR

Hysesani, A.
 « Policimi në komunitet: “Zyrat e Shërbimit të Qytetarëve” të Komisarariatit të Policisë Durrës, në kuadër të kësaj strategjie »

Policimi dhe Siguria nr.5, 2017

Elementët që vihen re në përgjigjet e respondentëve, janë që e kanë cilësuar shërbimin si: “të shpejtë”, “profesionist”, “informacion më i saktë”, “respektim i afateve procedurale”.

5. Analizë dhe konkluzione

Komunikimi institucional, është një proces i vazhdueshëm i shkëmbimit të mesazheve verbale dhe joverbale. Mesazhi duhet të përcillet nëpërmjet disa medimeve tek marrësi dhe është shumë e rëndësishme që ky mesazh të kuptohet nga marrësi në të njëjtën linjë, që është përcjellë nga dërguesi. Kështu që komunikimi, është një proces reciprok dhe është i paplotë pa reagim (feedback) të marrësit ndaj dërguesit, për të parë sesi mesazhi është përcjellë. Një ndër profilet e komunikimit, është komunikimi institucional ose ndryshe thënë komunikimi i administratës publike, si një specifike shumë e rëndësishme. Komunikimi efektiv është i rëndësishëm për menaxherët në organizatat në mënyrë që të kryejnë funksionet themelore të menaxhimit, d.m.th, planifikimi, organizimi, drejtimi dhe kontrolli. Komunikimi i ndihmon menaxherët për të kryer punët dhe përgjegjësitë e tyre. Komunikimi shërben si bazë për planifikim. Organizimi gjithashtu kërkon komunikim efektiv me të tjerët në lidhje me detyrën e tyre të punës. Kontrolli nuk është i mundur pa komunikim me shkrim dhe me gojë. Kështu, ne mund të themi se “komunikimi efektiv është një bllok ndërtimi i organizatave të suksesshme”. Me fjalë të tjera, komunikimi vepron si “gjaku” i organizatës.⁵ Si rrjedhojë strategjia e policimit në komunitet dhe përkatësisht krijimi i Zyrave të Shërbimit Ndaj Qytetarit, kanë ndihmuar në komunikimin brenda-institucional, ndër-institucional si dhe jashtë-institucional (me qytetarët, subjektet private si dhe bizneset), për shkak se lehtëson komunikimin dhe informimin, ndjek vijueshmërinë në njësitë ndërmjetëse të realizimit të praktikave etj.

Njëkohësisht ZSHQ-ja, lehtëson pikërisht pengesat tipike të një komunikimi institucional që janë:

- dallimet perceptuese dhe gjuha,
- tejmbushje me informacione,
- presioni kohës,
- emocionet,
- kompleksiteti në strukturën organizative.

Duke ndihmuar pikërisht në:

- plotësi,
- konsideratë,
- qartësi,
- mirësjellje,
- korrektësia.

6. Konkluzione

Ky punim, na nxjerr në një sërë konkluzionesh, ku më të rëndësishmet janë:

- ZSHQ-të kanë sjellë një shërbim më cilësor, më të shpejtë dhe informacion më të saktë, duke realizuar kështu qëllimin parësor për të cilin janë krijuar;

⁵ Sidick, Yammie Mohammad. *Communication in public administration*. Studim i publikuar në: <http://www.slideshare.net/yhamskiey/communication-in-public-administration>

- kanë ngushtuar mundësitë për dezinformim apo zvarritje lidhur me procedurat e ndryshme;
- kanë shkurtuar kohën e informimit apo dorëzimit të praktikës;
- ushtrojnë “presion pozitiv” në strukturat ndërmjetëse përta u përket ecurisë së dosjeve, duke u interesuar brenda afatit për kthim-përgjigje, ndaj qytetarëve apo subjekteve;
- kanë ndikuar pozitivisht në imazhin e Policisë së Shtetit;
- Strategjia e Policimit në Komunitet, për të krijuar struktura të shërbimit civil, është një hallkë e domosdoshme për të balancuar dhe normalizuar komunikimin institucional dhe më tej.

BIBLIOGRAFIA

1. Dominick, J. *Dinamika e komunikimit masiv*. Tiranë: UET Press, 2010.
2. Fuga, A. *Komunikimi në shoqërinë masive*. Tiranë: Papirus, 2013.
3. Machecky, S. *Changing Vistas in Public Relations Theories*. Deakin University, 2003.
4. Marconi, J. *Marrëdhëniet publike*. Tiranë: UET Press, 2010.
5. Qato, A. et al. *Manual i Policimit Në Komunitet*. Tiranë: 2015.

Burime nga interneti:

- <http://www.slideshare.net/yhamskiey/communication-in-public-administration>
<http://www.core.ecu.edu>

Hysesani, A.
 « Policimi në komunitet: “Zyrat e Shërbimit të Qytetarëve” të Komisarariatit të Policisë Durrës, në kuadër të kësaj strategjie »

Policimi dhe Siguria
nr.5, 2017

Siguria kombëtare dhe religjioni



■ **MSc Kujtim STOJKU**
Komisariati i Policisë Nr. 1

Abstrakt

Objekti i këtij studimi është terrorizmi, dhe siguria kombëtare. Në këtë punim kemi shqyrtuar ekstremizimin religjioz që cenon sigurinë kombëtare. Religjioni dhe siguria kombëtare janë parë në konceptet dhe metodat e filozofisë politike, të cilat mund të aplikohen për problemet praktike të terrorizmit, dhunës shtetërore dhe të sigurisë kombëtare. Natyrisht që kjo është një gamë e gjerë çështjesh në filozofinë politike të aplikuar, që përfshin etikën e luftës, teoritë e shtetit dhe të kombit, marrëdhëniet ndërmjet komuniteteve, nacionalizmeve dhe besimit e njëkohësisht të drejtat e njeriut, që janë kyçi artë për sigurinë kombëtare. Përkatësia etnike, identiteti kombëtar dhe interesat e shtetit, në konceptet e cituara, shpesh, për të justifikuar aktet terroriste, nënkuptojnë që të gjitha nocionet e ngurta, të kundërta, të asaj që përbën një komunitet politik. Shqyrtimi i arsyeve për këtë temë, kërkon një punë këmbëngulëse për të hedhur dritë mbi këtë rrezik të ri që kërcënon popujt. Shqyrtimi me kujdes i fakteve, do të na bëjë që të analizojmë shkurtimisht shkaqet, për të përballuar këtë fenomen të rrezikshëm në këtë shekull të ri. Nocionet e terrorizmit si luftë e padrejtë dhe si krim politik, duhet patjetër të kenë reagimin e duhur të shtetit e të dhunës politike, në çastin e duhur.

Fjalëkyçe:

Religjioni, siguria kombëtare, filozofia, aktet e dhunës dhe terrorizmi.

1. Hyrje

Ky është një fenomen i ri i cili u shfaq në fund të shekullit XX-të dhe në fillim të shekullit XXI. Kjo lloj lufte do të gjente të papërgatitura edhe shtetet më të fuqishme, - luftë e cila u fut si pykë, me format e saj ekstremiste të dhunës. Ky fenomen i ri dhe i rrezikshëm, doli në pah para botës me sulmet e njëmbëdhjetë shtatorit të viti 2001, në SHBA. Më pas ai do të merrte një përhapje të gjerë, aq sa më gjashtë tetor të vitit 1999, Robert Seiple, zyrtar i Departamentit të Shtetit dhe një ambasador i madh, në dëshminë e tij para Komitetit të Marrëdhënieve Ndërkombëtare të Departamentit të Shtetit, do ta vinte në dukje në “Raportin për Liritë Ndërkombëtare”. Ai, në këtë raport, identifikoi regjimet që kishin bërë shkeljet më të mëdha të lirisë fetare, përkuar me ato të Shteteve të Bashkuara; që tashmë ishin në luftë ose së shpejti do të shkonin në luftë dhe që menjëherë dilnin në rend të ditës si probleme të sigurisë kombëtare.¹

Dëshmia e tij e hollësishme, kishte si subjekt të veçantë shkeljet e rënda të lirive fetare. Korrelacioni mes persekutimit fetar dhe kërcënimeve ndaj sigurisë kombëtare nuk është një fenomen i shek. të XXI. Në raportimin e tij, ai përmendi disa vende të pazhvilluara, ku theksohej liria e fesë e ku eventualisht do të nxiteshin sjellje më të qeta. Në dëshminë e tij, ai theksonte po ashtu, se NATO, përfundoi pjesëmarrjen e saj në Kosovë dhe në Bosnjë. Gjithashtu, SHBA një vit më parë kishte filluar sulmet në Irak, Sudan dhe Afganistan. Dhe, dy vjet më pas do të vinin sulmet e njëmbëdhjetë shtatorit,

¹ Inboden, William. “Religious Freedom and National security”. *Policy Review*, October & November, 2012. Washington: Hoover Institution, (f.1).
Gjendet elektronikisht në: <http://www.hoover.org/research/religious-freedom-and-national-security>

të planifikuar nga Al Kaeda, prej bazës së saj në Afganistan.

2. Rizgjimi i radikalizimit të dhunshëm islamik

Mirëpo ky korrelacion mes persekutimit fetar dhe kërcënimit të sigurisë kombëtare, nuk është fenomen i këtij shekulli të ri të pas-Luftës së Ftohtë. Ky radikalizim i dhunshëm i kishte themelet qysh në shekullin e kaluar, duke përfshirë këtu edhe Luftën e Dytë Botërore. Kjo, më pas u karakterizua edhe nga konflikte të tjera. Rruga pa krye e Luftës së Ftohtë, me komunizmin sovjetik, paraqiti një kundërshtar që ishte angazhuar tmerrësisht në persekutimin fetar. Këto akte terrori, që fillojnë me 11 shtator të viti 2001, nxorën në pah një rrezik të ri ndaj sigurisë kombëtare, që në vitet në vazhdim do të merrte një përhapje më të gjerë dhe me shpejtësi. Në qendrën e këtij fokusi ka qenë islami. Një pjesë e problemit ishte mosmarrëveshja midis konceptit Perëndimor të lirisë për të zgjedhur dhe për të adhuruar perëndinë, përballë një koncepti islamik për t'iu nënshtruar perëndisë. Ndërtimi i fesë së Bushit ishte se liria nuk e ka ofruar kornizën optimale.²

3. Religjioni ndihmon në zgjidhjen e problemeve

Ky rizgjim i dhunshëm ekstremist religjioz bëri që bota të gjendej para një fenomeni të ri i cili kishte dalë në rend të ditës, dhe që kërkonte zgjidhje. Duke e parë më seriozitet këtë kërcënim të ri për popujt, Presidenti Barak Obama theksoi se “religjioni është një strukturë uniteti që zgjidh problem”. Meqenëse këto akte ndërmerreshin nga grupe të veçanta të besimit mysliman, duhet të jemi të kujdesshëm që të dallojmë myslimanët e rremë nga myslimanët e vërtetë. Por një pjesë e madhe myslimanësh, në disa vendet me shumicë myslimane gjejnë si justifikim terrorizmin. Këtu mendohet se është pika kyçe, më delikatja e problemit: feja të kuptohet si një fuqi në strategjinë e madhe dhe si sjellje që i adresohet politikës.

Nga një kornizë e tillë del si deduksion se është e dobishme të shikojmë përpara për projekte potenciale, duke pasur si qëllim bashkëveprimin midis fesë dhe sigurisë kombëtare.³ Edhe islami duhet të përfshihet brenda këtij procesi. Mirëpo me rritjen e pluralizmit fetar në një shkallë globale, liria e fesë është shfaqur edhe më shumë se sa një çështje themelore e të drejtave të njeriut. Ajo kryqëzohet gjithashtu edhe me sfida të tjera të politikës së jashtme, duke përfshirë këtu zhvillimin politik, social dhe ekonomik. Por një nga lidhjet më të rëndësishme dhe njëkohësisht që është më e dobëta, është ajo e sigurisë kombëtare.⁴

Këtu dallojmë tre politika të implikimeve religjioze: liria si një mjet diagnostik ose mjeti tregues i politikave të sigurisë; përmirësimi i sigurisë nga rreziku ekzistues si dhe mjetet për parandalimin e kërcënimeve të sigurisë në të ardhmen. Edhe pse Presidenti Obama e ka theksuar lirinë e fesë si një çështje kyçe në botën islame, ka akoma për të

² Shaw, Jonathan E. *Carlise Paper The Role of Religion in National Security Policy Since September 11, 2001*. Carlise (USA): Strategic Studies Institute, 2011, (f.v).

Gjendet elektronikisht në: http://www.globalsecurity.org/military/library/report/2011/ssi_shaw.pdf

³ Po aty, f. 5

⁴ Abstrakt i konferencës “Religious Freedom in US National Security Policy”, paneli i drejtuar nga: William Inboden, Jennifer Marshall, Pauletta Otis, Eric Patterson. Georgetown University: Berkley Center, 2010.

Gjendet elektronikisht në: <https://berkeleycenter.georgetown.edu/events/religious-freedom-and-national-security-policy>

bërë ndaj rregullave të sigurisë si një pjesë integrale të saj.⁵

4. Përcaktimi i sigurisë kombëtare

4.1 Paradigma aktuale

Tani, gjithsekush mund të shtrojë pyetjen se: Pse politikëbërësit kanë dështuar në përfshirjen e pluralizmit fetar në SHBA NSS? Një studim, përfundon duke theksuar se zyrtarët qeveritarë të SHBA-së, për ta adresuar çështjen e religjionit, - qoftë në përgjigjen laike dhe të traditës politike juridike e laike të SHBA-së, për shkak se religjioni shihet shumë i komplikuar dhe i ndjeshëm. Kornizat e tanishme të qeverisë amerikane për afrimin e religjionit janë të ngushta, duke i afruar shpesh religjionet si forca problematike ose monolite.

4.2 Aktet terroriste në Europë

Aktet terroriste, pas njëmbëdhjetë shtatorit, do të përhapeshin me shpejtësi edhe në vendet e tjera. Kështu që, pikësynimi i terroristëve u bë Europa. Franca u bë shënjestra e terroristëve. Më pas do të goditeshin nga këto akte edhe Brukseli e Gjermania. Në një kohë shumë të shkurtër, Franca do të merrte njëra pas tjetrës goditje të rënda nga terroristët. Këtu ka shumë faktorë, por ne do të specifikojmë disa, duke i përmbledhur shkurtimisht.

- Faktori i parë.

Në faktorin e parë, vihet re se historia religjioze e shteteve të Europës Perëndimore, është monolite. Ngritja e shteteve laike ka bërë shumë pak për ta ndryshuar idenë e një monokulture, ku ajo përfshin vetëm sekularizmin fetar, si monokultura e vetme. Në të vërtetë, shtetet si Franca dhe Turqia e kanë zbuluar prej kohësh sekularizmin si forma e vetme e pranueshme në sjelljet dhe në çështjet publike, ndërkohë që vende të tjera si p.sh. Norvegjia, i trajtojnë kishat e tyre si organe rudimentare.

- Faktori i dytë.

Faktori i dytë është se këto vende, kanë një rritje të diversitetit fetar duke përfshirë këtu rritjen e popullsisë myslimane. Veshja me mbulim e myslimanëve konservatorë, ka nxitur një frikë, sepse po vjen gjithnjë e duke u shtuar nga poshtë, nga shoqëria, duke përfaqësuar tashmë një opozitë religjioze ekzistuese. Ndërsa qeveritarët përmendin nevojën për siguri kombëtare, kufizimet dhe rrezikun e shprehjes fetare, ata krijojnë kështu, një efekt të kundërt. Ata i japin një shtysë, “pykës” midis qeverive dhe qytetarëve të tyre myslimanë. Shpresat e forta për bashkëpunim, janë shumë të nevojshme për të ndaluar radikalizmin dhe për të promovuar asimilimin e vlerave demokratike dhe të identitetit, në komunitetet myslimane.

5. Kombet dhe religjionet në Ballkan

Në Ballkan, religjioni duket se ka luajtur një rol shumë më të rëndësishëm në ndërtimin e shtetit se sa gjuha. Folësit serbokratë u shpërbënë në tre komunitete nacionale në bazë të religjionit. Kështu doli kombi boshnjak që e identifikon veten me islamin, duke e dalluar në mënyrë të qartë veten nga katolikët kroatë dhe serbët ortodoksë. Krijimi i

⁵ The Robert Straus Center. William Inboden në: “Religious Freedom and National Security”. Gjendet elektronikisht në: <https://berkeleycenter.georgetown.edu>

shteteve kombëtare në Ballkan u shoqërua, nga fillimi i shek XIX-të për të rivendosur shtetet para osmane të krishtera. Popullsia u hegjemonizua duke vendosur dëbimin e pakicave etnike dhe fetare, ose duke i asimiluar me forcë ato.

Kështu që në Ballkan dolën në rend të ditës këto probleme kryesore:

- identifikimi i bashkësisë kombëtare dhe fetare ka përcaktuar qëndrimin e popujve ortodoksë të Ballkanit ndaj islamit në një mënyrë tjetër;
- shekulli i 19-të, nxiti nacionalizmin;
- pavarësia e perceptuar, ishte për restaurimin e ish-shteteve mesjetare para-osmane;
- feja ishte një nga karakteristikat kryesore të dallueshme të identitetit kombëtar.

6. Shqipëria

Këto zhvillime që po ndodhin në kontinentin europian nuk ka se si të mos shqetësohesh për sigurinë kombëtare të vendit tënd. Shqipëria është në shënjestrën e sulmeve terroriste, që favorizohen nga shumë faktorë. Shqipëria është një vend me një demokraci të brishtë.

Ndryshe nga vendet e tjera, Shqipëria në këtë shekull të ri hyri si një popull ateist. Gjithashtu nuk duhet harruar se qysh gjatë Rilindjes Kombëtare e cila ishte ideatore e luftërave të njëpasnjëshme për të fituar pavarësinë nga Perandoria Osmane, rilindasit tanë dolën me një program të qartë politik, duke e identifikuar veten si shqiptarë dhe jofetarë. Pashko Vasa, një patriot i madh dhe njëkohësisht edhe poet i kësaj periudhe, në një krijim të tijin që titullohej “O moj Shqipni” përcjell mesazhin se “feja e shqiptarit është shqiptaria”.

Por, i gjithë ky program i Rilindjes Kombëtare, kishte një synim të qartë për të arritur objektivat madhore të tij. Duke qenë ajka më e arsimuar e shoqërisë shqiptare, që vuante nën sundimin osman, ata hodhën dritë mbi historinë tonë të lavdishme, duke shpjeguar rrënjët tona historike, si një prej popujve më të vjetër të Gadishullit Ballkanik.

Radikalizmi fetar në Shqipëri duhej kapur në fazën e tij më të hershme, gjë e cila nuk u bë. Edhe në anën e kësaj çështjeje nuk pati asnjë vëmendje nga ana shtetërore, gjë e cila bëri që këtij fenomeni t’i jepte një shtysë duke bërë të mundur që këta faktorë ta përkeqësonin këtë fenomen.⁶

Pikat themelore ku e si ky fenomen mund të zhvillohet, jepen si më poshtë:

- një nga arsytet vjen për shkak të mungesës kontekstuale midis shtetit, sigurisë dhe liderëve të komuniteteve fetare, në parandalimin e këtij fenomeni;
- lehtësimi i axhendës së grupeve fetare radikale nga mosekzistimi i shoqërisë civile në zonat rurale, duke krijuar kështu një hendek të madh në lidhjeje me “mbrojtjen” dhe aktivitetin e radikalizmit fetar dhe ekstremizmit të dhunshëm;
- nevojitet mbështetja e gjerë e komuniteteve fetare me besimtarë liberalë e tradicionalë dhe vlerat humanitare të këtij besimi e të harmonisë fetare;
- nuk duhet të gjenden justifikime për faktorët shtetërorë dhe joshtetërorë.

Këto fenomene, nuk duhet as të minimizohen dhe as të keqinterpretohen, sepse do të na krijoheshin situata mjaft të rrezikshme. Natyrisht, që këtu kanë ndikuar edhe një sërë faktorësh ekonomikë, politikë, kulturorë dhe shtytësish politikë. Së dyti, vlen të

⁶ Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim. *Religious Radicalism and Violente Extremism in Albania*. Tiranë: IDM, 2015. (f.10)

Gjendet në: <http://idmalbania.org/wp-content/uploads/2015/07/Religious-Radicalism-Albania-web-final.pdf>

theksohet me forcë se: dhuna dhe keqtrajtimi nga prokuroria dhe policia mund të shtyjnë drejt hakmarrjes dhe mbështetjes te grupet e dhunshme ekstremiste.

Sot, trazirat islamike në Shqipëri janë zhvillime të ngjashme e paralele me ato të vendeve të tjera të Ballkanit. Këto shtete kanë të përbashkëta disa karakteristika të rëndësishme:

- popullsia indigjene myslimane dhe tranzicione nga qeveritë autokratike socialiste apo komuniste;

- forcat islamike, kohët e fundit prirjen që t'i edukojnë myslimanët lokalë në ndërtimin e xhamive, duke ofruar shërbime publike e duke bërë investime;

- synimi i tyre është që të rrisin influencën, duke bërë njëkohësisht edhe ndryshime.

Shqipëria ka një numër të vogël myslimanësh terroristë vëhabistë dhe më modeste, krahasuar me ato që gjenden në Kosovë, Maqedoni dhe Bosnjë, që shtrihen nga rajoni i Sanxhakut e që pastaj vazhdojnë në Serbi e Mal të Zi. Megjithatë, shihet se myslimanët ekstremistë shqiptarë, kanë një tendencë që të jenë të rinj dhe të arsimohen në botën arabe apo më gjerë, në botën myslimane. Ata janë të lidhur ngushtë me ideologë të tjerë në rajon dhe do të vazhdojnë të jenë kërcënim për autoritetin e komunitetit mysliman në vend, teksa ata marrin pjesë në aktivitete islamike jashtë Shqipërisë.

7. Aktiviteti islamik

Pothuajse tetëdhjetë për qind e 3.6 milionë të qytetarëve të Shqipërisë, janë myslimanë. Komuniteti Mysliman i Shqipërisë është organi kryesor që përfaqëson myslimanët “suni” të vendit (dhe myslimanët shqiptarë në përgjithësi), dhe nga shteti e nga komuniteti ai konsiderohet si përfaqësues “legjitim” i myslimanëve shqiptarë. Pas tyre vijnë bektashinjtë, të cilët e kanë Qendrën Botërore në Tiranë. Ajo përfaqëson zyrtarisht rendin “shiit bektashi sufi” (përbën rreth 20 për qind të popullsisë myslimane të Shqipërisë), i cila ka disa ngjashmëri me “alevitë myslimanë” dhe ka një prani të gjatë në Shqipëri. Në Turqi urdhri Bektashi konsiderohet heretik nga shumë myslimanë, për arsye se praktikat e tij janë më të relaksuara dhe më liberale dhe ka teologji të ndryshme. Bektashinjtë janë të përbuzur, sidomos nga grupi i tretë dhe më i rrezikshëm i pranisë islame në Shqipëri, e cila është një pakicë puritane e tërhequr nga vëhabizmi, si dhe nga forma të tjera ekstreme të islamit, që mbizotërojnë në botën arabe.⁷

Është e vështirë që të përcaktohet numri i vëhabistëve në Shqipëri, sepse ata veprojnë jashtë strukturave zyrtare. Edhe pse ata vazhdojnë të bëjnë përpjekje të vendosur, për të uzurpuar pushtetin nga përfaqësuesit legjitimë islamikë të vendit, vëhabistët, kanë krijuar edhe institucione paralele, duke filluar nga xhamitë dhe shkollat e deri tek bamirësitë.⁸

Të dhënat tregojnë se grupmoshat më të rrezikuara që rekrutohen nga vendet e ndryshme janë nga Shqipëria, nga Kosova dhe nga Maqedonia. Në të gjithë Ballkanin janë rreth njëzet fondacione islamike arabe, të cilat kanë krijuar një prezencë të fortë në Shqipëri. Përmes veprimtarisë së tyre si, në ndërtimin e xhamive, bamirësive e bursat e studimit, kanë krijuar një identitet të fortë shpirtëror dhe një padurim për të promovuar një formë puritane të islamit. Kjo ka ardhur si pasojë e zbatimit të dobët të ligjit dhe nga ana e qeverisë i është kushtuar shumë pak vëmendje disa marrëveshjeve të dyshimta

⁷ Po aty.

⁸ Po aty.

nga disa organizata bamirësie.

Me formimin e Komitetit të Përbashkët të Arabisë për Kosovën dhe Çeçeninë, aktivitetet e së cilës janë të lidhura ngushtë me veprimet e al-Kaedës, u kryen një sërë investimesh si në shkolla fillore e të mesme, në zonat rurale të Kosovës së pasluftës. Por, më e rëndësishmja është dhënia e bursave të studimit në vendet arabe dhe hapja e shkollave të Kuranit ku kjo infrastrukturë e gjerë rriti numrin e klerikëve të kualifikuar.⁹

8. Shkallëzimi i problemit

Faktikisht, me gjithë këtë problematikë të zhvillimit të këtyre grupeve radikale, Shqipëria me gjithë problemet e saja, nuk është se në këtë fushë u gjend tërësisht e papërgatitur. Organet e inteligjencës dhe të zbatimit të ligjit dhanë alarmin në kohë, duke bërë të mundur vëzhgimin dhe neutralizimin e këtij fenomeni. Mund të thuhet se duhej bërë më tepër dhe kjo është e drejtë. Por, ky fenomen, siç e theksuam më lart, gjeti të papërgatitura edhe vendet më të zhvilluara. Megjithëse shteti demokratik është ende shumë i brishtë, edhe në këtë betejë mendojmë se nuk jemi të humbur. Së pari, kjo duket në numrin e vogël të individëve nga Shqipëria, në krahasim me vendet e tjera, të cilat janë përfshirë në veprimet xhihadiste para konflikti sirian. Numri i shqiptarëve që kanë marrë pjesë në këto veprime është 500 dhe numri më i madh është nga Kosova dhe Maqedonia. Për Kosovën dhe Maqedoninë ka një numër problemesh që i mundëson këta faktorë, ndër të cilët, disa nga më kryesorët janë:

- afërsia gjeografike,
- kufizimi i dhënies së vizave,
- kostoja e ulët e transportit për në Siri,
- logjistika e lehtë.

Këtu nuk duhet të harrohen edhe faktorët e tjerë ekonomikë dhe socialë, të cilët kanë ndikimin e vet në këtë plagë të rëndë. Një faktor tjetër për Kosovën, është edhe injoranca, shkalla më e ulët e arsimit të popullsisë. Rreth 62% e popullsisë së rritur të Kosovës, ka arsimim të ulët. Të gjitha këto i bëjnë njerëzit më të prekshëm ndaj indoktrinimit ideologjik dhe radikalizmit. Gjithashtu, duhet pasur parasysh edhe dobësia e përkeqësuar nga polarizimet e konsiderueshme dhe konfliktet e mprehta religjioze.¹⁰

9. Siguria kombëtare

Për t'i bërë ballë këtij fenomeni të ri që sa po vjen e po merr një shtrirje të gjerë, shtrohet si detyrë e menjëhershme që të garantohet siguria kombëtare. Natyrisht që vendi ynë ka një strategji të sigurisë kombëtare, miratuar me ligjin nr. 9322 datë 25.11.2004. Qëllimet themelore të Strategjisë së Sigurisë Kombëtare të Republikës së Shqipërisë janë:

- ushtrimi i sovranitetit të Republikës së Shqipërisë;
- mbrojtja e pavarësisë dhe e integritetit territorial;
- mbrojtja e jetës dhe e pasurisë;
- zhvillimi i pandërprerë demokratik dhe prosperiteti ekonomik;
- mbrojtja e dinjitetit dhe e vlerave kombëtare;

⁹ Po aty.

¹⁰ Po aty.

- anëtarësimi në strukturat ndërkombëtare të sigurisë.

Interesat e shtetit kërkojnë mbrojtjen e Kushtetutës, sovranitetit dhe integritetit territorial të vendit, përsosjen e demokracisë dhe forcimin e shtetit ligjor, mbrojtjen e jetës dhe të pronës private të qytetarëve, zhvillimin e ekonomisë së tregut, në funksion të prosperitetit dhe sigurisë kombëtare. Objektivat e Strategjisë së Sigurisë janë të planit afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë:

- paqe dhe siguri në vend;
- bashkëpunimi rajonal;
- konsolidimi i shoqërisë demokratike dhe të drejtave të njeriut;
- konsolidimi i institucioneve dhe i instrumenteve të sigurimit;
- fuqizimi i ekonomisë;
- integrimi në strukturat europiane të Bashkimit Europian;
- përafrimi i legjislacionit me standardet e Bashkimit Europian;
- stabiliteti rajonal konsiderohet si kusht drejt integritetit të vendeve të rajonit në Europë.¹¹

10. Filozofia e demokracisë dhe siguria

Demokracia, është e vetmja që garanton të drejtat dhe liritë e njeriut. Mes këtyre të drejtave dhe lirive, natyrisht që ajo përkrah edhe lirinë e fesë e të besimit. Filozofia e demokracisë e sheh fenë në nivel global, si një çështje jetike për sigurinë kombëtare dhe ndërkombëtare. Dy janë mënyrat që kjo filozofi e sheh ecurinë e saj:

- së pari, ajo e përkrah demokracinë dhe për këtë arsye forcon stabilitetin e brendshëm dhe atë rajonal dhe njëkohësisht nxit prosperitetin ekonomik;

- së dyti, ajo ndihmon për të luftuar luftën fetare bazuar në terrorizëm.

Është shumë e rëndësishme që të theksohet, se liria e fesë nuk duhet të ngatërrohet me lirinë nga feja. Një politikë e sekularizmit nuk duhet të promovohet në asnjë mënyrë si një mbulesë për intolerancë të paqëllimshme dhe ateizmit si një politikë shtetërore. Në çdo vend demokratik shteti është një garanci për lirinë e fesë dhe kjo tregon pranimin se premiset e demokracisë: që çdo individ ka vlerë dhe vlerën, dhe se shteti është krijuar për t'i shërbyer shoqërisë e jo anasjelltas. Në këtë kuptim, liria e fesë shërben si gur themeli i demokracisë.¹² Projekti i madh i shekullit të 21-të është që të inkurajojë dhe fuqizojë komunitetet fetare - sidomos myslimanët - të cilët kanë këtë pikëpamje, (d.m.th, që t'u përshtaten feve jomyslimane brenda shoqërisë islamike ku islami nuk është një kompromis, por një thellim për sqarimin e tij): Islami zotëron me shtatë. Do të jetë vetëm shpata që të ngulet nga jashtë për të prerë veshët e armiqve të tij të perceptuar, apo shpata që shpon së brendshmi për të prerë lotët në të vërtetën e Islamit?¹³

Tragjedia e madhe është se pishtari i sakrificës dhe i të vërtetës në islam - dhe në të gjitha besimet - ka qenë rrëmbimi shpatës nga duart e atyre që duhet ta mbajnë atë lart, në vend që t'u rrëmbet atyre që e ngrenë shpatën lartë si armiq të së vërtetës dhe të

¹¹ Strategjia e Sigurisë Kombëtare të Republikës së Shqipërisë, Ligj, Nr. 103/2014, Datë: 31.07.2014; dt. miratimi: 31.07.2014, Fletore Zyrtare nr. 137, faqe:137, Tiranë: 2014. (Tiparet e Sigurisë Kombëtare të Republikës së Shqipërisë). Gjetet elektronikisht në:

http://www.mod.gov.al/images/PDF/strategjia_sigurise_kombetare_republikes_se_shqiperise.pdf

¹² Grieboski, Joseph K. "Religious Freedom, Terrorism, and National Security" në: Second Session of the Interparliamentary Conference on Human Rights and Religious Freedom, Brussels, 2004.

Gjetet elektronikisht në: <http://www.theta.com/religious-freedom/20050119.php>

¹³ Po aty.

lirisë. Kështu që ata thonë: “zjarri nga zelli apostolik” i gjallë dhe i mirë në të gjitha besimet, është vjedhur nga altarët e zotit dhe tani vetë ata digjen në ferr dhe altarët bluajnë pluhur. Ne në fakt jemi të destinuar për tjetër një luftë dhe jo për përplasjen e qytetërimeve, e cila referohet shpesh gabimisht. Ne jemi të destinuar për një luftë kundër lirive të rreme - civile dhe fetare - të cilat rrezikojnë lirinë tonë dhe të vërtetën hyjnore.¹⁴

Dilema e sigurisë, e shkaktuar nga mungesa e lirisë fetare, përforcohet kur represioni fetar dhe mungesa e lirisë fetare shërbejnë si një shtysë për aktet e dhunës; madje terrorizmi ka në shënjestër edhe pakicat fetare. Këto akte kundër qeverisjes nuk mund të justifikohen kurrë, por prej kryerësve mund të duken si e vetmja mënyrë për t’iu drejtuar një regjimi që shtyp të drejtat e tyre themelore. Mohimi i të drejtës themelore të lirisë fetare në të vërtetë mund të ndikojë drejtpërdrejtë në sigurinë e vetë shtetit. Respektimi i çdo shprehje të lirisë fetare është, pra, një mjet efektiv për garantimin e sigurisë dhe stabilitetit brenda një shteti.¹⁵

11. Konkluzione

Pasi paraqitëm në këtë ekspozitë të shkurtër, rrezikun e sigurisë kombëtare nga disa sekte fetare, të cilat nëpërmjet dhunës dhe terrorit duan të arrijnë qëllime të caktuara, kemi arritur në një disa konkluzione që mendojmë se janë parësore për qenë të sigurt nga kjo veprimtari terroriste:

- ky ekstremizëm në emër të religjionit duhet të vlerësohet maksimalisht si një rrezik për liritë në një shtet demokratik;

- nevojiten masa radikale për të mbrojtur individin dhe kombin nga kërcënimi i terrorizmit;

- kërcënimi i terrorizmit ndaj individëve dhe shteteve, është shumë më pak se kërcënim - ai vjen edhe nga faktorë e ngjarje të tjera;

- kjo nuk do të thotë se është i mjaftueshëm justifikimi për shkurtimin radikal të lirive civile, por përkundrazi, ndërhyrja e shtetit laik dhe asnjës në mbrojtjen e lirisë së besimit do të kishte një rol vendimtar për të neutralizuar aktet e dhunshme terroriste që spekulojnë me besimin;

- shteti nuk duhet të mjaftohet vetëm me deklarata publike për kërcënimin e sigurisë nga aktet terroriste që vijnë nga terroristët;

- shteti duhet të angazhohet sinqerisht dhe seriozisht për mbrojtjen e qytetarëve nga kërcënimi i terrorizmit;

- shteti duhet të ketë detyra dhe politika të qarta e serioze, për të treguar realisht shkallën e kërcënimit dhe se si të mund të ruajë qytetarët kundër këtij fenomeni të rrezikshëm;

- në asnjë mënyrë nuk duhet përhapur frika e terrorizmit nëpërmjet retorikës mashtruese dhe të ekzagjeruar, e cila është jo vetëm e papërgjegjshme, por edhe moralisht kritike;

- frika që shkakton terrorizmi është një nga arsytet se pse aktet terroriste janë konsideruar moralisht të pështira, por ekzagjerohet në ato raste kur përforcohet ideja

¹⁴ Po aty.

¹⁵ Po aty.

¹⁶ Wolfendale, Jessica (2007). "Terrorism, Security and the Threat of Counterterrorism". *Studies in Conflict and Terrorism* 30 (1):75-93. (p.88).

se frika është po aq e neveritshme;

- duhen miratuar masa radikale kundër terrorizmit, i cili përbën një kërcënim të madh për jetën, mirëqenien fizike dhe sigurinë bazë njësoj si vetë terrorizmi;

- duhet pasur parasysh se efikasiteti i masave të reja kundër terrorizmit, qëndron larg kërcënimit evident të mijëra civilëve të pafajshëm;

- duhet pasur kujdes që të mos përdoret tortura apo paraburgimet e pacaktuara nga organe të tjera të antiterrorizmit;

- terrorizmi duhet të luftohet ashtu si të gjitha krimet e tjera dhe terroristët duhet të dërgohen para drejtësisë ashtu si kriminelët e tjerë, por nuk duhet të lejohet një retorikë kundër terrorizmit, e cila detyron marrjen masave që paraqesin një kërcënim më të madh për jetën dhe mënyrën e jetës së dikujt, se sa vetë terrorizmi.¹⁶

Bibliografi

1. Inboden, William. "Religious Freedom and National security". *Policy Review*, October & November, 2012. Washington: Hoover Institution.
Gjendet elektronikisht në: <http://www.hoover.org/research/religious-freedom-and-national-security>
2. Shaw, Jonathan E. *Carlise Paper The Role of Religion in National Security Policy Since September 11, 2001*. Carlise (USA): Strategic Studies Institute, 2011.
Gjendet elektronikisht në: http://www.globalsecurity.org/military/library/report/2011/ssi_shaw.pdf
3. Abstrakt i konferencës "Religious Freedom in US National Security Policy", paneli i drejtuar nga: William Inboden, Jennifer Marshall, Pauletta Otis, Eric Patterson. Georgetown University: Berkley Center, 2010.
Gjendet elektronikisht në: <https://berkeleycenter.georgetown.edu/events/religious-freedom-and-national-security-policy>
4. The Robert Straus Center. William Inboden në: "Religious Freedom and National Security".
Gjendet elektronikisht në: <https://berkeleycenter.georgetown.edu>
5. Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim. *Religious Rdicalism and Violente Extremism in Albania*. Tiranë: IDM, 2015.
Gjendet elektronikisht në: <http://idmalbania.org/wp-content/uploads/2015/07/Religious-Radicalism-Albania-web-final.pdf>
6. Strategjia e Sigurisë Kombëtare të Republikës së Shqipërisë, Ligj, Nr. 103/2014, Datë: 31.07.2014; dt. miratimi: 31.07.2014, Fletore Zyrtare nr. 137, faqe:137, Tiranë: 2014. (Tiparet e Sigurisë Kombëtare të Republikës së Shqipërisë).
Gjendet elektronikisht në: http://www.mod.gov.al/images/PDF/strategjia_sigurise_kombetare_republikes_se_shqiperise.pdf
7. Grieboski, Joseph K. "Religious Freedom, Terrorism, and National Security" në: Second Session of the Interparliamentary Conference on Human Rights and Religious Freedom, Brussels, 2004.
Gjendet elektronikisht në: <http://www.theta.com/religious-freedom/20050119.php>
8. Wolfendale, Jessica (2007). "Terrorism, Security and the Threat of Counterterrorism". *Studies in Conflict and Terrorism* 30 (1):75-93.

Stojku, K.
« Siguria kombëtare dhe religjioni »

Policimi dhe Siguria
nr.5, 2017

Koncepti i shkollimeve e trajnimeve dhe roli i mësimdhënësve



■ Msc **Adriatik Duqi**
Akademia e Sigurisë

Abstrakt

Shoqëria moderne ku jetojmë po ndryshon shumë shpejt. Ndryshimet e vazhdueshme në teknologji dhe në informacion shoqërojnë jetën tonë. Njohuritë që kemi sot nuk janë të mjaftueshme për të nesërmen. Citatet e shkruar nga filozofi i njohur Sokrati shume vite më parë se: “Dituria e vërtetë qëndron në të diturit, se nuk dimë asgjë”¹, apo “Unë di një gjë, që s’di asgjë”, tingëllojnë aktuale edhe në ditët e sotme. Arsimit dhe edukimit i shëndoshë i bazuar në vlera të larta, konsiderohet pa asnjë dyshim si rruga më e sigurt për përpërimin e përgjithshëm të çdo shoqërie. Dallimi në nivelin e zhvillimit të vendeve e popujve të ndryshëm, është para së gjithash dallimi i sistemeve të tyre arsimore. Në fund të fundit, edukimi dhe arsimimi bëjnë diferencën.² Në polici, si dhe në çdo profesion tjetër, kërkesat shtohen çdo ditë e më shumë. Kërkesat për një polici të mirëshkolluar (edukuar) janë prioritetet e çdo shoqërie moderne. Por në polici, si në shumë profesione të tjera, ngarkesa e ditës së punës dhe përgjegjësitë e saj nuk lënë kohë të mjaftueshme, për vetë edukim dhe vetë zhvillim. Si pasojë është shumë e rëndësishme të kemi një strukturë të organizuar dhe të planifikuar me persona të kualifikuar për zhvillimin e stafit. Në këtë mënyrë, do të përdoren më mirë burimet e organizatës (njerëzore dhe financiare). Edukimi gjithashtu është në lëvizje. Rruga e edukimit e përdorur në të shkuarën ka marrë disa ngritje në konceptet e reja të edukimit të cilat janë shfaqur. Një nga këto koncepte është “trajnimi”. Pikërisht në këtë shkrim do paraqes një analizë mbi trajnimin, instruktorin policor dhe rolin e tij të pazëvendësueshëm për ngritjen e kapaciteteve profesionale në Policinë e Shtetit.

Fjalëkyçe:

Edukimi, vetë zhvillim, trajnim, instruktor/trajner, procesi i të nxënit.

Duqi, A.
« Koncepti
i shkollimeve
e trajnimeve
dhe roli i
mësimdhënësve »

Policimi
dhe
Siguria
nr.5, 2017

1. Hyrje

Një përcaktim i thjeshtë për trajnimin është ai i dhënë nga Shoqëria Amerikane e Zhvillimit të Trajnimit, e cila thotë së trajnimi është: transferimi i aftësive për punën, njohurive dhe informacionit³. Ky trajtim i ri në edukim, lidhet ngushtë me “Andragogjinë”, ose shkencën e edukimit së të rriturve. Në këtë sistem roli i mësuesit vendoset me rolin e trajnuesit e referuar si “moderues” (lehtësues). Kështu “trajnuesi” është një person i cili ka përgjegjësinë për transferimin e aftësive të punës, njohurive dhe edukimit duke përdorur metodologjinë e andragogjisë. Në të shkuarën, në polici si në shumë profesione të tjera, personat të cilët supozoheshin të transferonin njohuritë ishin zgjedhur sipas një niveli ekspertize, pa ndonjë aftësi specifike edukimi.

Një përjasje tjetër për “trajnuesin” ishte instruktori me një formim pedagogjik, që u jepte mësim oficerëve të policisë. Rezultatet kanë qenë në më të shumtën e rasteve jo të kënaqshme dhe rezultonin në mospërdorimin e burimeve të organizatës (njerëzore dhe financiare). Kjo nuk do të thotë se një ekspert në një çështje nuk mund të përfshihet në trajnim. Ai, mundet! duhet!, por ka nevojë për zhvillimin të aftësive të duhura për të bërë të mundur transferimin e njohurive. Të qenit ekspert në një fushë nuk është kusht për dhënien e mësimi (trajnim), por edhe pasja e një grade shkencore nuk do të thotë se lektori/ja zhvillon më mirë një seancë trajnimi sesa një ekspert apo se një trajner/instruktur që nuk ka një gradë shkencore, por që është i certifikuar si instruktor/trajner.

Për të zhvilluar një seancë të suksesshme trajnimi apo një orë mësimore, lektori,

¹ Sokrati, (470–399 p.e.s.) ishte një filozof i lashtë grek.

² Lleshi, Sandër. “Edukimi modern si antidot pazëvendësueshëm në përballjen me ekstremizmin e dhunshëm”. *Policimi dhe siguria*, nr. 4. Tiranë, 2017: Akademia e Sigurisë, (f. 43).

Duqi, A.
«Koncepti
i shkollimeve
e trajnimeve
dhe roli i
mësimdhënësve»

Policimi
dhe
Siguria
nr.5, 2017

përveç se duhet të jetë një oficer policie me integritet të lartë, duhet edhe të dijë e zotërojë komponentët sesi zhvillohet një orë mësimore. Pra lektori/instruktori duhet të ketë përfunduar një trajnim të posaçëm për formimin e instruktorit /lektorit.

Në gusht të vitit 2005, me mbështetje të Programit ICITAP dhe PAMECA, filloi procesi i rishikimit të sistemit të edukim trajnimit policor shqiptar dhe në shtator 2006, filloi programi i parë për trajnimin bazë policor me kohëzgjatje 20 javore.⁴ Deri në fund të vitit 2013 shkollimin bazë policor e kanë përfunduar të gjithë punonjësit e nivelit bazë të policisë (7720), të cilët përbëjnë 74.88 % të numrit të përgjithshëm të punonjësve të Policisë së Shtetit. Me ristrukturimin e bërë në vitin 2006 në Akademinë e Policisë (ish-Qendra e Formimit Policor) në sektorin e shkollimit bazë policor, u hap një sektor i veçantë për formimin e instruktorëve të Policisë së Shtetit. Instruktorët e përgatitur nga ky sektor, zhvilluan mësim me të gjithë trupën e punonjësve të rolit bazë të Policisë së Shtetit, të cilët përfunduan me sukses dhe u certifikuan në përfundim të kursit 11 javor të shkollimit bazë policor.

Gjithashtu, instruktorët e përgatitur nga ky sektor zhvilluan mësim edhe me kursantët e shkollimit bazë policor 22 javor dhe aktualisht zhvillojnë mësim në Kolegjin e Lartë Profesional Kolegji i Policisë. Hapja e këtij sektori për formimin e instruktorëve në Akademinë e Policisë ishte një hap i rëndësishëm në reformimin e sistemit arsimor policor shqiptar. Shkollimi bazë policor ka luajtur një rol të rëndësishëm për përgatitjen e një shërbimi policor shqiptar drejt standardeve euroatlantike. Kjo është një arritje e madhe për organizatën tonë policore dhe kjo, falë edhe mbështetjes nga partnerët tanë euroatlantikë e në mënyrë të veçantë, monitorimit të këtij shkollimi nga misioni amerikan ICITAP⁵.

Fatkeqësisht, ky model i suksesshëm i shkollimit bazë policor nuk u ndoq edhe për nivelet e tjera të shkollimit, për shkak të keqmenaxhimit të implementit të programeve për shkollimin e nivelin të parë drejtues. Në polici, si dhe në shumë agjenci të tjera, njerëzit janë të trajnuar të japin njohuri pa qenë medoemos ekspert të asaj fushe.

2. Çfarë është instruktori?

Gjatë jetës sonë të gjithë kemi ndjekur kurse, pa marrë parasysh nëse kanë qenë të mira, të këqija apo nuk nëse nuk na kanë lënë asnjë përshtypje. Të gjithë kemi ndjekur mësimet në shkollën fillore, tetëvjeçare dhe të mesme; disa kanë vazhduar universitetin apo trajnime të mëtejshme profesionale. Përvoja jonë në nxënie apo mësimdhënie, i ka dhënë formë idesë së “instruktorit” në mendjet tona. Në përgjithësi, roli i instruktorit mund të përkufizohet si “sigurimi i mjeteve për t’i ndihmuar të tjerët të mësojnë”.

Për një mësues shkolle, gama e shkathtësive dhe aftësive për të cilat ai/ajo duhet të japë ndihmën e vet është me të vërtetë shumë e gjerë, ndërsa instruktori policor ka një gamë më të ngushtë aftësish dhe njohurish me të cilat duhet të merret. Konkretisht, roli i instruktorit policor është që t’i ndihmojë pjesëmarrësit të zhvillojnë njohuritë e tyre rreth policimit, ta kuptojnë atë dhe të zhvillojnë aftësitë policore, e ku të jetë e mundur e me vend, të merret me sjelljen e pjesëmarrësve të tij/saj si dhe vlerat e qëndrimit e tyre.

Duqi, A.
« Koncepti i shkollimeve e trajnimeve dhe roli i mësimdhënësve »

Policimi dhe Siguria
nr.5, 2017

³ Kursi i Formimit të Instruktorëve, Moduli I dhe II, Akademia e Sigurisë, maj 2015.

⁴ Kursi i parë i shkollimit bazë policor ka filluar më 4 shtator 2006 deri më 2 shkurt 2007.

⁵ Shala, Xhavit. “Reformimi i sistemit arsimor policor, domosdoshmëri për përballimin e sfidave bashkëkohore të sigurisë”. *Policimi dhe siguria*, nr. 4. Tiranë, 2017: Akademia e Sigurisë, (f. 294).

3. Çfarë bën instruktori?

Në shërbimin modern policor, një theks i veçantë i jepet njohurisë, të kuptuarit, shkathtësive, qëndrimeve dhe sjelljes. Këto fjalë nuk janë të përkufizuara në mënyrë specifike. Roli i një instruktori policie përfshin tre fusha të rëndësishme të zhvillimit të pjesëmarrësve:

- Së pari, instruktori zhvillon njohurinë e pjesëmarrësve mbi legjislacionin përkatës, procedurat që duhet të vëzhgohen dhe formularët e saktë që duhet të plotësohen.

- Së dyti, instruktori zhvillon të kuptuarit e tyre mbi mënyrën se si ta zbatojnë legjislacionin dhe ta interpretojnë atë që kërkohet në formular.

- Së treti, instruktori i zhvillon atyre aftësinë për të dëgjuar me vëmendje dhe për të pyetur si dhe të regjistruarit të saktë të informacionit.

Ndërsa ajo që është më e rëndësishme, instruktori zhvillon qëndrimet e tyre, aty ku është e nevojshme, në mënyrë që ata t'i trajtojnë të gjithë personat pa dallim, pavarësisht nga grupi etnik apo fetar që i përkasin. Instruktori i ndihmon ata të jenë të arsyeshëm, pavarësisht nga humori apo qëndrimi i ndonjë qytetari kundrejt tyre. Instruktori duhet të sigurohet që pjesëmarrësit të jenë të vetëdijshëm për rëndësinë e shmangies nga sjelljet diskriminuese dhe rëndësinë e dispozitave ligjore dhe të së drejtave të njeriut. Së fundmi, instruktori do të zhvillojë sjelljet e tyre në atë mënyrë që është e zakonshme për instruktorët policorë.

Ekzistojnë disa instruktorë, të cilëve këto gjëra u vijnë natyrshëm dhe instinktivisht. Ata janë pakica fatlume. Shumica jonë, duhet që t'i mësojë aftësitë e mira në trajnim, t'i praktikojë e praktikojë vazhdimisht ato. Por, edhe ata të cilët duket se kanë një prirje natyrore për të përvetësuar me lehtësi aftësitë e instruktorit, mund të përmirësohen dhe të bëhen edhe më të mirë!

4. Çfarë duhet të bëni, që të bëheni instruktor?

Ju sigurisht po mendoheni se nga t'ia filloni për t'u bërë instruktor. Si hap i parë, duhet të shqyrtoni pikat tuaja të forta dhe të dobëta. Kjo është baza e të nxënimit tek njerëzit. Në mënyrë që t'i nxisni të tjerët që të rrisin aftësitë dhe të tejkalojnë dobësitë e tyre, duhet të tregoni se jeni të zotë dhe të gatshëm për të bërë të njëjtën gjë edhe vetë.

Në Akademinë e Sigurisë zhvillohet kursi "Për formimin e zhvillimin e instruktorëve" i cili u ofron pjesëmarrësve mundësi të gjera për njohjen dhe zotërimin e metodave bashkëkohore të mësimdhënies. Mësimet që zhvillohen, jepen në mënyrë ndërvepruese dhe përfshijnë teknikat e të nxënimit për të rritur, metodat e mësimdhënies, aftësitë moderuese, planifikimin e trajnimit, qëllimin dhe objektivat e trajnimit, përdorimin e mjeteve mësimore efektive për trajnimin, menaxhimin e ambientit trajnues, etj.

Ky kurs bazohet në mësimnxënien që ka në qendër kursantin dhe organizohet në mënyra të ndryshme si: shqyrtimi i përvojave të pjesëmarrësve; studimi i ngjarjeve të vërteta; përdorimi i modelit të nxënies (lexim paraprak, kontroll i dijeve, sqarim e marrje vendimi dhe shtjellimi i të mësuarit të mëtejshëm). Kursi paraqet metoda mësimore, psikologjinë e mësimdhënies për të rriturit, proceset e të nxënimit në grup, burimet dhe materialet që nevojiten në klasë, planifikimin e mësimin, novacionet mësimore, metodat mësimore kreative, teknikat e zgjidhjes së problemit dhe inskenime

Duqi, A.
«Koncepti
i shkollimeve
e trajnimeve
dhe roli i
mësimdhënësve»

Policimi
dhe
Siguria
nr.5, 2017

që lidhen me mësimdhënien për të rriturit.

Kursi “Për formimin e instruktorëve” ka një kohëzgjatje prej 4 javësh mësimore (140 orë) dhe është hartuar për pjesëmarrës, të cilët kanë kaluar me sukses procesin e përgjeshjes nëpërmjet intervistës së strukturuar. Programi mësimor i kursit “Për formimin e zhvillimin e instruktorëve” përbëhet nga tre module⁶:

a) Moduli i parë.

Moduli i parë zgjat një javë mësimore (35 orë). Ky modul, u siguron pjesëmarrësve një hyrje mbi teorinë dhe praktikën e mësimdhënies dhe u jep atyre mundësi që të njihen me një pjesë të materialit që do të përdoret në modulin e dytë. Materiali do të mbulohet si përmes metodës së përqendruar tek instruktori, ashtu edhe nëpërmjet studimit të pavarur nën drejtimin e instruktorit, lexim të materialit të kursit. Instruktori i kursit do të prezantojë mësimin, objektivat mësimore dhe do të prekë konceptet parësore si përmes leksionit të drejtpërdrejtë ashtu edhe nëpërmjet metodave moderuese. Në përfundim të këtij moduli pjesëmarrësit përgatisin një prezantim 5 minutësh, përpara grupit mësimor. Vlerësimi i prezantimit me mbi 70 % të pikëve, mundëson kalimin në modulin e dytë.

b) Moduli i dytë.

Moduli i dytë zgjat dy javë mësimore (70 orë). Për të qenë të suksesshëm në këtë Modul, pjesëmarrësit duhet ta kalojnë testin e përbërë nga pyetje me shumë alternativa të mundshme, ku ata duhet të arrijnë së paku 70% të rezultatit në mënyrë që të mund ta vazhdojnë modulin e tretë.

c) Moduli i tretë.

Moduli i tretë zgjat një javë mësimore (35 orë) dhe konsiston në vlerësimin e performancës si instruktor. Për ta përfunduar këtë modul dhe njëkohësisht programin, pjesëmarrësit duhet që në mënyrë të suksesshme ta kalojnë fazën një javore të vlerësimit. Ky modul synon:

- Të ndihmojë pjesëmarrësit për të fituar përvojë në mësimdhënie duke punuar së bashku me një instruktor të kualifikuar.

- Të përfshijë pjesëmarrësit në përgatitjen dhe zhvillimin e dy mësimëve njëorësh, ku ata vlerësohen nga vlerësues të kualifikuar.

Programi dhe modulet që zhvillohen në kursin për formimin e instruktorëve në Policinë e Shtetit, është hartuar në mbështetje të rekomandimeve dhe asistencës së këshilltarëve të Programit ICITAP dhe misionit PAMECA IV.

5. Nxënia

Termi nxënie ka mjaft interpretime. Në fjalorin e rregullt kemi këtë përcaktim: marrja e njohurive ose aftësive, nëpërmjet studimit, eksperiencës ose sipas asaj që ju është mësuar. Në psikologji të nxënies ose të mësuarit kuptohet si: përvetësimi i njohurive të reja të cilat çojnë në ndryshimin e sjelljes dhe qëndrimit. Pra, të nxënies ka të bëjë me ndryshimin, - ndryshim i shkaktuar nga zhvillimi i një aftësie të re, nga kuptimi i ligjit shkencor dhe nga ndryshimi i sjelljes. Ky ndryshim nuk është totalisht identik ose natyral në mënyrën se si paraqiten ndryshimet kur ne bëhemi më të vjetër. Mësimi është një ndryshim relativisht i ndryshueshëm, zakonisht i qëllimshëm. Kur marrim pjesë në një kurs, kërkojmë nëpër libra, lexojmë një letër, ne fillojmë të nxënies.

⁶ “Kursi i formimit të instruktorëve”, Moduli I dhe II, Akademia e Sigurisë, maj 2015.

Një mënyrë tjetër të mësuarit mund të bëhet pa planifikuar, p.sh. eksperiencia. Nëse mobiloni një dhomë, fillimisht do të mësoni se fillimisht duhet lyer. Disa nga mësimet tona mund të jenë të rrezikshme, p.sh. mund të zbulojmë se thika është shumë e mprehtë duke prerë veten tonë. Zakonisht në procesin e të nxënimit gjendet një element brenda nesh, me anë të së cilit ne dëshirojmë të kujtojmë dhe të kuptojmë pse se ka ndodhur diçka dhe, që ta bëjmë më mirë herën tjetër. Të gjithë studentët janë individë dhe dy studentë nuk mësojnë në të njëjtën mënyrë. Një student mund të preferojë të lexojë informacion dhe të mësojë individualisht. Një student tjetër mund të ketë probleme me leximin dhe mëson vetëm direkt nga eksperiencia, duke vepruar në mënyrë konkrete. Një i tretë mëson përmes alternativit të eksperiencës dhe të menduarit rreth eksperiencës dhe mëson më mirë si anëtar i një grupi, ku konkurrenca është një element i rëndësishëm i procesit të së nxënimit. Për një trajnues është mjaft e rëndësishme njohja e ekzistencës së mënyrave të ndryshme të nxënimit, me qëllim plotësimin e mënyrave individuale të së nxënimit. Duhet pasur parasysh se një trajnues duhet ta rregullojë stilin e tij/saj në bazë të nevojave të nxënësve dhe jo e kundërta.

6. Tre fushat e të nxënimit

Ka një trajtim konsensual në lidhje me fushat nëpërmjet të cilave kryhet nxënia në trajnim.⁷ Ato janë të njohura si tre fushat e të nxënimit dhe janë si më poshtë:

1. psikomotore; 2. e njohjes; 3. emocionale (afektive).

a) *Fusha psikomotore*. Performanca aktuale e aftësive fizike bazuar në njohuritë e fituara. Një i rritur mund të ketë njohuri të bëjë një detyrë, por mund të mos ketë aftësitë. Të gjitha detyrat kërkojnë njohuri, por kryesisht, aftësitë fizike kanë nevojë për praktikë. P.sh., të gjuash me armë, ndërrimi i një gome, bërja e një gjilpëre, gjuajtja e një topi tenisi.

Mësimi në fushën psikomotore përfshin këto nivele:

- *Imitimi*: Vëzhgimi i aftësive/teknikës dhe përpjekja për ti përsëritur ato.
- *Manipulimi*: Kryerja e aftësive sipas instruksioneve më shumë se vëzhgimi.
- *Precizion*: Riprodhimi i aftësive me kujdes, në proporcion dhe me saktësi.
- *Artikulimi*: Kombinimi me harmoni dhe vazhdimësi i një ose disa aftësive me radhë.

- *Natyralizimi*: Kompletimi i një ose disa aftësive vetvetiu dhe natyrshëm

b) *Fusha e njohjes*. Një proces mendor, njohja e ruajtja e informacionit; marrja e vendimeve ose vlerësimeve. Është njohuria dhe njohja e “Si” dhe “Përse”, (aftësitë e të menduarit). P.sh.: Ligjet, rregullat dhe rregulloret, procedurat operacionale etj. Mësimi në fushën e njohjes përfshin këto nivele:

- Njohuritë - njohja dhe marrja e informacionit.
- Kuptimi - interpretim, shpjegim dhe përmbledhje e informacionit të dhënë.
- Zbatimi - përdorimi i informacionit në një situatë të ndryshme nga konteksti origjinal i mësimt.
- Analiza - ndarja e të gjithës në pjesë derisa lidhjet të jenë të qarta.
- Sinteza - kombinon elementët për të krijuar njësi të reja nga ajo origjinale.
- Vlerësimi - përfshin veprimet për marrjen e vendimeve të bazuara në kritere ose

Duqi, A.
«Koncepti i shkollimeve e trajnimeve dhe roli i mësimdhënësve»

Policimi dhe Siguria
nr.5, 2017

⁷ Kursi bazë i instruktorit ndërkombëtar, shkurt 2011. Përgatitur nga Këshilltarja e programit ICITAP, M. B. Findlay.

shpjegime.

• Fusha emocionale (afektive) - sjelljet që përfshijnë qëndrime, besime dhe vlera. Kjo çështje zakonisht neglizhohet. Të rriturit i mbajnë vlerat e tyre mjaft fort dhe do tu rezistojnë përpjekjeve për t'i ndryshuar ato. Kjo mund të jetë çështja më e vështirë për t'u mësuar dhe për t'u trajnuar si p.sh., Kodi i sjelljes dhe etikës, përshtatja fizike e oficerëve, etj. Mësimi në fushën emocionale përfshin këto nivele:

- Marrja: i vetëdijshëm, pjesëmarrje pasive ndaj stimujve të veçantë.

-Përgjigjja: bindja për të dhënë reagime ndaj një stimuli.

• Vlerësimi: paraqet sjellje në përputhje me një besim ose qëndrim të vetëm në situata ku nuk ka nevojë të bindesh.

• Organizimi: i bindur ndaj një grupi vlerash që shfaqen në mënyrën e sjelljes.

• Karakterizimi: sjellje totale në përputhje me vlerat e brendshme.

Përpara se një pjesëmarrës të mësojë ai/ajo duhet të jenë gati të mësojnë. Kur një detyrë ka një komponent emocional (afektiv) si dhe një komponent ose aftësi të njohjes, pjesëmarrësi nuk do ta mësojë komponentin ose aftësinë e njohjes derisa fusha emocionale të ndërhyjë. Është e nevojshme të merresh me çështjet emocionale përpara fillimit të kërkesave të tjera. Megjithëse një detyrë mund të vendoset kryesisht në një fushë të së nxënit, detyrat shpesh përfshihen në dy fushat e tjera. Para se të shikojmë se çfarë nënkuptojmë me të mësuarit nga përvoja, është me rëndësi që, së pari të vlerësojmë mënyrën se si ne mësojmë. A e keni shqyrtuar ndonjëherë mënyrën se si mësojnë të rriturit? Shumica prej nesh kënaqen duke e marrë si dhunti aftësinë tonë të së nxënit: për ne, ai ndodhë kaq lehtë e në mënyrë natyrore, dhe nuk na shkakton asnjë shqetësim.

Të mësuarit nga jeta është një nga ato procese të rëndësishme njerëzore që merret lehtë si dhuratë. Lehtësia me të cilën ne mësojmë fsheh kompleksitetin e kësaj aftësie të mrekullueshme njerëzore. Në brendësi të kësaj kornize të ndërlikuar, secili prej nesh ka zhvilluar mënyra të ndryshme të së mësuarit. Rrugët bashkëkohore të teknikave të nxënies të të rriturit, njohin faktin se ne kemi mënyra ose lloje të ndryshme të së nxënit. Autorët bashkëkohorë dallojnë katër lloje të së nxënit, të cilat janë : “aktivisti”, “reflektuesi”, “teoricieni” dhe “pragmatisti”⁸.

1. Aktivistët

